

STUDIM PËR VIKTIMAT E KRIMIT TË DHUNËS NË FAMILJE DHE SULMEVE SEKSUALE

LINJA E KËSHILLIMIT PËR GRA DHE VAJZA

Shtator 2013

Studim i Kryer nga:

Iris Luarasi
Artan Fuga
Anita Pilika
Elvana Gadeshi

Ky projekt u financua nga SIDA në kuadër të programit “Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme / Policisë së Shtetit Shqiptar për Policimin në Komunitet” (2012-2015)

Opinionet ose pikëpamjet e shprehura jo detyrimisht shprehin opinionet e vetë Programit.

© Të gjitha të drejtat i përkasin Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza

Botues: EDLORA
ISBN: 978-9928-139-83-7

Pasqyra e Lëndës

Falenderime	7
KAPITULLI I	
SITUATA EKZISTUESE DHE QËLLIMI I KRYERJES SË STUDIMIT	9
Konteksti i kryerjes së studimit	10
Objektivi i programit	15
Qëllimi i studimit	15
Përkufizimi i dhunës në familje	17
Llojet e dhunës në familje	18
Shifrat zyrtare për dhunën në familje gjatë viteve të fundit.....	19
KAPITULLI II	
METODOLOGJIA DHE GJETJET STUDIMIT SASIOR.....	23
Metodologjia e Vëzhgimit	24
Metodat e Kampionimit	29
Disagregimi gjinor i kampionit.....	31
Kampioni/modeli i Qytetit të Targetuar.....	33
Përgatitja e Punës në Terren	33
Kontrolli logjik dhe Verifikimi	34
Futja e të dhënave dhe Procedura e Pastrimit.....	34
Niveli i informacionit në lidhje me çështjen e dhunës në familje në Shqipëri.	34
Instrumente për marrjen e informacionit në lidhje me dhunën në familje në Shqipëri	35
Marrëdhënia gjinore dhe jeta familjare - <i>A ka të drejtë burri ta godasë gruan?</i>	37
Informacion i cunguar për dhunën familjare	40
Boshllëku gjinor në Rolet në Familje	44
Përjetimi i dhunës	45
Thyerja e Heshtjes	53
Familja si një mjedis i mbyllur	56
Struktura e dhunës në familje	58
Dhuna seksuale	58
Profili i viktimave të dhunës në familje	62
Ku të drejtohet për ndihmë viktimat e dhunës në familje?	63
Pasojat e Dhunës në Familje	67
Dhuna ndaj fëmijëve dhe të moshuarve	68
Cfarë propozojnë të intervistuarit si masa parandaluese?	70
Pyetsori on-line në faqen www.hotlinealbania.org	71
Gjetje të tjera	81

KAPITULLI III

METODOLOGJIA DHE GJETJET E STUDIMIT CILËSOR	87
Metodologjia e fokus grupeve	88
Konsiderata metodologjike	88
Shqyrtim i dizajnit të metodave të përziera.....	88
Kompozimi i metodave të përziera.....	89
Aplikimi i kërkimit me metoda të përziera në këtë studim.....	90
Dizajni i kërkimit.....	90
Udhëzues diskutimi për fokus grupe.....	91
Konsiderata etike	91
Grumbullimi i të dhënave.....	92
Afatet.....	92
Metodat dhe materialet.....	93
Metodat dhe materialet për grumbullimin e të dhënave (fokus grupe).....	93
Procedura për fokus grupet.....	93
Analiza e të dhënave e pjesës cilësore.....	94
Përqasja e teorisë së bazuar.....	95
Aplikimi i teorisë së bazuar në këtë studim.....	95
Gjetje	97
Dhuna në familje dhe ndikimi i faktorëve psiko- social.....	98
Dhuna në familje dhe karakteristikat individuale.....	101
KAPITULLI IV	
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	109
Përfundime.....	110
Konkluzione të Pjesës sasiore.....	110
Konkluzione të Pjesës Cilësore	115
Konkluzione të përgjithshme nga 4 fokus grupet	115
Konkluzione specifike	116
Fokus Grupi i Komunitetit Rom	116
Fokus grupi i Komunitetit LGBT.....	117
Komuniteti i grave të dhunuara	118
Rekomandime	120
Për popullsinë Rome	120
Për Komunitetin LGBT	120
Për Gratë e dhunuara.....	121
Për fëmijët.....	125
Për të moshuarit.....	126
Për një strategji më të mirë ndërjegjësimi e komunikimi me viktimat dhe publikun e gjerë.....	126
Grupi i Punës që realizoi Studimin	127
Bibliografia	129

LISTA E TABELAVE

Figure 1:	30
Figure 2:	32
Figure 3:	32
Figure 4	34
Figure 5:	36
Figure 6:	39
Figure 7:	41
Figure 8:	45
Figure 9:	47
Figure 10:	47
Figure 11:	48
Figure 12:	52
Figure 13:	52
Figure 14:	56
Figure 15:	57
Figure 16	58
Figure 17	59
Figure 18:	60
Figure 19:	62
Figure 20:	57
Figure 21:	59
Figure 22:	60
Figure 23:	61
Figure 24	65
Figure 25:	67
Figure 26:	68
Figure 28:	69
Figure 29:	70
Figure 30:	71
Figure 31:	72
Figure 32:	67

Shkurtime

DHF	Dhuna në Familje
DHNG	Dhuna ndaj Grave
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPQ	Drejtoria e Policisë së Qarkut
INSTAT	Instituti Kombëtar i Statistikave
KkDHF	Këshillat kundër Dhunës në Familje
LMKDDHF	Ligji “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”
LKGV	Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza
M&V	Monitorim dhe Vlerësim
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MPCS	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale
MSH	Ministria e Shëndetsisë
PNUD	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
PSH	Policia e Shtetit
QAGJZH	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QNLQ	Qendra Nisma Ligjore Qytetare
RRKDHGJT	Rrjeti kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit
SACP	Programi Suedez-Shqiptar për Policimin në Komunitet
SIDA	Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
SIPU	Instituti Suedez për Administrim Publik
SKBGJ-DHF	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje
UNICEF	United Nations Children’s Fund
UNTF	United Nations Trust Fund to Eliminate Violence Against Women

Falenderime

Studimi për viktimat e krimit të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale është një punë e përbashkët e stafit të Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza, ekspertëve dhe konsulentëve të qendrës tonë në nivel akademikësh. Ky studim merr parasysh faktin se të dhënat mbi dhunën në familje janë të nevojshme për realizimin e hapave të mëtejshëm në këtë kontekst për zhvillimin e planit të veprimit për të ndërhyrë në rastet e dhunës në familje.

Ne falenderojmë për asistencën, projektin e Mbështetjes Suedeze për Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit për Policimin në Komunitet që bëri të mundur financimin e këtij studimi dhe ekipin: si dhe të gjithë ekspertët e angazhuar në këtë proces për asistencën e vazhdueshme gjatë gjithë periudhës së realizimit të këtij studimi, vërejtjet, këshillat dhe sugjerimet me vlerë pa të cilat ky raport nuk do të kishte këtë paraqitje, të Znj. Alma Gjurgji – Shefe e Sektorit për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje dhe Z. Ilir Zhurka – Përgjegjës, Sektori i Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Z. Besnik Ahmetaj dhe Z. Eneo Gjergjani. si dhe gjithë specialistët e Sektorit dhe Seksioneve për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje në të 12 qarqet e vendit, veçanërisht Znj. Elona Mezini - shefe e seksionit për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje në DPQ Fier, Znj. Dashurie Hoxha - shefe e seksionit për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje në DPQ Kukës, Z. Ziadin Cako - shef i seksionit për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje në DPQ Gjirokastrë, Znj. Albana Hasani - shefe e seksionit për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje në DPQ Durrës si dhe Z. Flamur Azizi - shef i Koordinimit në DPQ Dibër.

Një falenderim për të gjitha organizatat që lehtësuan punën tonë gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave dhe kontaktimit me viktimat e dhunës në familje: Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim, Refleksione, Qendra Nisma Ligjore Qytetare, Streha për Gratë e Dhunuara, Streha Kombëtare e viktimave të Dhunës në Familje, Forumi i Pavarur i Gruas, Tjetër Vizion, Qendra e Këshillimit Durrës, Gruaja tek Gruaja, Qendra Vatra, Qendra e Këshillimit Kukës, Unë Gruaja, Qendra e Këshillimit Berat, Aleanca LGBT, ProLGBT dhe Roma Active Albania.

Dhe në fund jo për nga rëndësia, do të donim të falenderonim gratë e dhunuara, përfaqësuesit e komunitetit LGBT, të komunitetit Rom si dhe qytetarë që morën pjesë në këtë studim dhe që shpenzuan kohën e tyre për t’iu përgjigjur pyetsorëve tanë e ndanë me ne njohuritë dhe eksperiencat e tyre.

KAPITULLI I

SITUATA EKZISTUESE DHE QËLLIMI I KRYERJES SË STUDIMIT

Konteksti i kryerjes së studimit

Dhuna në familje është ende abuzimi më i shpeshtë me të drejtat e njeriut, por ende më pak i njohuri dhe i pranuari në botë. Njëkohësisht ky abuzim është edhe një problem shëndetësor që shkakton plagë madje dhe vdekje, komprometon mirëqenien e grave dhe gërryen dinjitetin dhe vetëvlerësimin e tyre. Është fakt i mirënjohur që dhuna në familje i kapërcen të gjithë kufijtë dhe gjendet në të gjitha kulturat. Kërkimi mbi dhunën në familje tregon se abuzimi me gratë është një problem kompleks dhe shumëdimensional. Shpjegimet duhet të përfshijnë faktorë kulturorë, shoqërorë, familjarë dhe individualë që ndikojnë në probabilitetin që gratë mund të bëhen viktimat të dhunës.

Duke ditur qartë nivelin, shpeshtësinë si dhe koston sociale, dhuna me bazë gjinore mbetet një shqetësim i madh në Shqipëri, si një nga dhunimet më serioze dhe të vazhdueshme të të drejtave të njeriut në vend. Studimet e realizuara nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare konfirmojnë se dhuna ndaj grave (DHNG) është e përhapur gjerësisht si në terma gjeografikë ashtu edhe në terma të grupeve sociale. Nga një matje e INSTAT¹ mbështetur nga UNICEF dhe UNDP ka rezultuar se 56% e grave të moshës nga 15 deri 49 vjec kanë eksperiencuar të paktën një tip të dhunës në familje (DHF), fizike, emocionale apo ekonomike. Ndërsa sipas studimit të Institutit Studimor Data Centrum² mbështetur nga Qeveria Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit Shqiptar për Policimin në Komunitet më shumë se 1 në 2 të anketuar deklarojnë se njohin dikë në rrethin e tyre personal (shoqëror e familjar) ose në lagjen e tyre që ka përjetuar të paktën një formë të dhunës në familje. Ndërsa sipas studimit për Dhunën Ndaj Fëmijëve të realizuar nga UNICEF³, 1 në 2 fëmijë pohoi se kishte qenë viktimë e dhunës në një moment të caktuar të jetës së tij.

Këto studime tregojnë gjithashtu se DHF në Shqipëri është seriozisht e paraportuar dhe se masat për ta adresuar duhet të jenë të qëndrueshme dhe shumëdimensionale.

¹ Studimi, i pari në shkallë kombëtare ka mbledhur statistika për të dokumentuar nivelin e DHNG është realizuar gjatë periudhës Nëntor – Dhjetor 2007.

² Studimi është realizuar gjatë periudhës 1 – 23 qershor 2012 me 570 të anketuar në 5 qytete kryesore të vendit.

³ Studim i realizuar nga UNICEF, 2006 me 4500 të intervistuar në 8 qarqe të vendit.

Shoqëria shqiptare ka një histori të dominimit mashkullor, një reflektim ky i traditave të forta patriarkale të Ballkanit. Gratë prej kohësh janë mësuar të pranojnë rolet e nënshtrimit. Gjatë periudhës komuniste ka ekzistuar një boshllëk i madh midis emancipimit të grave në këndvështrimin teorik dhe rrethanave e kushteve të jetës së përditshme. Që pas rënies së regjimit komunist në vitin 1991, Shqipëria po kalon një periudhë ndryshimesh të thella dhe shpesh herë dramatike shoqërore, politike dhe ekonomike, të cilat kanë një ndikim shumë të madh në jetët e shqiptarëve. Barazia gjinore është një parim që është i ri për shoqërinë shqiptare dhe ende nuk është përqafuar nga një pjesë domethënëse e popullsisë.

Viktimat e dhunës me bazë gjinore janë gra dhe vajza të të gjitha moshave, grupeve sociale dhe arsimore apo profesioneve të ndryshme. Megjithatë, grupet më vulnerabël mbeten gratë e varfëra, gratë kryefamiljare dhe vajzat, veçanërisht ato në komunitetet migratore të brendshme të ardhura nga zonat e ndryshme në rrethinat e Tiranës e Durrësit, studentet, gratë në veri të vendit ku tradita patriarkale është akoma e fortë dhe gratë në zonat rurale. Në shumicën e rasteve dhunuesit janë burra, të cilët njihen nga viktimat: anëtarë të familjes, të afërm, fqinj dhe kolegë. DHF mbetet një nga format më të zakonshme të dhunës në Shqipëri, që numëron edhe shifrat më të mëdha të jetëve të humbura mes mbijetuesve të DHNG.

Mediat shqiptare raportojnë shpesh raste ekstreme të dhunës ndaj grave dhe vajzave, shumë prej të cilave përfshijnë vrasjen apo vdekjen e viktimave. Kjo situatë e rëndë e dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri është jo vetëm shprehje e një mendësie patriarkale që i sheh ato si qytetare të dorës së dytë, por edhe rezultat i përpjekjeve të pamjaftueshme nga institucionet publike, të shoqërisë civile dhe të sektorit privat për të parandaluar dhunën mbi baza gjinore dhe për të mbrojtur e përkrahur viktimat e saj.

Gjatë viteve të fundit në Shqipëri janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të plotësuar kuadrin rregullator për parandalimin dhe eliminimin e dhunës mbi baza gjinore në nivel lokal dhe kombëtar me përfshirjen aktive të komunitetit të OJF-ve ku Rrjeti kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit (RRKDHGJT) ka luajtur rolin primar. Anëtarë të Rrjetit përfshijnë Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV); Shoqatën Refleksione; Strehën për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara (Strehëza); Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNLQ); dhe Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH). Hapi më i rëndësishëm ishte miratimi dhe hyrja në fuqi e ligjit “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, (LMKDHF) i cili hyri në fuqi në qershor 2007. Ky ligj u hartua nga

një koalicion OJF-sh shqiptare dhe u paraqit në Parlament si nismë qytetare, përmes një peticioni të firmosur nga 20,000 qytetarë. Po ashtu një vit më vonë, në korrik 2008 hyri në fuqi ligji “Për Barazinë Gjinore”, i cili rregullon trajtimin e njëjtë të burrave dhe grave. Një arritje e madhe ishte edhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2007-2011 (SKBGJ-DHF) dhe më pas Strategjia 2011-2015, bashkë me një Plan Veprimi Kombëtar aprovuar nga Këshilli i Ministrave në 19 Dhjetor 2007, ligji “Për ndihmën Ligjore” që hyri në fuqi në Prill 2009, i cili trajton ndihmën ligjore falas për viktimat e DHF; aktet nënligjore që lidhen me përgjegjësinë e policisë së shtetit dhe shërbimeve publike mjekësore në implementimin e LMKDHF të ratifikuara nga Ministria e Brendshme (MB) dhe Ministria e Shëndetsisë (MSH), si dhe rregulla të tjera të lidhura me DHF/DHNG të aprovuara nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (MPCS), autoriteti udhëheqës në implementimin e LMKDHF. Për këtë qëllim janë ngritur seksione të vecanta për të adresuar DHF si sektori “Për masat kundër dhunës në familje” në MPCS; sektori “për mbrojtjen e minorenëve dhe dhunës në familje në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe seksione në cdo Drejtori Rajonale të Policisë.

Në nivel lokal me nismën e Rrjetit kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit me mbështetje të United Nations Trust Fund To End Violence Against Women (UNTF) që nga 2008 po bëhen përpjekje për të angazhuar institucionet publike në nivel lokal (bashki) në zbatimin e ligjit “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”. Një sistem model komunitar i koordinuar është pilotuar suksesshëm përmes Këshillave kundër Dhunës në Familje (KkDHF), të cilat kanë bërë të mundur një platformë të frytshme bashkëpunimi që shërben si bazë për stabilizimin e sistemit të referimit për viktimat e DHF si dhe identifikon hapa konkrete për të adresuar DHF/DHNG dhe informon proceset planifikuese buxhetare të DHF. Pas implementimit nga RRKDHGJT të projektit “Të Zbatojmë Ligjin kundër Dhunës në Familje” të mbështetur nga UNTF, Rrjeti imponoi një nga aktet më të rëndësishme ligjore dhe në bashkëpunim me MPCS është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.334, datë 07.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”. □ Ky vendim përcakton me ligj mekanizmin që Rrjeti pilotoi në 5 bashkitë e para (Berat, Vlorë, Shkodër, Pogradec dhe Rrëshen) dhe që po implementon tani në 5 bashki të tjera (Elbasan, Lezhë, Manzë, Pukë dhe Njësia Bashkiake 6 në Tiranë) për të ngritur në çdo bashki,:

- a. *Komitetet drejtuese* □ (ish - Këshilli kundër Dhunës në Familje) përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, si: bashkia, policia, gjykata e

rrethit gjyqësor, prokuroria e rrethit, drejtoria arsimore, drejtoria e shëndetit publik, shërbimet sociale pranë bashkisë dhe komunave, zyra e përmbarimit, prefektura, kryetarët e komunave përkatëse, zyra e punësimit, OJF-të, qendrat / strehëzat për viktimat e dhunës në familje, institucionet fetare që mund të ofrojnë shërbime për viktimat; dhe kryesuar nga kryetari i bashkisë.

b. *Ekipet teknike ndërdisiplinore* □(ish Grupi Teknik i Punës) përbërë nga përfaqësues teknikë të institucioneve të përfaqësuara në komitetin drejtues, përfaqësues të njësive për mbrojtjen e fëmijëve dhe nëpunësve vendorë të barazisë gjinore, si dhe nga profesionistë të lirë: avokatë, psikologë etj.

c. *Koordinatorët vendorë* □për referimin e rasteve të dhunës në familje, të cilët janë përfaqësues të zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë vendore, njëherëshi drejtues të punës së ekipit teknik ndërdisiplinor.

Po ashtu UNDP për shumë vite ka mbështetur lobimin dhe ka forcuar kapacitetet e partnerëve në nivel kombëtar dhe lokal në Shqipëri për të adresuar fuqishëm çështjet e dhunës në familje.

Gjatë kësaj periudhe, UNDP ka ndihmuar në formulimin e një Strategjie Kombëtare dhe Plani Veprimi Kundër Dhunës në familje nëpërmjet proceseve të politikës pjesëmarrëse të Qeverisë, organizatave jo-qeveritare dhe shoqërisë civile. Kjo ndihmë ka shkuar në drejtim të rritjes së ndërtimit të partneritetit në nivel kombëtar dhe lokal në mënyrë që të sigurohet që Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit të jenë prone e përbashkët e pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe të gjithë partnerëve que kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të përbashkëta;

Në vitin 2010 Komiteti i CEDAW shqyrtoi raportin periodik të Shqipërisë për zbatimin e Konventës së OKB-së dhe ofroi disa rekomandime. Në dhjetor 2011 Shqipëria nënshkroi Konventën Evropiane për parandalimin dhe luftën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Për të mbështetur angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, qëndrueshmërinë e mjedisit dhe zhvillimin e kapaciteteve kombëtare Qeveria e Shqipërisë dhe Kombet e Bashkuara nënshkruan në vitin 2011 Programin e Bashkëpunimit 2012-2016. Ndërsa nga agjensitë e OKB-së do të kërkohet një perspektivë gjinore në të gjitha aktivitetet parashikohen ndërhyrje të fokusuara në tërësi ose në mënyrë të konsiderueshme në çështjet e barazisë gjinore të

përshkruara në rezultate.

Ligji Nr.10.399, datë 17.03.2011,“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005, për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” sanksionon të drejtën për tërheqjen e ndihmës ekonomike jo vetëm nga kryefamiljari, por edhe nga gratë e dhunuara në rastet kur ato pajisen me UM/UMM; si dhe parashikon mbështetjen me ndihmë ekonomike të familjeve në kohën kur bashkëshortet janë në proces zgjidhjeje martese. Ndihma ekonomike për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare përfitohet për periudhën e vlefshmërisë së UM/UMM-ve.

Së fundmi janë ndryshimet në Kodin Penal në mars 2012 të cilat tashmë kanë dy nene të vecanta për DHF.

Neni 124/b përcakton/përfshin mbrojtjen e të miturve edhe nga prindërit, vëllezërit dhe motrat, gjyshërit, kujdestari ligjor ose nga çdo person i detyruar të kujdeset për ta. Kjo lloj vepre dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.

Neni 130/a e përcakton dhunën në familje duke përfshirë: rrahjen apo çdo vepër tjetër dhune; kanosjen serioze për vrasje ose plagosjen e rëndë; plagosjen me dashje, të kryer nga bashkëshorti/ja; ish- bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose ish-bashkëjetuesi/ja, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, si veper që dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Me ndryshimet e Kodit Penal, incidentet e dhunës në familje janë cilësuar si veper penale (neni 130/a), dhe si pasojë prokuroria me të marrë dijeni për një rast të dhunës në familje (nga viktimat, policia ose burim tjetër) fillon menjëherë procedimin e rastit (kryesisht). Pra edhe nëse pala paditëse tërhiqet, çështja nuk mund të pushohet. Nga ana tjetër, dhunimi i urdhrit të mbrojtjes apo i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën një kundravajtje penale sipas nenit 320/321 të Kodit Penal të ndryshuar; si rrjedhojë, dhunuesi mund të arrestohet kur ekzistojnë këto rrethana dhe dënimi për shkeljen e UM/UMM-ve është përcaktuar vetëm burgosje deri në 2 vjet (pra është hequr dënimi me gjobë).

Megjithatë, duke marrë parasysh përmasat e dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri, një problem mjaft i prekshëm mbetet fakti që kapaciteti i shërbimeve për viktimat e kësaj dhune është shumë i vogël në raport me nevojat për këto shërbime. Në mungesë të shërbimeve ndaj tyre, gratë viktimat të dhunës detyrohen të vazhdojnë të jetojnë në shtëpitë e tyre me rrezikun që dhuna të përshkallëzohet, ndërsa të tjera dekurajohen që të kërkojnë ndihmë,

sepse e dinë që ajo nuk do të mund t’ju ofrohet.

Objektivi i programit

Objektivi kryesor i studimit është rritja e aftësisë së aktorëve që kanë të bëjnë me dhunën në familje, duke përfshirë PSH, për të ofruar shërbime që reduktojnë rastet e dhunës në familje. Përmirësimin e koordinimit ndërmjet PSH-së dhe aktorëve të tjerë për të siguruar trajtim të përshtatshëm të rasteve të dhunës në familje.

Secila fushë e programit duhet të shihet si një fokus për të përmirësuar situatën aktuale në përputhje me qëllimet e vendosura, por edhe si një prioritet për ndërtimin e kapaciteteve nëpër grupe të ndryshme, përmes qasjes së zgjedhur për zbatimin e aktiviteteve programore.

Realizimi i këtij studimi lidhet ngushtësisht me njohjen e problematikës së kategorive të mëposhtme të dhunës në familje:

- ☉ Perceptimi i qytetarëve lidhur me dhunën në familje: çfarë është keqtrajtimi dhe në çfarë kushtesh ndodh?
- ☉ Përhapja dhe format kryesore të dhunës në familje në Shqipëri
- ☉ Pasojat e dhunës në familje
- ☉ Reagimi i qytetarëve: metodat që përdorin qytetarët për ndalimin e dhunës ose për zvogëlimin e rrethanave të ushtrimit të saj
- ☉ Kufizimet sociale që i privojnë grupet e veçanta demografike në sferën private dhe publike dhe që potencialisht e rrisin dhunën në familje

Qëllimi i studimit

Ky studim bazohet në një anketim të gjerë, në intervista relativisht të zgjeruara rreth problemit në fjalë, në bashkëbisedime me grupe të fokusuara në këtë problematikë, në përvojën e LKGV, si edhe në një mendim shoqëror të përparuar rreth kësaj çështjeje.

Qëllimi i tij ka qenë të veçojë aktorët familjarë të prirur për të ushtruar dhunën familjare si edhe ata që e pësojnë atë, format dhe pasojat e kësaj dhune, të masë shkallën e informimit publik rreth dhunës në familje dhe të legjislacionit që kërkon ta parandalojë atë, ta shohë sesa është kjo dhunë e përhapur në kontekste të ndryshme familjare, shkaqet e saj sipas perceptimit publik dhe të paraqesë propozimet publike rreth masave plotësuese për parandalimin e saj.

Si një hap përpara për rritjen e njohurive në këtë fushë, ky studim shpjegues i dhunës në familje ne Shqipëri është përpjekur: (i) të identifikojë larminë e formave të dhunës që zakonisht janë të pranishme në familje (ii) të hedhë dritë në perceptimet e grave se cilat sjellje janë abuzive në cilat rrethana; (iii) të eksplorojë cilat strategji përdorin gratë për t'i dhënë fund dhunës apo për të minimizuar pasojat e saj; (iv) të dokumentojë pasojat e dhunës në familje mbi gratë, fëmijët dhe familjen e shoqërinë si e tërë; (v) të identifikojë sjelljet e grave përkundrejt abuzuesve të tyre dhe marrëdhënieve abuzive; (vi) të përcaktojë kushtëzimet sociale që i privojnë shumë gra të jenë të barabarta me burrat në sferën private.

Studimi kishte si objektiv viktimat e krimit të dhunës në familje dhe vlerësimet mbi sulmet seksuale. Rezultatet e studimit ne shpresojmë se do të merren parasysh gjatë zbatimit të aktiviteteve të tjera në këtë komponent të programit që do të jenë të tilla si;

- Zhvillimi i një manuali për personat përgjegjës për trajtimin e dhunës në familje me një përshkrim të roleve dhe përgjegjësive të agjencive të ndryshme që garantojnë koordinimin më të mirë të aktorëve;
- Zhvillimi i materialeve ndërgjegjësuese për dhunën në familje për të rritur ndërgjegjësimin e roleve përkatëse dhe përgjegjësitë e agjencive të ndryshme;
- Një studim për të përcaktuar nevojat për përmirësime në sistemin e raportimit aktual për dhunën në familje.

Studimi synon të marrë të dhëna të besueshme dhe të plota mbi shtrirjen dhe natyrën e fenomenit në lidhje me të gjitha etnitë, minoritetet dhe grupet e margjinalizuara, si dhe komunitetin LGBT dhe në këtë drejtim do t'i kushtojë vëmendje të veçantë situatës specifike të personave transeksualë, përvojat e të cilëve janë të lidhura me identitetin e tyre gjinor, pavarësisht orientimit të tyre seksual.

Rezultatet e studimit ne shpresojmë se do të merren parasysh nga ana e Policisë së Shtetit (PSH) dhe agjencive kombëtare partnere që janë të përfshira në përgjigjen zyrtare ndaj incidenteve të dhunës në familje dhe krimeve seksuale. Gjetjet do të ndihmojnë në përmirsimin e strategjive organizative dhe reagimeve operacionale në fushën e: parandalimit, hetimit, mbrojtjes së viktimave dhe të dëshmitarëve dhe rehabilitimin e shkelësve të ligjit.

Studimi mbuloi 12 qarqe të Shqipërisë dhe ka trajtuar ndërgjegjësimin për të drejtat dhe masën në të cilën të anketuarit raportojnë viktimat e krimit të dhunës në familje. Të anketuarit janë pyetur në lidhje me përvojat e tyre të fundit në lidhje me dhunën në familje.

Përkufizimi i dhunës në familje

Për të kuptuar drejt rezultatet e këtij studimi të mbështetur në një anketim të gjerë, duhet më së pari të sqarojmë se dhuna në familje në këtë punim, si term, i përmbahet një përkufizimi të caktuar, më së pari ajo është një fenomen që prek pjestarët e një familjeje në një rreth pak a shumë të gjerë familjar, së dyti ajo nuk lidhet vetëm me presionin fizik, por edhe me ushtrimin e dhunës psikike, seksuale, ekonomike, verbale, etj, duke lënë, së treti, pasojat në të gjitha planet e jetës dhe të ekzistencës të jetës njerëzore.

Pa përjashtuar nivele të tjera të ushtrimit të kësaj dhune, theksojmë se ajo studjohet më tepër në format e saj më kuptimplote sikurse janë format e dhunës së prindërve ndaj fëmijëve, dhe të fëmijëve të një farë moshe ndaj prindërve, të bashkëshortëve ndaj njeri tjetrit, sidomos të burrit ndaj gruas, të dhunës ndaj personave me status social relativisht të dobët, të varfër, handikapatë, si edhe atyre të moshuar.

Sipas përcaktimit të Zyrës kundër Dhunës në Familje në Departamentin e Drejtësisë në SHBA⁴ me ndihmën e burimeve kryesore të tyre si Hotline Kombëtar për Dhunën në Familje dhe Qendra Kombëtare për Viktimat e Krimit dhuna në familje përcaktohet si “model i sjelljes abuzive në çdo marrëdhënie, e cila ushtrohet nga një partner intim ose nga anëtarët e familjes për të marrë dhe për të ruajtur autoritet dhe kontroll mbi një tjetër partner intim ose anëtar të familjes. Dhuna në familje mund të jetë fizike, seksuale, emocionale dhe

⁴<http://www.ovw.usdoj.gov/domviolence.htm>

psikologjike që ndikon te një person tjetër. Kjo përfshin çdo sjellje që tremb, manipulon, poshtëron, izolon, frikëson, terrorizon, shtrëngon, kanos, dëmton, lëndon ose plagos dikë”.

Kërkimet në lidhje me dhunën seksuale mes partnerëve intimë kanë ardhur në rritje gjatë 20 viteve të fundit, por fatkeqësisht jo në Shqipëri. Disa studime tregojnë se gratë dhe burrat ka të ngjarë të viktimizohen njësoj nga partnerët e tyre⁵, por ka të tjerë që mendojnë se gratë ka më shumë të ngjarë të viktimizohen se burrat⁶.

Llojet e dhunës në familje

Për të pasur një përkufizim sa më të mirëpranuar, kemi cituar studimin INSTAT “Për Dhunën Familje në Shoqëri”⁷

Abuzimi emocional – shkatërrimi i ndjenjës së vetëvlerësimit dhe/ose të vetëbesimit të një individi. Kjo mund të përfshijë kritikimin e vazhdueshëm, poshtërimin, përçmimin e aftësive të një personi, sharjet, degradimin dhe dëmtimin e marrëdhënieve të dikujt me fëmijët e tij ose të saj.

Abuzimi psikologjik – përfshin shkaktimin e frikës nëpërmjet trembjes; kërcënimit për dëmtim fizik të vetes, partnerit, fëmijëve ose të familjes së partnerit apo të miqve; kërcënimit për braktisje; vrasjen e kafshëve shtëpiake dhe shkatërrimin e pronës; kërcënimet për marrjen e kujdestarisë së fëmijëve; izolimin e dhunshëm nga familja, miqtë, shkolla dhe/ose puna dhe mohimin e mundësisë për para ose mbështetje ekonomike.

Dhuna fizike – përfshin, por nuk kufizohet me: çjerrjen, shtyrjen, goditjen, kapjen, rrahjen, asfiksimin, pickimin, shpimin, shkuljen e flokëve, përdredhjen e krahut, goditjen me shuplakë, gjuajtjen, djegien, therjen dhe mbytjen. Dhuna fizike mund të përfshijë përdorimin e madhësisë dhe të forcës fizike të një personi, shtrëngimet ose armët (p.sh. pistoletë, thikë ose një objekt tjetër) për të marrë dhe për të ruajtur kontrollin mbi personin tjetër. Dhuna fizike shpesh

⁵Schafer, J., R. Caetano, C.L. Clark, “Rates of Intimate Partner Violence in the United States,” *American Journal of Public Health* 88 (11) (1998)

⁶ Bachman, R., *Violence Against Women: A National Crime Victimization Survey Report*, Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Bureau of Justice Statistics, 1994

⁷ Sondazh Kombëtar me bazë popullatën “Dhuna në Familje në Shqipëri”, mars 2009, INSTAT

shkakton disa forma dëmtimi ose lëndimi dhe mund të shkaktojë edhe vdekje.

Dhuna seksuale – përfshin imponimin, detyrimin ose përpjekjen për të detyruar kontakt ose sjellje seksuale pa pëlqimin e personit. Abuzimi seksual përfshin, por nuk kufizohet me përdhunimin martesor, sulmet në pjesët seksuale të trupit, detyrimin për të bërë seks pas ushtrimit të dhunës fizike ose trajtimin e personit në mënyrë seksualisht poshtëruese. Abuzimi seksual kryhet nga partnerët intimë dhe nga anëtarët e familjes brenda kontekstit të martesës, të marrëdhënieve dashurore dhe të familjes.

Shifrat zyrtare për dhunën në familje gjatë viteve të fundit

Në tabelat më poshtë janë rastet e raportuara pranë njësisive të dhunës në familje pranë rajoneve të policisë në 12 qarqe të vendit nga viti 2008 (kur filloi zbatimi i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” deri në fund të vitit 2012, si dhe numri i rasteve që kërkojnë UM/UMM nga policia nga 2008 deri në fund të 2012⁸.

Viti 2008		Drejtoria e Policisë Qarkut											
	Shuma	Tirane	Durrës	Vlorë	Shkoder	Berat	Fier	Kukes	Diber	Elbasan	Gjirokastr	Korce	Lezhe
Evidentuar	822	437	94	18	61	12	38	8	9	75	11	32	27
Kërkesë-padi Për U.Mbrojtje	377	249	94	8	4	6	0	4	3	4	2	3	0

⁸ Të dhënat janë ofruar nga Sektori për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë

“Studim për viktimat e krimit të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale”

Viti 2009		Drejtoria e Policisë Qarkut											
	Shuma	Tirane	Durrës	Vlorë	Shkoder	Berat	Fier	Kukës	Diber	Elbasan	Gjirokastr	Korçë	Lezhë
Evidentuar	1217	579	147	92	77	59	28	7	6	85	13	46	78
Kërkesë-padi Për U.Mbrojtje	841	415	141	46	49	58	7	7	6	15	7	26	64

Viti 2010:		Drejtoria e Policisë Qarkut											
	Shuma	Tirane	Durrës	Vlorë	Shkoder	Berat	Fier	Kukës	Diber	Elbasan	Gjirokastr	Korçë	Lezhë
Evidentuar	1998	539	217	173	182	117	233	42	16	209	62	122	86
Kërkesë-padi Për U.Mbrojtje	1234	393	196	82	109	114	84	17	16	23	34	105	61

“Studim për viktimat e krimit të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale”

Viti 2011:		Drejtoria e Policisë Qarkut											
	Shuma	Tirane	Durres	Vlore	Shkoder	Berat	Fier	Kukes	Diber	Elbasan	Gjirokastr	Korce	Lezhe
Evidentuar	2181	696	302	107	85	101	346	32	46	141	53	179	93
Kërkesë-padi Për U.Mbrojtje	1345	467	261	68	60	99	89	21	34	37	35	129	45

Viti 2012:		Drejtoria e Policisë Qarkut											
	Shuma	Tirane	Durres	Vlore	Shkoder	Berat	Fier	Kukes	Diber	Elbasan	Gjirokastr	Korce	Lezhe
Evidentuar	2526	906	312	139	157	135	142	41	127	186	55	216	110
Kërkesë-padi Për U.Mbrojtje	1562	534	267	91	74	110	75	31	60	41	41	177	61

Ndërsa në tabelat më poshtë janë rastet e vrasjeve në shkallë vendi nga 2008 deri në 2012 si dhe lidhja që autori i vrasjes ka pasur me viktimën.

“Studim për viktimat e krimit të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale”

Vepra penale - vrasje (në marrëdhëniet familjare)	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti
	2008	2009	2010	2011	2012
	Nr.viktima	Nr.viktima	Nr.viktima	Nr.viktima	Nr. viktima
Vrasje gjithsej (Nenet.76-83,85 KP)	22	16	20	29	28
Viktima femra	14	9	12	15	16
Viktima meshkuj	8	7	8	14	12

Lidhja familjare e viktimës me autorin e vrasjes	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012
bashkëshortja	10	6	10	11	10
bashkëshorti	1	-	1	5	1
motra	-	-	-	2	3
vëllai	2	2	2	1	4
fëmija	2	2	1	5	3
prindi	-	3	3	2	4
të tjerë	7	3	3	3	3

KAPITULLI II

METODOLOGJIA DHE GJETJET STUDIMIT SASIOR

Metodologjia e Vëzhgimit

Studimi raporton metoda të përfshira të kërkimit sasior në formën e pyetësorëve, si dhe cilësor në formën e fokus grupeve.

Për të identifikuar fushat kyçe të interesit brenda grupeve të targetuara u përdor një qasje sasimore. Përdorimi i metodologjisë cilësore në formën e fokus grupeve u shfrytëzua edhe për të komplementuar dhe zgjeruar të dhënat e përfthuara në literaturën e pyetësorit. Metodologjia e fokus grupeve u përzgjedh për të identifikuar pikëpamjet e grupeve LGBT, gra dhe vajza rome si dhe viktimat të dhunës në familje.




Figura 1. Tabela eksploruese e studimit

Target grupi i studimit nëpërmjet pyetësorëve, që përbën edhe palën e interesuar drejtpërdrejtë dhe aktorët e përfshirë në shqyrtimin e çështjeve sociale në familjen shqiptare janë:

- (1) Qytetar/e
- (2) Viktimat të dhunës në familje

Për përgatitjen e këtij raporti u krijua një grup pune me studiues, ekspertë dhe specialistë të dhunës në familje, të cilët punojnë çdo ditë me çështje të dhunës në familje si dhe specialistë të njësive kundër dhunës në familje pranë rajoneve të policisë në çdo qark. Si rezultat i një seri takimesh dhe diskutimesh, grupi i punës zhvilloi dhe miratoi instrumentin e mbledhjes së të dhënave. Ky instrument u testua në Tiranë dhe disa prej pyetjeve u qartësuan dhe u rregulluan/përmirësuan edhe me këshillat e anëtarëve të grupit të punës dhe përfaqësues të Policisë së Shtetit.

Pas përzgjedhjes së dymbëdhjetë intervistuesve (një intervistues për secilin Qark), me ta u krye një program trajnimi, në mënyrë që të jepeshin udhëzime të qarta për mënyrën e mbledhjes së të dhënave në terren dhe si të tregohesh kujdes në lidhje me konfidencialitetin e tyre. U plotësuan 500 pyetësorë në dymbëdhjetë Qarqet ku Tirana mori sigurisht vëmendjen më të madhe me 150 të intervistuar. Këtij numri i shtohet edhe numri i 60 pyetësorëve të plotësuar me viktima të dhunës në familje të cilët morrën në telefon nëpërmjet linjës telefonike pa pagesë e konfidenciale 08002040 për viktimat e dhunës në familje.

Skema e mëposhtme tregon mënyrën dhe punën përgatitore se si u realizua ky kërkim dhe si arritëm në këtë studim:




Figura 2. Struktura e studimit

Nga pikpamja e Metodologjisë së Intervistimit janë përdorur:

- Intervista *Face-to-Face* për grupet e synuara të anketimit (500 pyetsorë)
- Intervista me *Telefon* nëpërmjet Linjës Telefonike konfidenciale pa pagesë (60 pyetsorë)
- Vetintervistimi nëpërmjet pyetsorit të mbushur nga vizitorët në faqen *Web* të Linjës së Këshillimit (54 pyetsorë)

Njësitë e Intervistimit janë:

- Njësitë administrative urbane dhe rurale të 12 Qarqeve të Shqipërisë.

Përzgjedhja paraprake e këtyre njësive të veçanta u krye duke marrë parasysh:

- Natyrën kombëtare të studimit,
- Përfaqësueshmërinë e grupeve të synuara të anketimit, sipas të dhënave të LKGV-së.
- Koston për kryerjen e një vrojtimi të tillë.

Madhësia e kampionit të përzgjedhur është 614 të anketuar

Përzgjedhja e kampionit përfaqësues të popullsisë u realizua nëpërmjet metodës së probabilitetit të rastësishëm me kuota të qëllimshme (*purposive quota sampling*)

Pikat për përzgjedhjen e kampionit janë të paracaktuara për 11 qarqet e studimit dhe pothuajse trefishi i kampionit për qytetin e Tiranës, ndërkohë që, ndarja e projektuar e kampionit do të jetë rreth 6% për secilin nga të dymbëdhjetë qarqet.

Intervistat u kryen në zonat urbane dhe rurale përkatëse dhe çdo intervistë zgjati mesatarisht 22 minuta.

Përgjatë këtij studimi janë ndjekur një sërë metodash në studimin sociologjik të çështjes. Zgjedhja e kampionit të të anketuarve është bërë brenda grupeve që përfshihen në qëllimet e studimit. Janë përzgjedhur të 12 qarqet e vendit, përkatësisht qarqet e Tiranës, Durrësit, Vlorës, Gjirokastrës, Korcës, Elbasanit, Beratit, Shkodrës, Lezhës, Kukësit, Dibrës dhe Fierit.

Janë zona që duke pasur një dinamikë sociale të ndjeshme, përfaqësojnë edhe treva që iu përkasin edhe modeleve kulturore me specifika të veçanta.

Sado e vështirë që ka qenë, përbërja sociale e të anketuarve është përzgjedhur në atë mënyrë që t'i përgjigjet qëllimeve të studimit. Vemë në dukje se janë anketuar edhe qytetarë që nuk kemi pasur të dhëna se kanë qenë të ekspozuar ndaj dhunës, por edhe të tillë që kanë pësuar dhunë familjare. Këta të fundit janë 27,7 % e të gjithë të anketuarve. Po kështu janë përzgjedhur persona në një moshë ku edhe dukuritë e dhunës dukeshin si më të përhapura dhe ndofta të pajisur me një mendim më të pjekur që shoqëron perceptimet e tyre mbi dhunën në familje. Nga të dhënat e bazave tona statistikore del se 80,7 % e të anketuarve i takojnë tre grupmoshave që në përgjithësi shtrihen nga 20 deri në 45 vjec. Duke u përqendruar tek dhuna në familje, normalisht kemi përzgjedhur si pasojë e një seleksionimi rastësor.

71,6% të të anketuarve janë të martuar, kurse pjesa tjetër me status familjar beqar ose të ve. Dhe së fundi, nga të dhënat kryesore vemë në dukje se jemi fokusuar në familjen me një strukturë numerike më të shpeshtë në vitet e fundit, atë me 4 ose 5 antarë, të cilat, sëbashku, përbëjnë 56,4 % të familjeve në të cilat janë gjendur të anketuarit.

I theksojmë këto për të treguar se kampionimi i bërë na lejon të shohim në disa plane perceptimet popullore rreth problemit të dhunës në familje. Pra, të kemi edhe përfaqësues nga shtresa më të ekspozuara ndaj dhunës, por edhe një mendim qytetar më të përgjithshëm rreth problemit.

Gjithësesi, nisur nga fakti se shumica e të anketuarve janë femra, si shtresa që pëson më shumë dukuritë e dhunës, (83,2 % e të anketuarve janë femra), vemë në dukje se në perceptimet e paraqitura në këtë studim, këndvështrimi femëror sigurisht që do të ketë një peshë më të veçantë.

Lidhur me tematikën e ndarë sipas objektivave janë matur idetë dhe perceptimet e qytetarëve ndarë në disa tema të ndryshme, të para në detaje më poshtë:

A. Në lidhje me perceptimin e qytetarëve lidhur me dhunën në familje janë parë kryesisht tematikat e mëposhtme:

- ➔ Dhuna midis partnerëve
- ➔ Dhuna kundër fëmijëve

- ➔ Format e perceptuara të dhunës kundër grupeve të tjera
- ➔ Qëndrimet e qytetarëve ndaj keqtrajtuesve dhe marrëdhënieve keqtrajtuese

B. Është parë përhapja dhe format kryesore të dhunës në familje në Shqipëri nëpërmjet:

1. Vështrimit të përgjithshëm të dhunës në familje
2. Izolimit
3. Dhunës psikologjike
4. Dhunës fizike
5. Dhunës seksuale
6. Dhunës ekonomike
7. Kush janë viktimat? Grupet demografike të prekura më së shumti nga dhuna në familje
 - ☞ *Dhuna kundër fëmijëve*
 - ☞ *Dhuna kundër të moshuarve*
 - ☞ *Dhuna kundër njerëzve për shkak të orientimit të tyre seksual*
8. Kush janë keqtrajtuesit? Personat më të prirur për të kryer dhunën në familje

C. Në seksionin tjetër të objektivave të matjes janë analizuar pasojat e dhunës në familje të ndara në 3 grupe të vecanta:

- Pasojat për personat që vuajnë nga dhuna në familje
- Pasojat mbi fëmijët dhe familjen
- Pasojat mbi shoqërinë, duke përfshirë institucionet qeveritare

D. Në këtë pjesë matet reagimi i qytetarëve për dhunën në familje si dhe metodat që përdorin qytetarët për ndalimin e dhunës ose për zvogëlimin e rrethanave të ushtrimit të saj

- Si e trajtojnë qytetarët dhunën dhe njohuritë e qytetarëve lidhur me ndihmën
- Zvogëlimi i dhunës përmes parandalimit: Perceptimet e qytetarëve për faktorët që kontribuojnë në parandalimin e dhunës dhe për mënyrën e trajtimit të tyre

E. Gjithashtu në studim janë analizuar edhe kufizimet sociale që i privojnë grupet e veçanta demografike në sferën private dhe publike dhe që potencialisht e rrisin dhunën në familje

- Strukturat tradicionale të pushtetit brenda familjes
- Dhuna mbi baza gjinore kundër fëmijëve, e bazuar në traditë
- Mungesa e aksesit ndaj shkollimit
- Rolet gjinore diskriminuese dhe praktikat e punësimit
- Diskriminimi në posedimin e pronësisë dhe trashëgimisë

Metodat e Kampionimit

Ky studim iu nënshtrua përzgjedhjes së një metodologjie të gjerë të kampionimit për shkak se duhet të përfshiheshin dy grupime të ndryshme të targetuara: qytetarët dhe viktimat e dhunës në familje.

- a. Përzgjedhja e kampioneve të viktimave apo të mbijetuarave të dhunës në familje, të cilat në momentin e kryerjes së këtij vëzhgimi përdornin të paktën një nga shërbimet e mundshme të mbështetjes ndaj dhunës në familje.

Të mbijetuarat e dhunës në familje, të cilat përdornin të paktën një nga shërbimet mbështetëse të mundshme ndaj dhunës në familje u përzgjodhën me mbështetjen/këshillimin e psikologeve apo punonjësve socialë të ofruesve të shërbimit/strehëzave dhe njësisive kundër dhunës në rajonet e policisë, duke marrë parasysh numrin e atyre që ishin në këto qendra apo institucione për marrjen e shërbimeve përgjatë kohës në të cilin u krye ky vëzhgim (Mars - Prill 2013). Rreth 4 - 7 të mbijetuarat të dhunës në familje u intervistuan për secilën nga qendrat e ofrimit të shërbimeve. Në total u intervistuan 155 të mbijetuarat të dhunës në familje.

Grupi i Synuar i të Anketuarve

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Qytetar/e	405	72.3	72.3	72.3
Viktimë e dhunës në familje	155	27.7	27.7	100.0
Total	560	100.0	100.0	




Figure 1:

b. Përzgjedhja e kampionit të qytetarëve:

Kampioni për qytetarët u hartua bazuar mbi bazën e të dhënave të Taksapaguesve Familjarë të dymbëdhjetë qarqeve të targetuara, duke synuar një përfaqësim sa më të gjerë. Kjo bazë të dhënash përfshin si mbulimin e sipërfaqes gjeografike të grupeve ashtu dhe numrin e familjeve për atë grupim.

Pesë grupe kampionimi u përzgjedhën në secilin nga qytetet e targetuara për të kryer intervista. Në secilën nga pikat e kampionimit intervistuesit kryen katër intervista. Të intervistuarit u përzgjedhën mbi bazën e këtyre kritereve:

- 18 vjeç ose më shumë (duke përfshirë dhe të moshuarit); kishin ditëlindjen e parë ose të fundit në familje;

- një banor i përhershëm i familjes që jetonte atje pavarësisht faktit nëse ai/ajo ishte e regjistruar diku tjetër nga pikëpamja administrative; jo një emigrant, ushtar apo person me studime jashtë vendit;
- Të intervistuar në mënyrë individuale pa bezdisje apo sugjerime nga dikush tjetër. Intervistat kryheshin në atë moment që konsiderohej si më e përshtatshme për të dyja palët (intervistuesin/en dhe të intervistuarit). Në rast se njerëzit shoqëroheshin nga të tjerë, ata intervistoheshin veçmas.
- Një larmi e gjerë për sa i përket nivelit të tyre arsimor.

Disagregimi gjinor i kampionit

Gjinia

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Mashkull	94	16.8	16.8	16.8
	Femër	466	83.2	83.2	100.0
	Total	560	100.0	100.0	




Figure 2:

“Studim për viktimat e krimit të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale”

Qyteti * Gjinia Crosstabulation

		Gjinia		Total
		Mashkull	Femër	
Qyteti	Qarku i Beratit	2	31	33
	Qarku i Dibrës	5	28	33
	Qarku i Durrësit	9	24	33
	Qarku i Elbasanit	7	27	34
	Qarku i Fierit	2	31	33
	Qarku i Gjirokastrës	3	30	33
	Qarku i Korçës	2	32	34
	Qarku i Kukësit	7	26	33
	Qarku i Lezhës	7	25	32
	Qarku i Shkodrës	5	28	33
	Qarku i Tiranës	42	153	195
	Qarku i Vlorës	3	31	34
Total		94	466	560




Figure 3:

Në nivel kombëtar 83.2% e intervistuesve janë femra. Ky raport është i qartë me pothuajse të njëjtën përqindje në të gjithë "Qarqet". Kjo tregohet në figurën 2 dhe 3.

Kampioni/modeli i Qytetit të Targetuar

Sikurse u përmend më lart, vëzhgimi u krye në dymbëdhjetë qarqe si: Tiranë, Durrës, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë, Elbasan, Berat, Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër dhe Fier. Afërsisht, arritën të *kryheshin* 32-34 intervista në secilin qark, me përjashtim të qarkut të Tiranës me 194 intervista, të cilat në total përbëjnë 560 intervista.

Përgatitja e Punës në Terren

Ne mblodhëm të dhënat e nevojshme në të gjithë qarqet e targetuara. Ndërkohë, një sesion trajnimi u krye në fund të Shkurtit 2013. Gjatë këtij trajnimi, dymbëdhjetë intervistues u prezantuan me qëllimin e vëzhgimit, udhëzimet për metodën e kampionimit, metodën e intervistimit; dhe një prezantim hap pas hapi i pyetësorit. Trajneri përdori metoda interaktive të tilla si leximi, pyetjet dhe diskutimet, shpjegimet e metodës së kampionimit si dhe lojë me role me situata reale intervistimi. Çdo pjesëmarrës kishte shansin të përfshihej dhe të merrte pjesë në mënyre aktive.

Në ditën e trajnimit, çdo intervistues u pajis me paketën e punës në terren, e cila përfshinte:

1. Kopje të pyetësorit (numri serial i intervistës është përfshirë),
2. Listë e ofruesve të shërbimeve (qendrat këshillimore dhe strehëzat) të cilat operojnë në qytetet e targetuara duke përfshirë edhe pikat e nevojshme të kontaktit.
3. Listë e emrave të kontaktit të punonjësve të njësive kundër dhunës në familje pranë rajoneve të policisë nëpër qarqe.
4. Udhëzues të shkruar për kampionimin dhe intervistimin.

Kontrolli logjik dhe Verifikimi

Në momentin kur puna në terren e secilit intervistues u plotësua dhe numri i synuar i intervistave u plotësua, pyetësorët ishin subjekt i procesit të verifikimit. Procesi në vetvete konsistonte në një përzgjedhje të rastësishme të pyetësorëve. Mesatarisht, 25% e pyetësorëve u verifikuan nëpërmjet një telefonate me të intervistuarit. Dy persona ishin të përfshirë në kontrollin logjik dhe verifikimin e pyetësorëve.

Futja e të dhënave dhe Procedura e Pastrimit

Futja e të Dhënave ishte hapi vijues që pasoi kontrollin logjik. Programi kompjuterik që u përdor nga operatorët në futjen e të dhënave ishte SPSS Data Entry. Pas mbarimit të procesit të futjes së të dhënave u identifikuan mospërputhje ndërmjet të dhënave që kishte baza e të dhënave. Më pas, ju rikthyem edhe një herë pyetësorit dhe verifikuam opsionin korrekt të përgjigjes. Pas kësaj procedure, baza e të dhënave u konvertua në një dosje SPSS dhe u analizua.

Niveli i informacionit në lidhje me çështjen e dhunës në familje në Shqipëri.




Figure 4

Një pjesë e mirë e njerëzve të intervistuar nuk kishin informacion mbi kuadrin ligjor që i mbron ata nga dhuna dhe shumë të tjerë nuk kishin besim se ligjet në fuqi mund t'i mbronin ata. Kjo është më e dukshme në rajone si Gjirokastra, Vlora, Korca dhe Lezha. Ata besonin se ishin të vetëm në luftën kundër dhunës dhe të intervistuarat femra shpesh herë ndjeheshin fajtoare për këtë. Të dhënat e grumbulluara tregojnë se në përgjithësi jo vetëm të dhunuarat kanë shumë pak informacion për legjislacionin në fuqi, madje edhe kur ata janë të ndërgjegjshëm për këtë sërish kanë mungesë besimi. Shumica e viktimave të dhunës në familje dalin në gjyq pasi kanë përjetuar të paktën një herë një shkelje të zbatimit të ligjit për mbrojtjen e tyre nga abuzuesi. Kur ato e kuptojnë se dhuna nuk ndalon ato zakonisht adresohen drejt gjykatave për t'u divorcuar. Shumë të tjera përballen me çmime të larta që ju kërkojnë avokatët dhe gjykatësit nëpërmjet shërbimit të ofruar nga psikologët. Në këtë situatë, ato vendosin të tërhiqen përpara se të divorcohen dhe vazhdojnë të durojnë dhunën dhe pasojat e saj për të gjithë familjen.

Për më tepër, të dhënat tregojnë se shoqëria shqiptare ka shumë pak dijeni për mënyrat e parandalimit të dhunës në familje. Dhe kjo është një pasojë e injorancës mbi kuadrin ligjor.

Instrumente për marrjen e informacionit në lidhje me dhunën në familje në Shqipëri

Mënyrat më të rëndësishme për të marrë informacion në lidhje me dhunën në familje janë nëpërmjet: Radio/TV (51.%) dhe rrjetet sociale (13.6%). Mjetet më pak të përdorura për të marrë informacion mbi rastet, legjislacionin dhe pasojat e dhunës në familje janë fushatat e ndërgjegjësimit dhe media on-line. Shumica e të intervistuarve (78.7%) nuk merrnin pjesë në aktivitete që kishin në fokus çështje të dhunës në familje.

“Studim për viktimat e krimit të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale”




Figure 5:

Tabela 1:

Qyteti * Sa informacion keni ju në lidhje mënyrat e parandalimit si dhe të luftës kundër dhunës në familje?

Qyteti		Sa informacion keni ju në lidhje mënyrat e parandalimit si dhe të luftës kundër dhunës në familje?							Total
		Aspak	Pak	Disi	Mjaftueshëm	Shumë	Ndoshta/Refuzoj /Asnjë nga sa më sipër	99	
Qyteti	Qarku i Beratit	Count: 3 % of Total: .5%	Count: 13 % of Total: 2.3%	Count: 7 % of Total: 1.3%	Count: 6 % of Total: 1.1%	Count: 4 % of Total: .7%	Count: 0 % of Total: .0%	Count: 0 % of Total: .0%	Count: 33 % of Total: 5.9%
	Qarku i Dibrës	Count: 11 % of Total: 2.0%	Count: 9 % of Total: 1.6%	Count: 9 % of Total: 1.6%	Count: 3 % of Total: .5%	Count: 1 % of Total: .2%	Count: 0 % of Total: .0%	Count: 0 % of Total: .0%	Count: 33 % of Total: 5.9%
	Qarku i Durrësit	Count: 8 % of Total: 1.4%	Count: 15 % of Total: 2.7%	Count: 7 % of Total: 1.3%	Count: 1 % of Total: .2%	Count: 2 % of Total: .4%	Count: 0 % of Total: .0%	Count: 0 % of Total: .0%	Count: 33 % of Total: 5.9%
	Qarku i Elbasanit	Count: 5 % of Total: .9%	Count: 14 % of Total: 2.5%	Count: 8 % of Total: 1.4%	Count: 2 % of Total: .4%	Count: 5 % of Total: .9%	Count: 0 % of Total: .0%	Count: 0 % of Total: .0%	Count: 34 % of Total: 6.1%
	Qarku i Fierit	Count: 3 % of Total: .5%	Count: 13 % of Total: 2.3%	Count: 7 % of Total: 1.3%	Count: 6 % of Total: 1.1%	Count: 4 % of Total: .7%	Count: 0 % of Total: .0%	Count: 0 % of Total: .0%	Count: 33 % of Total: 5.9%
	Qarku i Gjirokastrës	Count: 8 % of Total: 1.4%	Count: 14 % of Total: 2.5%	Count: 8 % of Total: 1.4%	Count: 1 % of Total: .2%	Count: 0 % of Total: .0%	Count: 1 % of Total: .2%	Count: 1 % of Total: 2%	Count: 33 % of Total: 5.9%
	Qarku i Korçës	Count: 4 % of Total: .7%	Count: 16 % of Total: 2.9%	Count: 4 % of Total: .7%	Count: 6 % of Total: 1.1%	Count: 2 % of Total: .4%	Count: 1 % of Total: .2%	Count: 1 % of Total: .2%	Count: 34 % of Total: 6.1%
	Qarku i Kukësit	Count: 11	Count: 11	Count: 7	Count: 1	Count: 3	Count: 0	Count: 0	Count: 33

“Studim për viktimat e krimit të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale”

	% of Total	2.0%	2.0%	1.3%	.2%	.5%	.0%	.0%	5.9%
Qarku i Lezhës	Count	11	11	7	1	2	0	0	32
	% of Total	2.0%	2.0%	1.3%	.2%	.4%	.0%	.0%	5.7%
Qarku i Shkodrës	Count	11	9	9	3	1	0	0	33
	% of Total	2.0%	1.6%	1.6%	.5%	.2%	.0%	.0%	5.9%
Qarku i Tiranës	Count	42	87	44	5	17	0	0	195
	% of Total	7.5%	15.5%	7.9%	.9%	3.0%	.0%	.0%	34.8%
Qarku i Vlorës	Count	8	14	9	1	0	1	1	34
	% of Total	1.4%	2.5%	1.6%	.2%	.0%	.2%	.2%	6.1%
Total	Count	125	226	126	36	41	3	3	560
	% of Total	22.3%	40.4%	22.5%	6.4%	7.3%	.5%	.5%	100.0%

Të dhënat e mbledhura tregojnë se 30% e të intervistuarve nga grupi i qytetarëve dhe 31.3% e të intervistuarve nga grupi i viktimave të dhunës në familje kanë “Pak” ose “Aspak” informacion në lidhje me mënyrat e parandalimit si dhe të luftës kundër dhunës në familje. Gjithashtu 6.4% e të intervistuarve nga grupi i qytetarëve dhe 7.3% e të intervistuarve nga grupi i viktimave të dhunës në familje pohojnë se kanë “shumë” informacion” në lidhje me këtë çështje.

Marrëdhënia gjinore dhe jeta familjare - *A ka të drejtë burri ta godasë gruan?*

“Shumica e burrave shqiptarë nuk i vlerësojnë gratë. Ata i shohin gratë si sklave, të cilat duhet të kujdesen për fëmijët, për shtëpinë, të bëjnë gjithë punët dhe kaq.”

Djana, 22 vjece, e divorcuar, nënë e një fëmije

Shumë gra flasin me hidhërim mbi pritshmëritë e tyre dhe shpresat që kishin për martesën dhe mënyrën se si ato bien në kontradiktë me realitetin e jetës së

përditshme. Oriola, një avokate 40 vjeçare e divorcuar, thotë: *“Unë prisja që martesë ime të ishte e ngjashme me atë të prindërve të mi, por fatkeqësisht unë gjeta një tjetër model. Ai kishte modelin e prindërve të vet. Ai ishte rritur në një familje të dhunshme. I ati abuzonte me nënën e tij dhe ai donte të bënte të njëjtën gjë me mua.”* Sikur gjithë gratë në kultura të tjera patriarkale, gratë shqiptare janë mësuar të jenë të nënshtruara, pasive, të varura dhe të bindura ndaj meshkujve. Nëse ato nuk binden, për meshkujt është më se e pranueshme të përdorin dhunën për t’i disiplinuar ato dhe për t’i mbajtur nën kontroll. Ja si e shpjegon Afërdita, një fermere: *“Kur unë u martova, nëna ime më këshilloi: “Bëj kujdes, ai është burri yt tani dhe ndonjëherë mund të të bërtasë, ndonjëherë madje edhe mund të të qëllojë. Edhe mikeshat e mia më thanë të njëjtën gjë. Në fillim, ne shkonim mirë me njëri tjetrin. Unë isha 20 vjeç kur u martova dhe ai gjithmonë më bënte komplimenta dhe më thoshte fjalë të ëmbla për sytë e mi. Por, dy vjet më vonë, kur unë ende nuk kisha ngelur shtatzënë, ai filloi të më bërtiste: “Do bësh fëmijë ti apo jo? Se nuk u martova për sytë e tu unë.” Unë ndjehesha keq dhe vetëm qaja.”* Një mësuese në Tiranë, 31 vjeçe dhe e divorcuar mori të njëjtën këshillë nga nëna e saj: *“Unë mësova nga nëna ime se duhet të isha e bindur ndaj burrit tim. Babi im përfaqësonte modelin mashkullor të kokëfortësisë dhe tipareve gjaknxehta. Burri im, për t’i treguar të atit të vet se ishte ai që udhëhiqte marrëdhënien tonë, filloi të më bërtiste, duke abuzuar me mua dhe arriti sa merrte çdo lloj vendimi për çdo lloj gjëje pa më pyetur fare. Këtu në Shqipëri tradita e kërkon që problemet të zgjidhen me sherre dhe terror.”* Besëtytninë kulturore në lidhje me nënshtrimin si dhe për familjen, traditat popullore dhe normat mbizotërojnë mbi të drejtat e individit.

Ja si e përshkruan Lira një mësuese e papunë: *“Burri im është me universitet, por problemi qëndron se ai vjen nga një familje tradicionale ku gruaja duhet të jetë e nënshtruar ndaj burrit, ndërsa burri duhet të jetë - i plotfuqishëm dhe arrogant.”* Në këtë traditë, gratë kanë më shumë detyrime se të drejta. Brisida, një punëtoreshë nga Shkodra, thekson: *“Ky është zakoni që kanë kosovarët. Gruaja duhet t’i lajë këmbët burrit sapo ai të hyjë në shtëpi, t’i shtrojë për të ngrënë ndërsa ai rri shtrirë dhe sheh TV. Ai nuk duhet të shqetësohet nga fëmijët. Gruaja nuk ka të drejtë të pyesë burrin e vet se ku ka qenë, çfarë ka bërë dhe nëse ka sjellë ndonjë lek në shtëpi apo jo. Për të ruajtur zakonet mua mu desh t’i nënshtrohem të gjitha këtyre rregullave. Unë s’kisha të drejtë të shkoja asgjëkund, të vishesha mirë apo të përdorja makijazh. Edhe kur bëja dush para se të shkoja në punë, ai do më pyeste “E përse bëre dush ti?”*





Figure 6:



47.2% e qytetarëve të intervistuar dhe 42.6% e viktimave të intervistuar mendojnë se legjislacioni në ndihmë të viktimave të dhunës në familje nuk zbatohet. Ndërsa 1.7% e qytetarëve të intervistuar dhe 7.7% e viktimave të intervistuar mendojnë se ky legjislacion zbatohet. 47.2% e qytetarëve të intervistuar dhe 42.6% e viktimave të intervistuar mendojnë se ky legjislacion nuk zbatohet.

Informacion i cunguar për dhunën familjare

Një seri pyetjesh të anketës kanë dashur të kuptojnë nëse format latente të dhunës në familje, ato që në një farë mënyre pranohen pjesërisht edhe nga opinioni i gjerë shoqëror, sidomos nga ai konservator, janë më pak ose më shumë të shenjuar kështu edhe prej individëve të ndryshëm.

Pyetjes : "Ndonjëherë a është në rregull që burri të godasë gruan e tij?", 79,1 % e të anketuarve përgjigjen prerë se kjo nuk është aspak e rregullt. Duket si një shifër pozitive dhe pjesërisht kështu është. Por, një analizë e saktë e saj do të na tregojë se rreth 18% e të anketuarve mendojnë se burri edhe mund ta godasë gruan e tij pavarësisht se disa përgjigjen se "janë dakord", "dakord deri diku", ose ka edhe nga ata që shprehen se "janë kundër deri diku" përsëri e lënë një shteg hapur për një dhunë "natyrore" të burrit ndaj gruas në raste të caktuara.

Pra, pothuajse një ndër pesë të anketuar nuk merr një qëndrim të prerë kundër çdo forme dhune, goditjeje fizike, etj., ushtruar nga bashkëshorti kundër gruas së vet. Këtu është fjala për goditje fizike, sepse për forma më të "lehta" dhunimi, natyrshëm që pranueshmëria do të kishte qenë edhe më e lartë.

Të intervistuarit e këtij studimi tregojnë për një opinion në lidhje me këtë çështje, i cili është sqaruar si vijon:




Figure 7:

Pjesa më e madhe e atyre që janë intervistuar nuk binin dakord me faktin që burri duhet ta rrahë gruan e tij. Por nga ana tjetër, të dhënat e mbledhura tregojnë se në disa zona të Shqipërisë ende konsiderohet si shumë normale që burri duhet ta rrahë gruan e vet, kjo është evidente madje edhe në Tiranë, ku megjithëse ka pasur shumë ndërhyrje për të ndërgjegjësuar publikun e gjerë, ky mentalitet ekziston akoma. Arsyeja përse kjo është e pranishme edhe në Tiranë vjen sepse Tirana është produkt i një migracioni të brendshëm dhe është populluar gjerësisht nga një numër banorësh që vijnë nga zona shumë të thella dhe malore të vendit. Nga ana tjetër është mëse e qartë se ligji kundër dhunës në familje nuk zbatohet ashtu siç duhet në Shqipëri.

Të mos heqim nga vëmendja se pjesa dërmuese e të anketuarve janë gra dhe vajza, çka përbën një publik më kritik ndaj dhunës në familje. Ndoshta, shifra do të kishte qenë më e lartë nëse numri i burrave të anketuar do të kishte qenë më i rëndësishëm. Problemi qëndron te fakti se edhe një pjesë e grave e kanë ndërgjegjësuar ushtrimin e dhunës mbi to si një fakt të natyrshëm, i cili sipas tyre bën pjesë në logjikën e ligjet e jetës bashkëshortore.

A është e saktë kjo e dhënë ? Sipas anketës sigurisht. Por, edhe po të nisemi nga një arsyesim më i përgjithshëm, dihet natyra patriarkale e vlerave kulturore shqiptare në traditat e tyre të hershme që mbijetojnë ende sot. Burri ende në shoqërinë tonë konsiderohet si më i pushtetshëm dhe garant i nderit dhe i sjelljes së mirë të femrave të familjes së vet.

Por, problemi nuk duhet menduar se lidhet vetëm me traditat shoqërore të së kaluarës në raportet burrë - grua. Në një farë mënyre dhuna latente shprehet edhe në traditën që e përcakton në një mënyrë të diskriminuar rolin dhe statusin e gruas në familje. Gruaja si personi që mban në mënyrë të pabarabartë peshën e lodhjes së punëve të shtëpisë dhe i shërben pjesës tjetër të familjes, edhe ky fakt, shpesh pranohet si i natyrshëm te një pjesë e shoqërisë. Është një dhunë e heshtur që mban në një pozitë nënshtrimi gruan në familje.

Sigurisht gjërat kanë nisur të ndryshojnë si rezultat i shumë faktorëve që vijnë nga emancimi dhe liberalizimi i zakoneve në kushtet e proceseve demokratizuese, por edhe tradita vazhdon të ruajë efektet e saj. Dhuna latente e paperceptueshme nga një pjesë e publikut është ajo edhe më e shtrira. Pyetjes : "Nga nuset pritet që të kenë më tepër përgjegjësi për pastrimin dhe përgatitjen e ushqimit sesa nga antarët e tjerë të familjes?", të anketuarit, në masën prej vetëm 28% të tyre, shprehen se "nuk janë aspak dakord". Pjesa tjetër, në një përmasë fort të konsiderueshme mendon se nuk ka ndonjë çudi që nuset ta kenë këtë barrë mbi supe në krahasim me pjestarët e tjerë të familjes. Kjo pozitë e nënshtruar e nuseve, nuk është pra vetëm në raport me pjesën mashkullore të familjes së burrit, por edhe me pjesën femërore të saj.

Anketa dëshmon edhe për një banalizim të fenomenit të dhunës në shoqëri, pra edhe të asaj që quajmë dhunë familjare. Me banalizim të dukurisë së dhunës kuptojmë besimin kolektiv se shoqëria e ka si bashkëshoqëruese të pashmangshme dhunën. Kuptohet se kjo vjen në një shoqëri që pasi doli nga një regjim pesë dekadash bazuar në "luftën e klasave", përjetoj edhe drama të mëdha sociale, shpesh të dhunshme edhe në këto vite të tranzicionit demokratizues. Pranimi i fatalitetit të dhunës në shoqëri jo vetëm e rrit praninë e saj në familje, por ul ndjeshëm edhe shkallën e raportimit të saj publik dhe rezistencën ndaj dukurive të dhunës në familje.

Pyetjes : "A është dhuna pjesë normale e cilësdo marrëdhënie shoqërore?", vetëm 21,6 % e të anketuarve i përgjigjen kategorikisht "jo". Pjesa tjetër nuk është e bindur ndryshe. Veçojmë se 34,1% e të anketuarve pohojnë se dhuna është pjesë normale e dukurive shoqërore. "Normaliteti i dhunës" është një

besim kolektiv që del në pah nga analiza e anketës sonë.

E tillë është edhe ideja se gruaja është një objekt që me ose pa pëlqimin e saj është aty për të kënaqur, qoftë edhe pavarësisht dëshirës së saj, energjitë erotike të bashkëshortit. Pyetjes : "A mund të konsiderohet si dhunë marrëdhënia seksuale, edhe nëse kjo kryhet kundër vullnetit të njerit nga partnerët?", 49,8% e të anketuarve përgjigjen qartazi se kjo është një formë e dhunshme marrëdhëniesh seksuale. Pjesa tjetër varion nga ata që mendojnë krejt të kundërtën (15,4%) mendojnë se deridiku mund të mos quhet akt i dhunshëm (11,1%), deri te ata që e quajnë "deridiku" akt të dhunshëm, por hezitojnë të marrin një qëndrim të prerë (17%).

Problemi kulturor i pranueshmërisë së fatalitetit të dhunës latente nuk lidhet thjesht si duket vetëm me traditat. Ka edhe dukuri të reja që e nxisin.

Dihet përshembull se në familjet e sotme rolet familjare dhe funksionet sociale të partnerëve janë bërë shumë më fleksibël sesa më parë. Kjo sjell edhe negociimin e funksioneve dhe të çështjeve midis partnerëve. Në një farë mënyre familja është bërë një hapësirë diskutimi që shpesh është tepër e nxehtë sepse ka të bëjë me të drejtat dhe detyrat e gjithësecilit në jetën e përditshme. Kjo sjell edhe dhunë verbale, por shpesh edhe kjo gjendje degjeneron drejt akteve të dhunës fizike. Është një kulturë dialogu familjar, sidomos në çiftet relativisht të reja në moshë të cilat ende nuk e zotërojnë si duhet si në planin racional ashtu edhe përsa u përket strategjive dhe teknikave psikologjike të administrimit të dialogut familjar.

Pyetjes : "Eshtë e natyrshme që dhuna fizike ndodh ndërmjet çifteve kur ata debatojnë?", 55,2% e të anketuarve mendojnë se nuk është aspak e pranueshme dhe e natyrshme. Por, pjesa tjetër ose heziton të japë një përgjigje të prerë, ose edhe e quan disi të natyrshme që debati të degjenerojë në dhunë fizike (12,9%).

Ka edhe një psikologji ku të moshuarit konsiderohen si barrë për familjet urbane, sidomos ato të reja. E kjo nuk mungon të shoqërohet edhe me një lloj neglizhimi, në mos braktisjeje, apo edhe çfaqje braktisje apo dhune verbale, keqtrajtuesh dhe dhunë fizike ndaj disa të moshuarve. Pyetjes : "A janë njerëzit e moshuar barrë për familjen?", 11,1% e të anketuarve shprehen se ata janë të tillë ose deridiku janë barrë për ta. Është një dukuri relativisht e re për familjen shqiptare kjo e fundit sepse në kushtet e familjes rurale dhe klanore, statusi dhe pozicioni social i të vjetërve ishte krejtësisht i veneruar simbolikisht.

Boshllëku gjinor në Rolet në Familje

Një variabël që është lidhur me abuzimin në çift ka të bëjë me sjelljet tradicionale në rolet që marrin individët në familje. Studimi tregon se abuzimi në marrëdhëniet midis partnereve ka më shume gjasa të ndodh dhe të vazhdojë aty ku çifti, sidomos burri shfaq sjellje tradicionale në rolet e familjes (p.sh. bashkëshorti sjell të ardhurat në familje, bashkëshortja kujdeset për shtëpinë dhe fëmijët).

Në mënyre tipike, burrave ju jepet relativisht një mbretërim i lirë në një shoqëri patriarkale për shkak se ata sigurojnë të ardhurat për familjen. Të tilla konkluzione janë konsistente me gjetjet tona, të cilat tregojnë se çdo bashkëshort apo partner i konsideron punët e shtëpisë si një eskuzivitet dhe përgjegjësi e gruas së tij. Altina, një nëpunëse civile nga Lezha dhe nënë e dy fëmijëve, e përshkruan mënyrën se si "ndahen" punët e shtëpisë në familjen e saj: *“Unë i bëj të gjitha në shtëpi. Detyrat e tim shoqi janë të shkoj në punë, të dalë çdo mbrëmje dhe të shtrihet”*.

Nga gratë pritet që të kujdesen dhe pastrojnë shtëpinë dhe të kujdesen për fëmijët dhe t'u tregojnë bashkëshorteve të tyre bindje dhe respekt. Teuta, një mësuese 31 vjeçare nga Tirana thotë: *“Sipas mendimit të burrit tim një femër duhet të jetë një grua shtëpie, të dijë të gatujë, të bëjë punët e shtëpisë, të ketë marrëdhënie të mira me familjen e burrit dhe t'i pranojë mendimet e të tjerëve, të jetë e ëmbël, e dashur, seksuale, tërheqëse dhe të plotësojë dëshirat e burrit të vet në çdo moment”*. Merita, një rrobaqepëse nga Tirana, nënë e dy fëmijëve, pranon rolet e saj tradicionale në shtëpi, edhe pse kjo nënkupton se duhet të lodhet trefish duke mbajtur barrën me të cilët përballet çdo ditë: *“Unë bëj gjithçka që duhet të bëj një grua. Pastroj, gatuj, kujdesem për fëmijët e mi. Burrin e kisha papunë por, gjithsesi ai kurrë nuk bëri ndonjë punë shtëpie. Ai asnjëherë nuk mendoi të bënte ndonjë gjë. Unë nuk prisja që ai të bënte ndonjë punë shtëpie gjithsesi, por kur mbaronte së ngrëni bukë të paktën mund të pastronte tavolinën për të më ndihmuar, sepse isha kaq e lodhur nga puna e përditshme dhe kujdesi për fëmijët.”* Nëse një burrë percepton se gruaja e tij në një mënyre ose në një tjetër ka dështuar me njërin nga rolet, ka kapërcyer kufijtë e saj apo ka sfiduar të drejtat e tij, atëherë ai mund të reagojë në mënyrë të dhunshme.




Figure 8:

Përjetimi i dhunës

“Pas muajit të parë të martesës tonë ai filloi të abuzonte me mua. Ai më gjuante me shpulla, me shqelma dhe më godiste me grusha, ma përplaste kokën pas murit. As vetë nuk e di se si t'i përshkruaj këto episode... Më gjuante shpesh në kurriz. Një herë më goditi kaq fort sa për një moment nuk po merrja dot më frymë. Për më shumë se një javë kisha dhimbje. As nuk kollitesha dhe as nuk merrja dot frymë. Madje një herë provoi të më mbyste dhe më goditi me një objekt të fortë derisa filloi të më dilte gjak. Unë nuk mund të therrisja sepse nuk doja që ta dëgjonin fëmijët. Fëmijët u frikësuan shumë, kështu që i mora me vete dhe ika nga shtëpia. Ne e kaluam natën jashtë dhe u kthyem në shtëpi pasi ai kishte ikur në punë. Kur u kthye nga puna vazhdonte të më shante e mallkonte se përse isha akoma aty. Ai donte që unë të ikja nga shtëpia, po unë s'kisha ku të shkoja të futja kokën. Mendova se gjërat mund të përmirësoheshin, por ai acarohet sa herë që më shikonte. Edhe pse mundohesha dhe bëja sa mundja, të sillesha mirë me të, atij nuk i bëhej vonë fare për këtë.”(Bardha, 42 vjece, teknikene nga Tirana, e martuar dhe nënë e pesë fëmijëve).

Dhuna e burrave ndaj grave zakonisht karakterizohet nga privatësia, ç’ka nënkupton se ajo ka tendencën të shmangë praninë e një vëzhguesi të jashtëm. Dëshmitë e grave provojnë se abuzimi është një fenomen kompleks, sepse ai përfshin forma të ndryshme, që variojnë nga turpi deri tek izolimi, prostituimi i detyruar, seksi i dhunshëm dhe rrahja. Abuzimi në intimitet i partnerit është zakonisht pjesë e një sjelljeje abuzive dhe kontrolli më shumë se sa e një akti të izoluar agresioni fizik. Stela, një mësuese nga Tirana thotë: *“Ai e kishte zakon të më kërcëronte duke thënë se do të mi merrte fëmijët. Një herë unë i thashë se doja të divorcohesha. Ai erdhi dhe ma mori vajzën e ma largoi për një javë. A mund ta imagjinoni se çfarë kam ndjerë gjatë atyre ditëve? Unë isha shumë e frikësuar dhe nuk mund të vija gjumë në sy, ashtu sikur çdo nënë tjetër s’do mund ta bënte kur i mungon fëmija. Nuk e dija se ku e kisha vajzën. Dilja në orën 5 të mëngjesit nëpër rrugë duke e kërkuar. Vëllai im më ndihmoi. Lajmëruam policinë. Ndoshta ai kishte frikë nga policia dhe e solli vajzën në shtëpi.”* Evelina, një nënë e papunë e tre fëmijëve, kujton: *“Njëherë, kur isha 8 muajshe shtatzënë ai u kthye shumë vonë në shtëpi. Unë ndjehesha shumë e lodhur, sidomos nga shtatzania. U grindëm për një gjë fare të vogël. Unë nuk i kisha hekurosur këmbët ose pantallonat dhe ai u inatos me mua. Ndërsa i bërtisnim njëri-tjetrit, ai me qëllori me shpullë. Ajo ishte shuplaka e parë dhe që nga ai çast jeta ime ndryshoi. Ai vazhdoi të bënte të njëjtën gjë edhe për 15 vitet në vazhdim. Ai vazhdimisht më ofendonte dhe injoronte dhe pastaj më merrte në dhomën e tij me forcë për të më rrahur. Shpesh herë edhe fëmijët ishin prezent. Nëna e tij i nxirrte jashtë që ata të mos më shihnin duke qarë e bërtitur.”*

Abuzimi psikologjik

“Ne kishim dy vjet që ishim martuar dhe një ditë unë mendova se kisha ngelur shtatzënë. Por, një mëngjes mësova se në fakt nuk isha shtatzënë. Ai filloi të më kërcëronte: nëse nuk ngelesh dot me barre do të të kthej tek yt atë. Unë qava me dënësë..... Ai nuk u kthye në shtëpi atë ditë. Unë isha shumë e frikësuar dhe po e prisja. Kur u kthye vonë në darkë unë kisha frikë nga ai dhe po rrija në një cep të krevatit. Ai mu afrua dhe filloi të më përkëdhelte. Kështu u pajtuam përsëri. Kur ngela shtatzane ai ndaloi së më godituri. Arturi dilte çdo ditë. Kur unë e pyesja ku ishte gjithë ditën e ditës?, - ai zakonisht më përgjigjej me një zë të inatosur: Mos më merr mua në pyetje, se s’ta kam borxh të të jap shpjegime dhe pastaj filloi të më ofendonte. Ti je si jevgë, prandaj mbylle! Do të të dërgoj mbrapsht te jot ëmë, etj.” (Suela, 32 vjeçe, punëtoreshë nga Berati)




Figure 9:




Figure 10:




Figure 11:

“Ka shumë arsye që e shpjegojnë dhunën: e para, mungesa e hapësirave për të jetuar. Ne kishim dy dhoma e një kuzhinë dhe ishim në të njëjtën shtëpi me dy kunetërit, vjehrrin tim dhe tre fëmijët. E dyta, situata ekonomike, tranzicioni dhe mungesat e vendeve të punës në tregun e punës. Kur unë humba punën time, burri im filloi të pinte dhe të luante bixhoz. Pastaj ai filloi të ushtronte dhunë mbi fëmijët dhe mua. Mendoj se arsyeja kryesore për gjenerimin e dhunës është varfëria, kur nuk ka të ardhura, burri fillon të ushtrojë dhunë mbi gruan e tij. Pastaj vjen xhelozia dhe papunësia gjithashtu.” (Jonida, 40 vjeçe, e martuar me tre fëmijë, punëtoare nga Shkodra)

Zakonisht, një hap i rëndësishëm në marrjen e vendimit për të lënë një partner të dhunshëm është procesi i të kuptuarit të shkakut të abuzimit. Gratë ja atribuojnë dhunën në familje një sërë faktorësh: individualë (probleme psikologjike, përdorim i shpeshtë i alkoolit, apo xhelozia); konteksti familjar (kontrolli mashkullor mbi burimet e të ardhurave/financiare, mungesa e mjeteve ekonomike, konfliktet midis brezave); komuniteti (izolimi i grave dhe mungesa e mbështetjes sociale); normat kulturore (modeli mashkullor i lidhur me

ashpërsinë, nderi burrëror apo dominanca që legjitimon dhunën e burrave, rolet tradicionale gjinore të përcaktuara shumë ngushtë dhe të zbatuara, pranimi i dhunës si një mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërpersonale dhe perceptimi se burrat kanë "pronësinë" e grave); dhe faktorët socialë (stresi social, varfëria, papunësia). Edhe pse të intervistuarit identifikojnë një sërë shkaqesh të dhunës në familje dhe shumë nga këto shkaqe janë të përmendura dhe të ndërthurura, ato kanë tendencën të shpjegojnë abuzimin brenda diskursit që thekson ndryshimet e shpejta sociale që kanë ndodhur në Shqipëri që nga viti 1991. Dyzet e gjashtë gra (83%) e shohin dhunën si një problem social që buron nga një shoqëri ku mungojnë ekuilibrat, është e ngecur midis tradicionales dhe modernes. Disa burra nuk mundën t'i pranojnë e të mësohen me këto lloj ndryshimesh sociale dhe presione të reja. Kjo do të thotë se përgjegjësia për dhunën kthehet në një faktor të jashtëm nga shumë të intervistuar. Suzana, 34 vjeçe, e martuar dhe nënë e një fëmijë, punëtore në Tiranë, shpjegon: *“Është papunësia që shkakton këto probleme. Edhe nëse je i punësuar rrogat janë aq të ulëta, ndërsa çmimet janë aq të larta dhe është mëse normale që kjo gjë të krijojë probleme midis bashkëshortëve. Ka pasur shumë stres këtë dekadën e fundit. Gjysma e çifteve në Tiranë janë divorcuar.”* Të jetuarit në varfëri gjeneron stres dhe frustime dhe një ndjenjë të papëlqyeshme tek burrat për faktin se ata kanë dështuar të jetojnë me rolet e tyre të përcaktuara në mënyrë kulturore si "fitues së bukës së përditshme".

Burrat shqiptarë, të ngecur midis dy botësh dhe të kapluar nga stresi kanë humbur sensin e tyre të identitetit dhe vetëvlerësimit. Ata mund ta shohin shtëpinë e tyre si bastioni i fundit i autoritetit mashkullor. Frustrimet derdhen në shtëpi ku gratë dhe fëmijët janë kryesisht viktimat e rastit. Evis, 40 vjeçe, nënë e tre fëmijëve dhe punëtore në Shkodër, thotë: *“Unë mendoj se faktorët ekonomikë janë shkaktarë të dhunës në familje. Një situatë e mirë financiare e parandalon dhunën. Dhuna është plotësisht e shmangshme në rastet ku siguria financiare është e pranishme.”* Sikurse e përmendin edhe shumë gra të tjera, burrat thjesht nxjerrin mërzitjen dhe dhimbjen e grumbulluar nga konfrontimi me stresin shoqëror. Një grua e martuar, nënë e pesë fëmijëve, banorë në Tirane, shton:

“Situata e pasigurt ekonomike shkakton shumë probleme dhe shumë stres. Burrat fillojnë të pijnë, të dehen dhe të bëjnë skandale në shtëpi.” Një tjetër shkak i përmendur shpesh për dhunën në familje, përmend atë se çfarë bëjnë ata. *“Unë vërtet mendoj se gjëja e parë që mendojnë burrat shqiptarë kur ata zgjohen në mëngjes është të pijnë alkool. Unë mendoj se duhet nxjerrë një ligj që t'i ndalojë baret/lokalet të shërbejnë pije alkoolike që në mëngjes. Do të ishte më mirë të parandalonim shitjen e alkoolit sepse po shkatërrohen jetët e*

njerëzve. Unë kam jetuar me një të alkoolizuar për 12 vjet dhe mund t'ju them se ata vërtet nuk dinë seç bëjnë.” Sipas 16 të intervistuarve, xhelozia nga ana e agresorit mund të provokojë sjellje të dhunshme gjithashtu. “Ai ishte shumë xheloz. Ai ishte gati të fillonte një sherr në çdo moment. Ai arriti deri aty sa të më kërcënonte se do të mi priste pjesët e trupit me gërshërë,” tregon një grua e re 28 vjeçare, nënë e dy fëmijëve. Një tjetër nënë e martuar me tre fëmijë tregon: “Ai bëhej i dhunshëm kur bëhej xheloz, nëse unë vishesha bukur apo përdorja make-up kur dilnim bashkë. Unë asnjëherë nuk përpiqem të ndryshoj pamjen time tani, sepse kjo gjë mund të shkaktojë probleme. Ka pasur raste kur ai përdorte dhunë fizike mbi mua edhe për një keqkuptim fare të vogël.” Një tjetër grua, banore në Tiranë sjell një eksperiencë të ngjashme: “Në fillim fare ne kishim një marrëdhënie të mirë, ashtu si çdo çift normal, por shumë shpejt pas grindjeve dhe sherreve filloi dhuna. Arsyeja kryesore ishte xhelozia. Si rezultat i xhelozisë, unë u detyrova ta braktisja punën time. Ai madje më mbyllte brenda në shtëpi. Pastaj filloi të pinte dhe nuk hiqte dorë nga ky zakon, që e çoi në varësi ndaj alkoolit. Në këndvështrimin tim, alkooli dhe xhelozia janë shkaqet kryesore për sherret tona.” Tre gra ia atribuojnë dhunën e partnerëve të tyre faktorëve psikologjike. Në këtë drejtim dhuna familjare është ndërtuar si produkt i emocioneve jofunksionale, të tilla si depresioni dhe niveli i ulët i vetëvlerësimit. Ky fokus mbi shkaqet e dhunës në nivel individual përfshin një justifikim për aktet e dhunshme, akte që shkojnë përtej kontrollit të agresorit/dhunuesit. Dhunuesit si të tillë mendohet se janë në dëshpërim dhe veprojnë për shkak të problemeve emocionale dhe destrabilitetit mendor. Aktet e dhunës perceptohen si rezultat i derdhjes së ndjenjave të ankthit, frustrimit dhe inatit. Elona, 40 vjeçe, nënë e tre fëmijëve, thotë: “I shkreti burri im nuk e bën gjithë këtë gjë sepse ka dëshirë, por e bën nga dëshpërimi. Shumica e burrave i rrahin gratë për shkak të gjendjes së rënduar të depresionit, njësoj si dhe burri im.”

Një tjetër shkak për sjelljet e dhunshme u përshkrua nga të intervistuarat tona si "sjellje maço", e cila nënkupton që sipas mendimit të këtyre grave, burrat janë të dhunshëm thjesht sepse ata janë burra, si shpjegon një 42 vjeçare: “Burrat janë të dhunshëm nga natyra, prandaj s'mund të bësh asgjë për t'i ndryshuar. Për shtatë vjet u përpoqa të bëj diçka për të ndihmuar tim shoq, por ai vetëm sa u përkeqësua.” Një vajzë e re 22 vjeçare e divorcuar thotë: “Dhunën e ka në gjak.”

Një tjetër grua, me profesion farmacistë komenton: “Mendoj se arsyeja kryesore për ushtrimin e dhunës është egoja mashkullore dhe mungesa e tolerancës.” Kjo mënyrë e të kuptuarit të dhunës mashkullore është e bazuar në shpjegimet psiko-biologjike, sipas të cilave burrat janë ndërtuar nga natyra të jenë agresivë. Një

vajze 20 vjeçare e papunë nga Tirana, thotë: *“Burrave ju pëlqen të luftojnë për hiçmosgjë. Ata duan të bëjnë çdo gjë sipas mendjes dhe dëshirës së tyre dhe duan të jenë superiorë ndaj grave.”* Një tjetër grua e papunë nga Berati shpjegon: *“Unë mendoj se burrat janë lindur për të qënë të dhunshëm. Dhuna nuk mund të shpjegohet nëpërmjet situatës ekonomike apo faktorëve financiarë, për shkak se kur ai kishte para, ai sillej edhe më keq.”* Disa të intervistuar gjithashtu përmendën faktin se presioni nga njerëz të tjerë, të tillë si vjehrra, mund të çonin në një situatë dhune. Pasi kishin qënë në mënyrë të vazhdueshme të denigruara, tre gra filluan të fajësonin veten për abuzimin dhe dështimin e marrëdhënies së tyre. Ato shprehen besimin se ato ndoshta nuk kishin qënë mjaftueshëm bashkëshorte të mira; Silvana, një mësuese shkolle ndjeu se e kishte ajo fajin për abuzimin: *“Unë shpesh e konsideroja veten time fajtoresh. Unë kurrë nuk thashë ndonjë gjë dhe gjithmonë i kërkoja falje. Shpesh qaja gjithë natën. Pastaj, kuptova se nuk ishte vetëm faji im.”* Gra të tjera nuk mund të arrinin të kuptonin dhunën në familje, ashtu si Milva, e martuar dhe me dy fëmijë, thotë: *“Më vjen keq, sepse nuk e di se cilat janë arsyet që sjellin dhunë; unë thjesht jam e ndërjegjishme që dhuna ndodh, por nuk jam e aftë ta kuptoj arsyen përse.”* Manjola, 46 vjeçe, teknikene në Tiranë, deklaron: *“Shpesh herë pyes veten time se cilat janë arsyet për dhunën në familjen tonë, sepse çdo gjë kthehet në një arsye për të. Vetëm ai e di se përse sillet në atë mënyrë.”* Etleva, 23 vjeçe, e papunë, nga Shkodra shpreh një konfuzion të ngjashëm: *“Ja kam bërë shpesh vetes këtë pyetje, por asnjëherë nuk kam gjetur një përgjigje. Mendoj se ka më shumë të bëjë me natyrën e tij. Ai është një person i dhunshëm, se s'ka arsye tjetër. Ne jetojmë me dy fëmijët tanë dhe askush nuk na ndërhyr në jetën tonë. Kemi një situatë financiare normale, ai ka një punë.....por gjithsesi është edhe i dhunshëm.”* Kur gratë përpiqen të reflektojnë mbi dhunën dhe e shpjegojnë brenda kontekstit shqiptar, pjesa më e madhe i kthejnë faktorët sociale në të vetmin kuadër kryesor shpjegues. Gratë artikulojnë një të kuptuar sistematik të dhunës si një produkt i marrëdhënieve jofunksionale sociale në vend të individëve disfunksionale. Ata evokojnë varfëri, një shkallë të lartë të stresit social, një shoqëri të pabalancuar/jo të ekuilibruar, polaritet midis të pasurve dhe të varfërve, midis traditës dhe modernizmit. Dhuna e burrave mbi gratë përfaqësohet si një nga shumë sëmundje sociale. Pretendimi se burrat veprojnë dhunshëm për shkak të stresit tranzicional i përshkruan ata si viktimat të vërteta të ndryshimeve shoqërore/sociale. Për këtë arsye, natyra gjinore e dhunës nuk reflektohen në mënyrë konsistente. Fakti që dhuna në familje nuk është perceptuar realisht si një fenomen gjinor ka implikime serioze për programet e parandalimit të dhunës. Për të luftuar problemin e dhunës ndaj grave, është e detyrueshme të ndryshohet socializimi i burrave dhe grave në

mënyrë që të bëhen më të ndërgjegjshëm për diskriminimin gjinor që ekziston në Shqipëri.




Figure 12




Figure 13:

Të pyetur se cila është forma më e zakonshme e dhunës që ata/ato (të intervistuarit) njohin, shumica të përgjigjet abuzimi fizik e më pas vjen ai emocional, seksual dhe ekonomik. Gjithsesi, kjo tabelë tregon se pothuajse të gjithë të intervistuarit i njohin qartësisht format e dhunës në familje dhe jo vetëm kaq por identifikojnë edhe atë që mbizotëron më shumë sipas tyre (Figura 13).

Thyerja e Heshtjes

Heshtja në lidhje me dhunën në familje është sigurisht një mënyrë efektive për përforsimin e marrëdhënies midis burrit dhe gruas. Heshtja nuk është thjesht një shenjë viktimizimi, por një shenjë shtypjeje. Dhuna, shtypja dhe heshtja janë të lidhura në një tentativë për të mbajtur dominimin dhe kontrollin. Gjatë regjimit komunist, dhuna në familje ishte pothuajse e padukshme. Gratë e abuzuara nuk mund t’ja lejonin vetes të shfaqeshin e të bëheshin të dukshme. Nuk ekzistonin strehezat, qëndrat këshillimore, asnjë mbulim mediatik, asnjë ndihmë nga policia apo institucione të tjera shtetërore. Dalja nga errësira në lidhje me çështje të dhunës në familje është ende një proces i vështirë dhe i përzierë nga një stigmë e konsiderueshme. Shumë viktimat e dhunës në familje ende e mbajnë si sekret abuzimin e tyre. Por duke i thënë një tjetër qenieje njerëzore në lidhje me atë që të ndodh ty dhe trupit tënd është një mjet i fuqishëm për prishjen e velit që mbështjell dhunën në familje. Zbulimi i ngjarjeve sekrete të dhunës në familje është një katalizator i rëndësishëm për ndryshimin. Duke treguar historinë e abuzimit të tyre, pjesëmarrësit në këtë studim thyejnë heshtjen. Duke bërë dhunën intime të dukshme është një hap i rëndësishëm në sfidimin e hegjemonisë të abuzuesit. Megjithatë në vitet e fundit janë bërë ndryshime të rëndësishme në Shqipëri, vendi nuk ka arritur ende të çrrënjosë sjelljet e ngulitura mirë në lidhje me statusin e vartësisë së grave. Ja si thotë një 34 vjeçare, e martuar dhe me tre fëmijë: *“Në botë njerëzit flasin për të drejtat e njeriut. Kështu që, pse gratë në Shqipëri trajtohen si pronë e burrave? Ata duhet të flasin në lidhje me këtë gjë.”* Stela, një mësuese shkolle 31 vjeçe shton: *“Gratë duhet të ngrënë zërin e tyre që në momentin e parë që shfaqet dhuna, që në episodin e parë. Asnjë grua nuk duhet të pranojë dhunën, sepse nëse ajo e fal një herë dhuna do të vazhdojë përgjithmonë. Gratë duhet të afirmojnë personalitetet e tyre sepse ato nuk janë skllave, nuk janë të mira vetëm për të qënë shtëpiake, të mira vetëm për të bërë punët e shtëpisë apo për të lindur fëmijë.”*




Figure 14

Ende ekziston një opinion jo korrekt në vend, i cili penalizon më shumë viktimat e dhunës në familje. Pjesa më e madhe e të intervistuarve bien dakord se viktimat e dhunës në familje duhet të largohen dhe vendosen në një shtëpëz ose të çohen tek familja e saj e origjinës, ndërsa burri duhet të qëndrojë në shtëpi deri sa çështja të zgjidhet (Figura 14).




Figure 15

Pjesa më e madhe e të intervistuarve nga të dyja grupet: qytetarë (40.5%) dhe viktimat (54.2%) mendojnë se nëse ka dhunë në një familje, atëherë gruaja duhet të shkojë në një strehë të posaçme ose tek familja e saj, ndërsa burri duhet të qëndrojë në shtëpi derisa çështja të zgjidhet (Figura 15). Kjo vjen pjesërisht edhe nga fakti se në shumicën e rasteve gruas – viktimë e dhunës në familje në rast moslargimi i duhet të jetojë me familjarët e burrit.

Është për t'u shqetësuar nga fakti se 10% e të intervistuarve kanë dëgjuar anëtarë të familjes që i bërtasin çdo ditë njëri-tjetrit. Kjo tregon një përqindje shumë të lartë dhune ku ajo është vazhdimisht e pranishme, aty, çdo ditë. 18% dëgjojnë anëtarë të familjes duke bërtitur me njëri-tjetrin pothuajse çdo javë, kurse 27.5% çdo muaj (Figura 16).




Figure 16:

Familja si një mjedis i mbyllur

Dukuria e re në periudhën e tranzicionit është konsiderimi moral dhe ligjor i familjes si hapësirë private, autonome, e paprekshme, intimiteti i së cilës garantohet me ligj. Kjo përbën një të drejtë demokratike për individin sepse i siguron atij privatësinë dhe intimitetin familjar. Kjo vlerë sigurisht që shkelej me këmbë në periudhën totalitare kur partia në fuqi apo organizatat e masave ndërhyjnë në çështje të mirëfillta familjare dhe shpesh në mënyrë arbitrare.

Sikurse theksohet në literaturën e sotme sociologjike dhe politologjike, kjo situatë e re demokratike, ka edhe pasojat e veta negative që lidhen me rrezikun e kthimit të familjes në një mjedis disi të mbyllur ku syri i opinionit publik dhe i institucioneve që garantojnë të drejtat qytetare të mos mundet të penetrojë dot. Në këtë rast supozohet që burri në shtëpi fiton shpesh një pozicion të privilegjuar ndaj femrës, në kushtet e mungesës së veprimit të ligjit që siguron barazinë e stutuseve dhe të të drejtave.

A është e tillë, e mbyllur, familja shqiptare? Anketa tregon një sërë të dhënash të cilat e vërtetojnë këtë aspekt dhe që bëjnë që aktet e dhunës të mbesin të paraportuar, të kryhen në një mjedis opak, jashtë syrit të opinionit publik, dhe viktimat të mos gjejnë mbështetjen e duhur në shoqëri.

Familja i mban gati fshehur brenda saj dukuritë e dhunës sepse e konsideron të turpshme që komshinjtë dhe të afërmit t'i marrin vesh këto informacione. 78,6% e të anketuarve gjykojnë se është një turp, pra do të ishin të turpëruar në sytë e e fqinjëve, nëse akte dhune brenda familjes së tyre do të merreshin vesh prej tyre.



Figure 17:

Pyetjes se "Cilat janë arsyet që viktimat nuk e denoncojnë dhunën ?", të anketuarit u përgjigjën në këtë mënyrë : 30,7% shprehen se kanë frikë nga hakmarrja. Dhunuesi mund të bëhet edhe më i dhunshëm nëse merr vesh se viktima është rrëfyer te të tjerët për çfarë ka pësuar. Turpi ndaj të tjerëve është gjithashtu një faktor që e mbyll dhunën në familje brenda mureve të saj. 25% e të anketuarve mendojnë se është ky faktor që e ben viktimën të mos denoncojë. 21,4% gjykojnë se viktima nuk ka besim se rrëfimi i gjendjes së vet te ofruesi i shërbimit mund të sjellë ndonjë ndryshim pozitiv për të (Figura 17).

Duhet patur parasysh se përmbyllja në vetvete e familjes shqiptare jo vetëm e rrit mundësinë e dhunës brenda saj, por edhe se statistikat e raportuara të dhunës në familje nuk tregojnë realisht nivelin e dhunës dhe duhen konsideruar disa herë më të larta sesa situata e raportimit të tyre, duke marrë në konsideratë të gjitha arsyet (Figura 18) që jepnin të intervistuarit se pse nuk e denonconin dhunën.

Edhe pse gjatë viteve të fundit është bërë shumë punë ndërgjegjësuese për të ndryshuar perceptimin e gabuar se dhuna në familje është një çështje private dhe jo një çështje e të drejtave të njeriut dhe e shëndetit publik, duhet shumë punë ende. Pyetjes : "A e konsideroni dhunën në familje si çështje private, apo një çështje të të drejtave të njeriut dhe e shëndetit publik,?" të anketuarit u përgjigjën në masën 54,4 % se e konsiderojnë një çështje private (Figura 18).




Figure 18:

Struktura e dhunës në familje

Anketa jep të dhëna edhe për strukturën e dhunës në familje, pra për format e shfaqjes së saj, për pasojat, orientimin e akteve të dhunës, (Figura 13), etj.

Edhe shpërndarja e dhunës në antarët e familjes ka një strukturë të caktuar. 41,6% e të anketuarve thonë se njohin femra si viktimat të dhunës sesa të anketuarit (3.6%) që shprehen se njohin meshkuj të tillë. Po ashtu, pjesa dërmuese e të anketuarve, 37,4% e tyre, pohojnë se të njohurit e tyre si viktimat të dhunës familjare janë midis moshës 19 dhe 50 vjeç. Pak më shumë se një e katërta e të anketuarve shprehen se të njohurit e tyre si viktimat të dhunës janë me arsim të mesëm.

Kjo e dhënë e relativizon shumë mitin se një nga shkaqet kryesore të dhunës është niveli shumë i ulët arsimor dhe kulturor i familjeve ku ka prani dhune në mënyrë të vazhdueshme dhe na pohon se dhuna nuk njeh nivel arsimor apo kulturor por është e pranishme.

Ndërkaq thuhet nga 39,8% e të anketuarve se viktimat e dhunës në familje janë të papunë. Por, kjo e dhënë nuk mund të merret sikur papunësia është një shkakësi lineare e dhunës, sepse shumë pjesë të popullsisë janë të papuna, por nuk kanë brenda tyre një histori të dhunës në familje. Një grua e papunë nuk dhunohet sepse është e tillë, por sepse marrëdhëniet në familje janë të tilla që prodhojnë dhunë.

Pasojat e dhunës sipas të anketuarve janë të ndryshme. 43,2% e tyre mendojnë se kryesore janë lëndimet fizike, 14,3% janë pasojat psikologjike, kurse faktorët e tjerë tërheqin shumë më pak të anketuar.

Dhuna seksuale

Dhuna seksuale, një nga më të paraportuarat në Shqipëri vjen në këtë studim për herë të parë si një formë e raportuar nga të pyeturit e sondazhit tonë dhe jo vetëm kaq, por e identifikuar si e treta në rradhën e dhunës që përjetohet nga publiku me 15,2% të të intervistuarve. Zyra e Statistikave të Drejtësisë në Departamentin e Shtetit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjeneron të dhëna vjetore për sulmet seksuale ndaj burrave e grave. Sipas studimit të fundit raporti

i sulmeve seksuale nga një partner intim ishte 1 me 1 mijë për gra mbi 12 vjec⁹.




Figure 19:

Në këtë studim dhuna seksuale përfshin të gjitha situatat ku gruaja detyrohet ose është e detyruar të marrë pjesë në një aktivitet seksual të padëshiruar ose të pasigurt (kjo përfshin seksin e detyruar nga ana e bashkëshortit/partnerit me të cilin gruaja kryen gjithashtu seks me pëlqimin e saj). E nisur pikërisht nga ky fakt, pothuaj një e treta e e të intervistuarve nuk mendojnë se kryeja e marrëdhënieve seksuale kur një prej bashkëshortëve apo partnerëve intimë nuk e dëshiron atë quhet dhunë. Kjo është një shifër tepër e lartë dhe duhet marrë me shumë seriozitet për t’u trajtuar në të ardhmen në lidhje me edukimin e popullsisë për këtë fakt të rëndësishëm. Është e rëndësishme të theksohet që dhuna seksuale në një marrëdhënie martesore apo bashkëjetese duhet të konsiderohet një formë serioze dhe mjaft e përhapur e dhunës në familje ndaj grave (31,4% e të intervistuarve). Studime të mëparshme ndërkombëtare në këtë fushë na tregojnë që dhuna seksuale në martesë apo bashkëjetesë në shumicën e rasteve ka pasoja të rënda për gruan, e për fat të keq këto pasoja zgjasin për një

⁹<https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/181867.pdf>

kohë të gjatë. 31,4% e të intervistuarve raportuan që kishin përjetuar dhunë seksuale apo marrëdhënie seksuale të padëshiruara me bashkëshortin/en, partnerin/en apo bashkëjetuesin/en dhe kjo tregon qartë se dhuna seksuale shpesh justifikohet brenda kontekstit të martesës përmes mentalitetit që i përcakton gratë si pronë e burrave ndërsa seksin si një detyrim martesor të bashkëshorteve, por në këtë rast shumë më tepër të gruas, pasi nga pjesa e të intervistuarve që kanë pranuar dhunën seksuale rezultatet tregojnë se në 29,5% të rasteve kjo ndodh mbi gratë dhe vajzat e vetëm 1,4% te burrat (Figura 20).




Figure 20:

Tabela tregon se dy janë grupmoshat më të mëdha për të përjetuar dhunë seksuale dhe respektivisht gratë dhe vajzat e moshës 25 deri 34 vjec me 12.7 % dhe gratë dhe vajzat e moshës 18 dhe 24 vjec me 9.1% (Figura 21). Nga këto 15.8% e të intervistuarve janë të martuar ose jetojnë me dikë, ndërsa 15.2% vijnë nga një marrëdhënie divorci.




Figure 21:

Të intervistuarit të parë nga niveli arsimor dhe punësimit, mund të thuhet se nuk kanë pasur ndryshime të mëdha bazuar në nivelin e arsimit të të pyeturve, sepse të intervistuarit e paarsimuar ose pak të arsimuar kishin po aq të ngjarë t'u ndodhte një marrëdhënie seksuale e padëshiruar sa edhe të intervistuarit me arsim të mesëm ose universitar. Përsa i përket nivelit të punësimit, të intervistuarit që kanë punuar jashtë shtëpisë kishin po aq gjasa sa edhe ata/ato nuk kishin punuar jashtë shtëpisë që të përjetonin dhunë seksuale nga bashkëshorti/ja, partneri/ja, bashkëjetuesi/ja.

Nga studimet provohet se përveç rreziqeve të mundshme nga probleme të rënda fizike dhe sëmundje seksualisht të transmetueshme, gratë dhe vajzat e dhunuara seksualisht ka shumë të ngjarë që të vuajnë edhe pasoja emocionale dhe psikologjike të rënda, sepse dhuna ndaj tyre në këtë rast ushtrohet nga një person që supozohet që të jetë një person i dashur, njeriu me të cilin ato kanë vendosur të ndajnë jetën e tyre.

Profili i viktimave te dhunes ne familje




Figure 22




Figure 23:




Figure 24:

Bazuar mbi të dhënat që tregojnë Figurat 22, 23 dhe 24 duket se shumica e njerëzve që kanë qenë viktimë e dhunës në familje i përket grupit që ka karakteristikat që vijojnë:

Femër e moshës 19-50 vjeç, me arsim të mesëm dhe e papunë.

Ku të drejtohet për ndihmë viktimat e dhunës në familje?

Opinionet e të anketuarve tregojnë se institucioni më i rëndësishëm në lidhje me dhunën në familje është Policia (38.2% e të anketuarve); OFJ-të që ofrojnë shërbime për dhunën (23.2 % e të anketuarve) dhe më pas vjen Gjykata (18% e të anketuarve) kurse 15.4% mendojnë se janë qendrat e kujdesit shëndetsor. Është zhgënjyesh fakti që vetëm 1,1% e të intervistuarve mendojnë se pushteti lokal është institucioni i rëndësishëm në këtë aspekt edhe pse ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i jep këtij të fundit rolin më të madh e më të rëndësishëm (Figura 25).





Figure 25:

Të ndarë sipas qarqeve, të intervistuarit në Tiranë përbëjnë shumicën e të anketuarve që kanë besim te policia (10% e të anketuarve), më pas vjen policia e qytetit të Korçës (4% e të anketuarve), ndërsa (3% e të anketuarve) besojnë policinë në Fier, Gjirokastrë, Kukës dhe Vlorë.



Në tabelën më sipër jepet besueshmëria që kanë te institucionet grupi i qytetarëve dhe ai i viktimave të dhunës në familje. Bie në sy se komuniteti i qytetarëve ka besimin më të madh te policia, kurse grupi i grave të dhunuara më shumë beson te OJF-të që ofrojnë shërbime dhe pastaj te policia.





Figure 26:



Në vazhdim të së njëjtës llogjikë me pyetjen paraardhëse, pjesa më e madhe e grupit të qytetarëve të intervistuar (50.1%) mendojnë se nëse ka dhunë personi duhet të kërkojë ndihmë tek policia ndërsa (67.1%) e viktimave mendojnë se duhet të kërkojnë ndihmë në ndonjë OJF të specializuar për këtë punë.

Në shumicën e rasteve kur fenomeni i dhunës në familje është raportuar institucioni Polici ka qenë i pari, i cili është bërë prezent në vendin e ngjarjes gjithashtu nëpërmjet të cilit është bërë edhe denoncimi. Më pas të dhënat e mbledhura flasin se institucioni tjetër mbështetës dhe në të cilin është referuar rasti është gjykata. 21-27% e të intervistuarve shprehen se dhunuesi është arrestuar ose dënuar (Figura 27).




Figure 27

Anketa ka dhënë një sërë gjetjesh lidhur me këtë çështje. 72,7% e të anketuarve shprehen se do t'i ishin drejtuar ligjit, dhe organeve ligjore, nëse do të ndiheshin të kërcënuar nga akte dhune ose do t'i kishin pësuar ato.

Policia ka besimin pothuajse më të madh se të gjithë operatorët e tjerë të anketuesit. 30,3% theksojnë se kanë konstatuar policinë që ka ndërhyrë kur

është raportuar rasti i dhunës. Shumë larg nga kjo shifër është numri i të anketuarve që mendojnë se viktimës i është dhënë ndihmë nga pushteti lokal. Vetëm 2,4% e tyre mendojnë në këtë mënyrë. Numri i të anketuarve që nuk kanë besim te policia në këto raste është gjithësesi i vogël, rreth 8,4% e tyre.

Pasojat e Dhunës ne Familje




Figure 28:

Një nga pasojat më të mëdha të dhunës në familje është lëndimi që e gjithë kjo dhunë i shkakton viktimës. Pas lëndimeve, viktimat përballet me probleme psikologjike për shumë të intervistuar.

Dhuna ndaj fëmijëve dhe të moshuarve

Opinionimi i pjesës më të madhe të të intervistuarve është që “Njerëzit e moshuar nuk janë barrë e familjes” (62.9%)




Figure 29:

Ndërkohë që grafiqet e mëposhtme tregojnë se të moshuarit (grupmosha mbi 65 vjeç) kanë “aspak” ose “disi” informacion në lidhje me çështjet e dhunës në familje si dhe me mënyrat e parandalimit të saj (Figura 30). Gjithashtu, përsëri kjo grupmoshë mendon se fenomeni i dhunës në familje ndodh më shumë në familjet e varfra dhe të paarsimuara. Ata mendojnë se forma më e përhapur e dhunës në familje është ajo fizike, emocionale dhe seksuale. Policia dhe qendrat e kujdesit shëndetësor janë sipas tyre institucionet më të rëndësishme në lidhje me çështjet e dhunës në familje.




Figure 30:

2.1 % e të intervistuarve pohojnë që personi i cili ka qenë viktimë e dhunës në familje ka qenë i moshuar, kurse e 3.4% e të intervistuarve pohojnë që personi i cili ka qenë viktimë e dhunës në familje ka qenë fëmijë (0-12 vjec).

Gjithashtu 14.5% e të intervistuarve pohojnë që prindërit i rrahin me shuplaka fëmijët e tyre çdo muaj dhe 26.8% e tyre mendojnë se ky fenomen ndodh çdo ditë. Nderkohë që babai dhe vëllai janë dy pjestarët të familjes cilët dhunojnë më shumë fëmijët. Për më tej opinionet flasin për faktin se një pjesë e fëmijëve të dhunuar, braktisin shkollën si pasojë e saj.




Figure 31

Shumica e të intervistuarve 28,6% mendojnë se fëmijët duhet të goditen me shpullë për gabimet që ata kryejnë, ndërsa 7,7% thonë se i godasin me rrip ose sende të forta që e çon në 36,3 numrin e të intervistuarve që përdorin dhunë mbi fëmijët e tyre. 26% mendojnë se ata duhen dënuar me më shumë punë shtëpie dhe pothuajse 35% përdorin dënime alternative si dënimi për të mos luajtur me shokët, apo dënimi që fëmija të qëndrojë në dhomën e tij. Megjithatë vetëm një pjesë e vogël e të intervistuarve 6,9% nuk mendojnë se rrahja me shuplakë, apo me rrip a shkop e fëmijëve nuk mund të konsiderohet dhunë në familje.




Figure 32

Nga ana tjetër, 30% e të intervistuarve pohojnë se dënimi është i ndryshëm për djemtë dhe vajzat. 40.3% mendojnë se djemtë duhet të kenë disiplinë më të rreptë se sa vajzat për arsye se kjo i bën ata më të fortë, ndërsa 55,2% mendojnë se vajzat kanë nevojë për më shumë disiplinë se sa djemtë, në mënyrë që të jenë moralisht korrekte.

Cfarë propozojnë të intervistuarit si masa parandaluese?

Vendin e parë e zenë propozimet për hapje vende pune. 16,4% e të anketuarve e quajnë këtë masë të parë që do të qetësonte individin dhe do të stabilizonte edhe marrëdhëniet e veta familjare, duke e socializuar më shumë dhe duke iu dhënë edhe viktimave një status social më dinjitoz. Po kështu, janë në vend të dytë, 15,7% e të anketuarve që mendojnë se ka nevojë për fushata të fuqishme ndërgjegjësimi kundër dhunës në familje që përbëjnë një mjet efikas parandalimi. Ligj më i fortë dhe i zbatueshëm më shpejt dhe më me vendosmëri kërkohet nga 14,5% e të anketuarve. 10,3% e të anketuarve e gjejnë prioritar krijimin e infrastrukturave pritëse për viktimat e dhunës në familje. 9,1% duan dënime më të forta dhe më të rënda për dhunuesit. 6,4% e të anketuarve preferojnë si masë një ndihmë sociale më të qenësishme për viktimat e dhunës në familje etj.

Pyetsori on-line në faqen www.hotlinealbania.org


54 pyetsorë në total u mbushën nga njerëz të ndryshëm në faqen Web të Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza gjatë fushatës publicitare në media përmes spotit televiziv dhe posterave të shpërndarë në 12 qarqe të vendit. Përgjigjet e të gjitha pyetjeve janë të renditura më poshtë në bazë përqindjesh dhe tabelash.

Rezultatet

Numri i regjistrimeve:	54
Totali i regjistrimeve në vëzhgim:	54
Totali në përqindje:	100.00%


1. A keni informacion në lidhje me çështjen e dhunës në familje në Shqipëri?

Përgjigje	Njehsim	Përqindja
Po (A1)	42	89.36%
Jo (A2)	4	8.51%
Pa përgjigje	1	2.13%




2. A keni informacion në lidhje mënyrat e parandalimit si dhe të luftës kundër dhunës në familje?

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Po (A1)	27	57.45%
Jo (A2)	19	40.43%
Pa pergjigje	1	2.13%




Sa informacion keni ju në lidhje mënyrat e parandalimit si dhe të luftës kundër dhunës në familje?




3. A keni informacion mbi legjislacionin për dhunën në familje?

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Po (A1)	17	36.17%
Disi (A2)	17	36.17%
Jo (A3)	12	25.53%
Pa pergjigje	1	2.13%




A keni informacion mbi legjislacionin për dhunën në familje?




4. Ndonjëherë është në rregull që burri të godasë gruan e tij?

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Po (A1)	0	0.00%
Disi (A2)	6	13.95%
Jo (A3)	37	86.05%
Pa pergjigje	0	0.00%




5. Dhuna ndodh vetëm në familje të varfra e të paarsimuara?

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Po (A1)	2	4.65%
Disi (A2)	13	30.23%
Jo (A3)	28	65.12%
Pa pergjigje	0	0.00%




6. Është e natyrshme që dhuna fizike ndodh ndërmjet çifteve kur ata debatojnë?

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Po (A1)	3	6.98%
Disi (A2)	9	20.93%
Jo (A3)	31	72.09%
Pa pergjigje	0	0.00%




7. Është e natyrshme që dhuna në familje të ndodhë pasi dikush të pijë alkool?

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Po (A1)	5	11.63%
Disi (A2)	14	32.56%
Jo (A3)	24	55.81%
Pa pergjigje	0	0.00%




8. Marrëdhënia seksuale nuk konsiderohet dhunë edhe nëse kjo gje kryhet kunder vullnetit te njerit nga partneret?

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Po (A1)	7	16.28%
Disi (A2)	6	13.95%
Jo (A3)	30	69.77%
Pa pergjigje	0	0.00%




9. Nga nuset pritet të ketë më tepër përgjegjësi për pastrimin dhe përgatitjen e ushqimit se sa anëtarët e tjerë të familjes

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Po (A1)	6	13.95%
Disi (A2)	10	23.26%
Jo (A3)	27	62.79%
Pa pergjigje	0	0.00%




10. Cila mendoni ju është forma më e zakonshme e dhunës në familje?

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Abuzim fizik (A1)	17	45.95%
Seksual (A2)	1	2.70%
Emocional (A3)	14	37.84%
Ekonomik (A4)	2	5.41%
Pa pergjigje	3	8.11%




11. Dhuna në familje është një çështje

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
E shëndetit publik dhe të drejtave të njeriut (A1)	30	81.08%
Private e familjes tuaj (A2)	7	18.92%
Pa pergjigje	0	0.00%




12. A mendoni se kryeja e marrëdhënieve seksuale kur një prej bashkëshortëve apo partnerëve intimë nuk e dëshiron atë quhet dhunë?

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Po (A1)	34	91.89%
Jo (A2)	3	8.11%
Pa pergjigje	0	0.00%




13. A ju ka ndodhur ju ose dikujt që ju njihni një marrëdhënie seksuale e padëshiruar edhe me bashkëshortin/en, partnerin/en, bashkëjetuesin/en tuaj?

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Po (A1)	12	32.43%
Jo (A2)	25	67.57%
Pa pergjigje	0	0.00%




14. A njihni ndonjë person i cili ka raportuar për ndonjë episod dhune?

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Po (A1)	24	64.86%
Jo (A2)	13	35.14%
Pa pergjigje	0	0.00%



15. Nëse do t'ju ndodhte juve ndonjë episod dhune në familje, a mendoni se do t'i drejtoheshit ligjit për të kërkuar ndihmë për rastin tuaj?

Pergjigje	Njehsim	Perqindja
Po (A1)	26	70.27%
Jo (A2)	11	29.73%
Pa pergjigje	0	0.00%



Pyetjes së hapur drejtuar të intervistuarve online se cilat mendojnë ata se janë disa nga shkaqet e dhunës në familje, të anketuarit i janë përgjigjur në mënyra të ndryshme ku më shumë janë përmendur varfëria dhe faktorët social ekonomik, moszbatimi i ligjeve nga organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, mentaliteti, traumat nga fëmijëria, sëmundjet mendore që po shtohen, mendësitë e vjetëruara që burri ka të drejta mbi gruan se ajo është pronë e tij në momentin që ata martohen, alkooli dhe substancat narkotike, xhelozia, etj.

Disa prej njerëzve që kanë plotësuar Pyetsorin mbi Dhunën në Familje kanë dhënë përgjigjet e mëposhtme në lidhje me shkaqet që ata/ato mendojnë të mundshme për këtë dukuri në shoqërinë tonë.

☞ *“Mentaliteti i krijimit të një figure të përcaktuar femërore nga i cili çdo ndryshim apo 'devijim' nga ai model gjykohet dhe rrjedhimisht dënohet, gjë që është shumë e gabuar, pastaj vijnë problemet ekonomike, injoranca dhe kultura e dialogut të varfër”.*

☞ *“Injoranca e meshkujve shqiptarë, e kaluara e tyre që ka ndikuar në formimin e karakterit që kanë sot. Nuk ka shkak që justifikon dhunën në familje”.*

☞ *“Mentaliteti dhe modelet ndërpersonale që justifikojnë dhunën në familje kryesisht ndaj grave dhe ndaj fëmijëve duke e parë këtë të fundit si metodë të mirë edukimi”.*

Ndërsa pyetjes se cilat mendojnë ata/ato se janë problemet kryesore të shoqërisë shqipëtare që shkaktojnë dhunë në familje, shumë prej të anketuarve u janë përgjigjur duke listuar problemet e mëposhtme:

Mentaliteti dhe faktorët sociale, ekonomia e dobët, xhelozia, papunësia, stereotipet gjinore, mungesa e strukturave që mbrojnë personat e dhunuar dhe ndëshkojnë personat që dhunojnë, frika që kanë gratë për të treguar dhunën nga opinioni, toleranca kolektive ndaj episodeve të dhunës, etj.

“Dhuna mbizotëron në këto familje dhe gratë e vajzat trajtohen si skllave që vetëm shërbejnë dhe rrihen konstant nga partnerët. Kam asistuar në një rast ekstrem ku bashkëshorti që ishte një djalë 25 vjeçar, i rritur e arsimuar në Evropë, rreh me rrip të shoqen që për më tepër ishte shtatzënë, vetëm e vetëm për të treguar në prani të shokëve se ç'është në gjendje të bëjë, për të treguar që unë jam burri dhe gruaja nuk ma bën dot fjalën dysh. Vajza në fjalë është një

vajzë e qytetëruar dhe e shkolluar, por që nuk ka rrugëzgjdhje për momentin, as mbështetje. Nga frika që gjërat mund të shkojnë më zi, që i shoqi mund t'i dëmtojë edhe familjen, duron dhe pret për një ditë më të mirë”.

Pyetjes së fundit se çfarë mund të bëjnë organizatat, institucionet dhe qeveria për të parandaluar dhunën në familje, të anketuarit i kanë dhënë këto përgjigje:

Të ndihmojnë gratë e dhunuara, më shumë sensibilizim, punë në identifikimin e fajtorëve dhe dënimin e tyre të jetë më efektiv sistemi i drejtësisë, politika parandaluese, ndërgjegjësim dhe sensibilizim të shoqërisë për pasojat e mëdha që ka dhuna në familje, dënim më i rreptë për dhunuesit, forcimi i besimit të institucionet si dhe të shtohen qendrat e rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit.

Gjetje të tjera

- Dhuna në familje është e pranishme në shoqërinë shqiptare dhe sipas perceptimeve publike ajo përbën një dukuri shoqërore të dhimbshme për viktimat e saj. Studimi dëshmon se kjo dhunë në familje në rradhë të parë ka të bëjë me atë që quhet “kulturë e dhunës”, e cila identifikohet me atë mentalitet kolektiv, të perhapur në disa shtresa, sipas të cilit dhuna, qoftë edhe në përmasa të lehta dhe kalimtare apo jo të rregullta, është edhe një mjet për të ruajtur shoqërinë të strukturuar, për të vendosur autoritetin, për të edukuar, apo për të ndrequr gabime apo vese të individëve të ndryshëm. Në këtë kontekst sidomos justifikohet brenda një kulture të caktuar edhe dhuna ndaj fëmijëve nga prindër të ndryshëm, çka shtrihet jo vetëm mbi moshën fëmijënore, por edhe mbi adoleshentët.
- “Kultura e dhunës” që del nga studimi, ndërtohet mbi disa hierkarki sociale vertikale që veprojnë fuqishëm brenda familjes shqiptare dhe shpesh shërben si instrument pushteti dhe sundimi i një kategorie që e konsideron legjitim pushtetin e vet mbi të tjerët, kundër parimeve të barazisë. Këto hierarki tradicionale lidhem me sundimin e bashkëshortit mbi bashkëshorten, e vëllait mbi motrën, e më të pushtetshmit ekonomikisht ndaj më të dobtit ekonomikisht, i më të riut në moshë ndaj të moshuarve të shtyrë në vitet e pleqërisë, i të shëndoshit mbi të sëmurin, i njerzve të fisit të burrit ndaj nuses së shtëpisë, i prindërve ndaj fëmijve edhe pse në një moshë jo minore, etj.

- Aktet e dhunës në familje janë të shumëllojshëm dhe kanë frekuenca të ndryshme atje ku kjo dhunë ushtrohet. Ka shfaqje të dhunës fizike, të dhunës seksuale, të dhunës psikologjike, të dhunës që ka të bëjë me shfrytëzimin ekonomik, etj.
- Dhuna ushtrohet në mjedise të izoluara, jashtë vrotimit të syrit kolektiv të opinionit publik, por edhe konstatohet nga ky i fundit nëpërmjet dëshmime të drejpërdrejta, nëpërmjet njohjes së fakteve nga raportimet e bëra nga viktimat e dhunës, nga fakti i angazhimit në struktura sociale kundër dhunës në familje, etj. Nga kjo pikëpamje, studimi provon se vërtet familja është një mikromjedis social relativisht i izoluar, një hapësirë private, por jo në mënyrë absolute. Familja nuk është një agjenci tërësisht e mbyllur dhe izoluar nga shoqëria. Nga kjo pikëpamje mund të thuhet se opinionin shoqëror e njeh dukurinë e dhunës familjare, por problemi nuk është më shumë mosnjohja, por më shumë te mosreagimi për shkak të faktorëve të ndryshëm.
- Dhuna në familje në një shtet ligjor, atëhere kur ajo është e paraportuar, e pandëshkuar dhe e toleruar, përbën një zonë të shoqërisë ku dhuna dhe jo ligji bëhet “rregullatore” e jetës shoqërore. Familja në këto raste bëhet një hapësirë jashtëligjore. Në këtë mënyrë viktimat e dhunës në familje apo personat e kërcënuar prej saj jetojnë në dy realitete kontradiktore që bëhen shkas për gjendje skizofrenetike. Si qytetarë jetojnë në një shoqëri ku në një masë të caktuar supozohet se vepron ligji dhe e drejta, ndërsa si antarë të një familjeje jetojnë pa të drejta individuale, të pambrojtur ndaj dhunës arbitrare, vetëgjyqësisë dhe nën peshën e kërcënimit të dhunshëm të pambështetur në norma ligjore dhe kundër tyre. Studimi në gjetjet kryesore të tij ka edhe administrimin e perceptimit publik se një pjesë e familjeve shqiptare janë apo jetojnë në këtë hapësirë të parregulluar ligjore.
- Studimi provon se në perceptimin publik ka shumë më tepër akte dhune në familje nga sa raportohet në media, në publik apo denoncohet në institucione. Ka më tepër akte dhune nga sa ato që njoftohen organet e ruajtjes së rendit. Ka më tepër akte dhune ku ndërhyjnë policia nga sa rastet që çështja shkon në gjykatë. Ka shumë më tepër raste dhuna që trajtohen në gjykatë nga sa ato që përfundojnë me një dënim të ushtruesit të dhunës. Kuptohet që diferenca mes këtyre të dhënave do të ketë natyrshëm, porse në perceptimin publik ato janë të konsiderueshme dhe bëhen shkak që dhuna të

gjejë hapësirë të lirë veprimi dhe opinioni shoqëror të mobilizohet në mënyrë shumë të vakët kundër saj.

- Studimi tregoi se dhuna në familje është një dukuri shoqërore e cila vjen dhe si rezultat i mbijetesës të faktorëve konservatorë dhe tradicionalë të shoqërisë shqiptare, si patriarkalizmi, maskilizmi, seksizmi, konsiderimi i trupit dhe nderit të femrës si pronë e prindërve apo bashkëshortit, por edhe si rezultat i zbehjes të disa vlerave të shëndosha të traditës shqiptare sikurse është respektimi i më të moshuarve, etj.
- Kjo dhunë në familje është gjithashtu pasojë e modelit të sotëm të shoqërisë që përjeton dy tipe vlerash kontradiktore me njëra tjetrën, nga njera anë të drejta individuale të garantuara nga një sistem juridik dhe social liberal dhe ruajtjes të një morali konservator në mikromjedise sociale dhe familjare të caktuara. Shpesh here morali familjar konservator mundohet të ruajë sundimin e vet në familje nëpërmjet qendrimeve të dhunshme ndaj lirisë që kërkojnë të përjetojnë brezat e rinj. Por, kjo dhunë vjen edhe në lidhje me shtimin e përqindjes së divorceve si rezultat i shprishjes së marrëdhënieve mes partnerëve familjarë në kushtet e emigrimit, fillimit të jetës së re në qendra të reja urbane, xhelozisë në kuadrin e shoqërisë së hapur, etj.
- Viktimat e dhunës ndodhen në një pozitë dyfish të frustruar. Nga njera anë ato pësojnë pasojat e dhunës, por nga ana tjetër, ndonëse e dinë se kanë të drejtë ta denoncojnë këtë dhunë, shpesh nuk e bëjnë dot për shkak të faktorëve të ndryshëm socialë dhe psikologjikë si edhe sepse autoritetet që duhet ta mbrojnë këtë individ nga dhuna në mjediset e ngushta familjare nuk janë në gjendje të ndërhyjnë sa edhe si duhet. Këtu ndikon edhe fakti se ndërhyrja e ligjit dhe e forcave të ruajtjes të rendit publik në familje është shumë delikate në rastin e familjes. Psikologjikisht studimi këtë do ta shpjegonte nëpërmjet konceptit të “frustrimit të dyfishtë psikologjik”.
- Parë nga ky prizëm, viktimat e dhunës në familje i drejtohen këtij apo atij faktori shoqëror mbrojtës apo receptues mesazhesh të tyre në varësi nga shumë rrethana. Në vendin më të parë nga pikëpamja e orientimit të viktimave të dhunës e zenë miq e shokë, pjestarë të tjerë të rrethit familjar, dhe në kushtet e një dhune të rëndë forcat e rendit publik. Studimi provon se viktimat e dhunës e kanë më të lehtë të referohen te organizatat që ofrojnë shërbime, por ato nuk mbulojnë gjithë vendin e veçanërisht zonat rurale.

- Të dhënat e studimit të krahasuara me rastet e dhunës së ashpër dhe ekstreme brenda familjes (vrasje, plagosje me dashje, etj.) japin perceptimin se ka një “dhunë në familje vertikale”, pra që niset nga burri, bashkëshorti apo më i forti fizikisht dhe shkon drejt personave më vulnerabël, sikurse ka edhe një “dhunë horizontale” mes meshkujve të familjes apo të fisit për çështje pronësie dhe konflikti ekonomik ku edhe pasojat janë edhe më brutale, imediate dhe të rënda nga pikëpamja e vlerësimit penal. Përgjithësisht, konfliktet ekonomike, për çështje pronësie, apo edhe për “motive të dobta”, xhelozia, nder, etj, si edhe të lidhura me interesa më të fuqishme dhe të kryera si akte në kushte tronditje psikologjike japin akte dhune më të menjëhershme dhe më të egër. Kurse faktorët e tjerë krijojnë kushte të një dhune latente ose jo, por më të zgjatur në kohë dhe të rëndë psikologjikisht për viktimat apo të kërcënuarit nga dhuna.
- Shoqëria shqiptare, sipas anketimit, ka informacion për dhunën në familje, por ka pengesa të ndryshme që ky problem të kthehet në një çështje të debatit shoqëror. Kjo vjen që nga ideja për t’u konsideruar një çështje private deri te frika për informim, ose turpi që vjen nga personat e viktimizuar.
- Në një farë mënyre vepron edhe ai që mund të quhet “ligji i heshtjes”, kur të gjithë dinë diçka, por askush nuk e shpreh. Studimi tregon se burimet e informacionit për dhunën në familje janë në rradhë të parë mediat, pastaj komunikimi ballë për ballë i viktimave me grupe a rrethe shokësh apo miqsh. Ndërkaq komunikimi dhe debatimi për këto çështje në konsulta të specializuara, të organizuara nga shoqata apo institucione të specializuara, është i pakët.
- Ndërkaq, midis informimit dhe reagimit kolektiv kundër akteve të dhunës në familje ka gjithashtu një shpërpjestim që studimi e tregon qartësisht. Përgjigje dhënësit shprehen në mënyrë pothuajse unanime se nuk kanë marrë pjesë në manifestime kolektive kundër kësaj dukurie negative shoqërore.
- Duket qartë se në kushtet e shpërbërjes të lidhjeve të vjetra sociale, dhe në rrethanat e emigrimit masiv nga njeri vendbanim te tjetri, shoqëria shqiptare vuan mungesën e kohezionit të vlerave dhe të opinionit shoqëror ndaj shfaqjeve në kundërshtim me disa norma morale bazike në jetën e përditshme sikurse është dhe mosdhunimi i të afërmeve.

- Edhe këtu ndihet fakti se edhe morali fetar në parimet e veta rregullatore për tolerancën dhe mirëkuptimin vepron relativisht dobët në disa mikromjedise familjare ku edhe dhuna gjen praninë e vet.
- Sigurisht që dhuna në përgjithësi është një dukuri që karakterizon paditurinë, mungesën e emancipimit, arsimimin në nivele të ulta, etj. Në parim përsëritet formula e Balzakut se atje ku hapet një shkollë mbyllet një burg. Por, studimi tregon se kjo e vërtetë përgjithësisht e provuar duhet marrë në një kuptim relativ dhe jo absolut. Përgjigje dhënësit në një masë të konsiderueshme pohojnë se u ka ndodhur që të jenë dëshmitarë të skenave ku i dhunuari apo kryesisht e dhunuara të jetë edhe me arsim të mesëm edhe të lartë. Dhuna nuk përjashton edhe familjet me nivel që nuk mund të quhet ai i varfërisë. Pra, anketimi dëshmon se mikromjediset sociale ku dhuna në familje është e pranishme mund të jenë dhe janë edhe ato të arsimuara dhe me kushte ekonomike të qëndrueshme ose edhe të mira. Kjo kuptohet meqë jemi në kushtet e arsimimit masiv, në kushtet kur konfliktet pronësore kapin shtresa të ndryshme të shoqërisë dhe se konfliktet familjare mes brezave nuk njohin dallime mes kategorive shoqërore me ose pa arsimimin përkatës, etj.
- Studimi gjithashtu na tregon se një pjesë e dhunës në familje që ze peshë të veçantë është dhuna seksuale si në marrëdhëniet bashkëshortore, ashtu edhe mes partnerësh të divorcuar, apo edhe në format e prirjeve incestuale në ato raste që edhe janë paraqitur në mënyrë simbolike nga media. Këtë e dëshmojnë jo vetëm përgjigjet e drejtpërdrejta, por edhe fakti që objekt i dhunës seksuale janë moshë ku edhe tërheqja seksuale mashkullore është më e madhe.

KAPITULLI III

METODOLOGJIA DHE GJETJET E STUDIMIT CILËSOR

Metodologjia e fokus grupeve

Në prill 2013, u zhvilluan katër fokus grupe në total me target grupe të ndryshme në lidhje me studimin për viktimat e krimit të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale.

Konsiderata Metodologjike

Shqyrtim i Dizajnit të Metodave të Përziera.

Creswell¹⁰ (2009) identifikon katër faktorë të kërkimit me metoda të përziera dhe teksta vendos që metodat e përziera janë forma më e mirë e të pyeturit për t’u përdorur në një projekt kërkimi në shkencat sociale, hapi tjetër është të zgjidhet kompozimi më i mirë për t’u përdorur për projektin. Ky studim adopton një kompozim të kërkimit me metoda të përziera. Ky seksion diskuton përkufizimin dhe racionalen e metodologjisë dhe rolin e saj mbi dizajnin dhe zhvillimin e studimit.

Creswell dhe Clark (2007) e përkufizojnë kërkimin me metoda të përziera si kombinim i përqsjeve sasiore dhe cilësore, të cilat ofrojnë për të kuptuar më mirë problemet e kërkimit. Sipas Johnson dhe Onwegbuzie¹¹ (2004), kërkimi me metoda të përziera ju jep studiuesve lirinë për të përzgjedhur atë që ata e shohin si përqsjen më të përshtatshme për pyetjet e kërkimit, pa ndonjë supozim të paramenduar lidhur me superioritetin e ndonjë metode të caktuar kërkimi. Për pasojë, kërkimi me metoda të përziera mund të përqafojë si përqsjet cilësore ashtu edhe ato sasiore.

¹⁰ Creswell, J. W. (2009). Research design: Qualitative, quantitative, and mixed methods approaches (3rd Edition ed.). Thousand Oaks, CA: Sage

¹¹ Johnson, B. R., Onwegbuzie, A. J., & Turner, L. A. (2007). Toward a definition of mixed methods research. Journal of Mixed Methods Research, 1(2), 112-133.

Filozofikisht, paradigma e kërkimit me metoda të përziera shoqërohet me pragmatizmin, ku shqetësimi parësor është ajo metodë që siguron një zgjidhje praktike për një pyetje të caktuar të kërkimit. Ky theks mbi rezultatet e lejon atë të çlirohet nga debati tradicional midis metodave cilësore dhe sasiore dhe unifikimi i tyre në një studim të vetëm krijon mundësinë për të kompensuar dobësitë e tyre përkatëse. Praktikisht, kërkimi me metoda të përziera karakterizohet nga përdorimi i trekëndëzimit dhe multiplizmit. Trekëndëzimi forcon vlefshmërinë e rezultateve të kërkimit duke përdorur metoda të shumëfishta për të hetuar të njëjtin fenomen, duke kompensuar në këtë mënyrë anshmëritë, ndërsa multiplizmi e mbështet trekëndëzimin duke rekrutuar sa më shumë burime të dhënash që të jetë e mundur.

Kompozimi i Metodave të Përziera.

Pasi zgjedhëm metodat e përziera si strategji kërkimi kërkuaam përzgjedhjen e një kompozimi që do të përfaqësonte më mirë të dhënat e grumbulluara për studimin. Pas marrjes në konsideratë të katër faktorëve të kërkimit me metoda të përziera dhe vendimit që metodat e përziera janë forma më e mirë për t’u përdorur në një projekt kërkimi në shkencat sociale, hapi pasardhës ishte të zgjidhnim kompozimin më të mirë për t’u përdorur për projektin. Për këtë morëm vendime lidhur me tipin e të dhënave (cilësore apo sasiore) të cilave ju dhamë përparësi në aspektin se cili lloj të dhënash grumbullohet në fillim; dhe se si do të përzihen të dhënat (Rauscher & Greenfield¹², 2009). Siç u përmend më sipër, duhen marrë parasysh 4 faktorë kur zgjidhet një kompozim i metodave të përziera për një studim kërkimor. Për këtë arsye i identifikuaam faktorët si më poshtë:

1. koha
2. ponderimi
3. përzierja
4. teorizimi

¹²Rauscher, L., & Greenfield, B. H. (2009). Advancements in contemporary physical therapy research: Use of mixed methods designs. *Physical Therapy*, 89(1), 91-100.

Aplikimi i Kërkimit me Metoda të Përziara në këtë Studim.

Studimi krahason dhe trekëndëzon të dhënat sasiore të përftuara nga pyetësorët dhe të dhënat cilësore të përftuara nga intervistat në fokus grupe.




Figura 1. Dizajni i Trekëndëzimit të Studimit

Dizajni i Kërkimit

Siç u përmend më sipër, ky studim adopton një kompozim kërkimi me metoda të përziara të përbërë nga metoda grumbullimi të dhënash sasiore dhe cilësore. Metodat e grumbullimit të të dhënave cilësore përbëhen nga diskutimet në 4 fokus grupe me gra rome, viktimat e dhunës në familje, dhe 2 grupe të komunitetit LGBT (Tabela 1).

Tabela 1

Përmbledhje e Metodave të Grumbullimit të të Dhënave

	<i>Pjesëmarrësit</i>
Metoda Cilësore Diskutim në fokus grupe	1. Gra dhe Vajza Rome 2. Gra të dhunuara 3. Pro LGBT Albania 4. Aleanca LGBT
Metoda Sasiore	Pyetësorët 1. 500 të intervistuar 2. 60 viktimat në telefon 3. 54 pyetësorë të mbushur në faqen e Web

Udhëzues Diskutimi për fokus grupe

Pyetjet e fokus grupeve janë përcaktuar nga identifikimi i temave në grupin e punës. Secili sesion diskutimi është zhvilluar në të njëjtën mënyrë. U përdor për të gjitha fokus grupet i njëjti udhëzues diskutimi, duke siguruar një nivel konsekuence. U ndërton disa tema për t'u diskutuar në sesionet e fokus grupeve. (Shih temat në Shtojcën 1)

Konsiderata Etike

U përgatitën në shqip fletë informacioni për pjesëmarrësit dhe letra falënderimi. U shpërndanë përpara grumbullimit të të dhënave. Fletët e informacionit për pjesëmarrësit flasin për natyrën e kërkimit, përfshirë qëllimin, përfitimet, dhe metodat. Mbulojnë gjithashtu edhe të drejtat e pjesëmarrësve dhe ofrojnë informacion për të shprehur shqetësime apo sugjerime. Letra e mirënjohjes është një falënderim i shkurtër për pjesëmarrjen, motivimin dhe ndershmërinë. Procesi i grumbullimit të të dhënave filloi pas përfundimit të procesit të miratimit etik.

Grumbullimi i të Dhënave

Grupet pjesëmarrëse që morën pjesë në studim i njohën kërkueset si profesioniste në fushën e dhunës në familje.

Shumica e pjesëmarrësve vlerësuan rolin e kërkuesit dhe u dukën se i përgjigjën afatit të intervistës së pyetësorit, apo diskutuan në fokus grupe duke qenë të hapur (me disa përjashtime në grupin e grave romë). Së fundi, pjesëmarrësit shprehën vështirësitë në përballimin e jetës dhe folën edhe për nevojën e tyre për informacion mbi dhunën në familje si dhe për dëshirën e tyre për të marrë materialet që do të prodhojë ky studim.

Afatet

Grumbullimi i të dhënave u nda në dy periudha




Figura 2. Dizajni i Grumbullimit të të Dhënave

Metodat dhe Materialet

Ky studim përdori pyetësorët dhe diskutimet në fokus grupe si metoda për grumbullimin e të dhënave.

Metodat dhe Materialet për Grumbullimin e të dhënave (fokus grupe).

Diskutimi në fokus grupe ishte metoda dytësore për plotësimin e informacionit të përftuar nga pyetësorët. Materialet e fokus grupeve përfshinin: Udhëzues diskutimi dhe regjistruer. Udhëzuesi i Diskutimit ishte hartuar për të mbledhur informacion nga 4 fokus grupet e krijuara. Pjesëmarrësit u përzgjedhën nga komuniteti LGBT dhe komuniteti rom me ndihmën e shoqatës PRO LGBT dhe Aleanca LGBT, si dhe nga Roma Active Albania. Siç u përmend më sipër, pjesa cilësore që përfaqësohet nga fokus grupet është plotësuese. U zhvilluan një total prej 74 temash për diskutim. Regjistruerit u cilësua si material i rëndësishëm pune për fokus grupet dhe u trajtua brenda rregullave të mirëmbajtjes së materialeve.

Procedura për Fokus Grupet.

Sesionet e fokus grupeve u zhvilluan nga një grup me dy anëtarë: një moderator dhe një ndihmës moderator. Roli i moderatorit ishte të drejtonte çdo sesion duke përdorur kalendarin e sesionit, duke lehtësuar diskutimin me anë të përdorimit të ngacmimeve për komente të mëtejshme, si dhe duke përmbledhur pikat kyçe gjatë dhe drejt fundit të secilës intervistë. Pjesëmarrësve iu kërkua shpesh të komentonin se sa e përfaqësonin përmbledhjet diskutimin që ishte bërë. Roli i ndihmës moderatorit ishte të mbante shënime gjatë dhe menjëherë pas çdo interviste, të kujdesej për kasetat e regjistrimit, dhe të maste kohën. Gjatë pushimit prej pesë minutash dhe pas përfundimit të çdo sesioni, moderatorët diskutonin shënimet e terrenit, duke u përqendruar tek pikat kryesore që ngriheshin nga pjesëmarrësit dhe natyrën e përgjithshme të intervistës.

Sesionet zgjasnin 2 orë. Në secilin sesion, diskutoheshin të gjitha temat e diskutimit të përcaktuara. Biseda regjistrohej. Roli i kërkuesit ishte të lehtësonte dhe rrallë, të drejtonte diskutimin e çështjes, duke bërë pyetje mbi të. Diskutimi në grup kishte një kohëzgjatje kohore prej 2 javësh. Çdo javë u zhvilluan nga dy sesione.

Analiza e të Dhënave e pjesës cilësore.

Fazat në Analizën e të Dhënave Cilësore

Cilësore	Fazat në Analizën e të Dhënave
Zbardhja e tekstit	Faza 1
Përgatitja e të dhënave për analizë kompjuterike, MAXQUDA	Përgatitja e të dhënave për analizë
Leximi i të dhënave	Faza 2
Shkrimi i memove	Hulumtimi i të dhënave
Kodimi i të dhënave	Faza 3
Grupimi i kodeve në kategori	Analiza e të dhënave
Përfaqësimi i gjetjeve në diskutimet e kategorive	Faza 4
Paraqitja e modeleve vizuale	Përfaqësimi i analizës së të dhënave
Gjenerimi i një teorie	
Trekëndëzimi	Faza 5
Shqyrtimi moshatar	Verifikimi i të dhënave
Rezultatet e analizave	Faza 6
	Integrimi i të dhënave

Tabela 2: Skema e procesit të transformimit nga të dhënat tek modeli Teorik Të dhënat cilësore të gjeneruara në këtë studim u analizuan duke përdorur përfaqshen e Teorisë së bazuar.

Përfaqja e Teorisë së Bazuar

Teoria e bazuar ofron metodologjinë dytësore përdorur në këtë studim. Glaser e përkufizon Teorinë Bazë si ‘një metodologji specifike mbi mënyrën e kalimit nga grumbullimi sistematik i të dhënave tek prodhimi i teorisë konceptuale shumë-varietetesh’ (Glaser, 1999, f. 836). Metodologjia e teorisë bazë synon të gjenerojë teori nëpërmjet një procesi krahasimi konstant dhe thekson nevojën për ta filluar një projekt pa asnjë teori të paramenduar.

Në analizën e teorisë së bazuar, teoria dhe të dhënat mbahen në një bisedë të vazhdueshme, në të cilën drejtimi përcaktohet nga të dhënat në vend që të drejtohet prej një teorie.

Intervistat luajnë një rol qendror në grumbullimin e të dhënave për një studim të teorisë së bazuar. Më pas, teoria i drejton metodat e analizës së të dhënave në një krahasim konstant të të dhënave brenda një cikli përsëritës, induktues dhe deduktues, duke lejuar që teoria të lindë drejtpërdrejt nga të dhënat. Fillon me përshkrimin bazë, rritet deri në renditjen konceptuale, dhe zhvillohet në teori (Patton, 2002).

Aplikimi i Teorisë së Bazuar në këtë Studim.

Ky studim përdor kampionimin teorik për të grumbulluar të dhëna nga individë që mund të kontribuojnë në teorinë në zhvillim. Të dhënat cilësore u grumbulluan duke përdorur sesione fokus grupesh si metodë. Të dhënat u analizuan në shqip. Seksionet pasuese e shpjegojnë këtë proces, ilustruar me shembuj të përftuar prej pjesëmarrësve.

Faza 1 – Përgatitja e të Dhënave Cilësore. Të dhënat cilësore përfshinë sesionet e fokus grupeve. U prodhuan 4 regjistrime audio me një kohë totale regjistrimi prej 8 orësh.

Materiali regjistruar u zbardh në çdo fjalë.

Faza 2 – Eksplorimi i të Dhënave Cilësore. Eksplorimi i të dhënave u krye si një proces leximi nëpër të dhëna dhe krijimi memosh me qëllim zhvillimin e të kuptuarit fillestar të bazës së të dhënave. Eksplorimi i të dhënave u përdor edhe për të kontrolluar saktësinë e zbardhjeve të intervistave.

Faza 3 – Analiza e të Dhënave Cilësore. Analiza e të dhënave filloi me kodimin, i cili transformon të dhënat bruto në ndërtime teorike. Kodimi synon të gjenerojë një grup kategorish dhe veçorive të tyre që mund të lindin një teori. Kodimi u ndihmua nga përdorimi i MAXQUADA, një program analize të dhënash cilësore. Në sesionet e fokus grupeve u gjeneuran mbi 360 kode dhe 10 memo. Kodimi ishte një proces përsëritës leximi, mendimi dhe emërimi të dhënash, përkrah shkrimit të memove. Ky proces përsëritës aplikohet tek të dhënat radhë pas radhe, duke kërkuar qëllimin e ndonjë të dhëne të veçantë. Përgjigjet e grave rome hera-herës ishin gramatikisht jokorrekte, por u zbardhën dhe u koduan fjalë për fjalë.

Pasi kodet u përcaktuan, ato u grupuan së bashku sipas ngjashmërive dhe dallimeve. Kodet e grupuara përbënin kategori dhe kategoritë u zhvilluan e u bënë hierarki.

Memot

1.	Gratë e komunitetit rom paraqesin vështirësi në të kuptuarin e pyetjeve.
2.	Përgjigjet e pyetjeve shpesh herë nuk janë në kontekstin e duhur.
3.	Vërehet një lloj hezitimi për t’u përgjigjur me sinqeritet për shkak të njohjeve në grup
4.	Për komunitetin LGBT konstatohet një lloj dëshire për të diskutuar rreth këtij problemi
5.	Duken mjaft të hapur për të shprehur mendimet e tyre
6.	Janë të shkolluar dhe flasin qartë, bukur.
7.	Ndihen mjaft të frustruar dhe kanë probleme emocionale
8.	Për fokus grupin e grave të dhunuara: Ato ngurojnë të flasin në fillim.
9.	Më pas fillojnë të flasin
10.	Niveli i edukimit është i ndryshëm

Gjetje

Botëkuptimi /mentaliteti / tradita: Pjesmarrësit në fokus grup theksuan se në konceptin e dhunës ndikojnë shumë faktorë ku ndër më të përmendurit janë **mentaliteti** që individët kanë, **traditat** familjare dhe krahinore të cilave iu përkasin. Ndikimi i mentalitetit dhe traditës ishte një çështje që u cilësua në diskutimet e 4 fokus grupeve. Një pjesëmarrës i komunitetit LGBT shprehet: *“Mentaliteti ekziston, pasi dikush para ca kohësh vrau të bijën dhe gjykata i dha vetëm 2 vjet burg pasi ai e kishte bërë për të mbrojtur nderin e familjes”*. Gjithashtu duke jetuar në familje të mëdha ku bashkëjetojnë individë me diferencë brezash, ndryshon edhe mënyra e perceptimit të dukurive, që shpesh bëhet shkak për konflikte e deri në dhunë psikologjike. Shpesh herë familet që vijnë nga zonat rurale në qytet tentojnë të ruajnë zakonet e zonës së tyre. Një pjesmarrës tjetër i komunitetit LGBT shprehet: *“Vajzat janë ato që janë akoma edhe më të shtypura, kemi plot raste ku lidhja dashurore midis djalit dhe vajzës ka qenë mjaft e fortë dhe për shkak të familjeve nuk ka mundur të finalizohet”*. Një pjesmarrës tjetër nga komuniteti rom thotë: *“Humbja e virgjërisë së një femre është ende tabu sot sidomos në zonat më të thella të veriut”*. Një tjetër pjesmarrës nga komuniteti rom thekson se: *“Gjithmonë dhuna gjeneron dhunë, gjithmonë fëmija model ka prindin, djali model ka babain, gjyshin që dikur ka dhunuar gjyshen”*. Fëmijët të cilët janë prezent në aktet e dhunës pësojnë trauma psikologjike pasi shohin skena të frikëshme qoftë për nënën, qoftë për gjyshen, vëllai për vëllain, motrën, babain. Në disa raste dhuna ushtrohet nga vjehri, vjehrra, kunetrit, etj.

Njëra nga bashkëfolëset (grua e dhunuar) mendon se: *“në zonat rurale me pak popullsi kjo gjë përpiqet të mbahet e fshehtë dhe nuk merret vesh nga të tjerët ndryshe nga zonat urbane ku sipas saj ndodh e kundërta”*.

Një tjetër folës nga komuniteti LGBT shprehet se: *“për të ruajtur krenarinë e tyre të tillë njerëz nuk denoncojnë dhe pse rrethi familjar e më gjerë mund të jetë tërësisht në dijeni të situatës”*. *“Femrat edhe mund të zgjedhin të viktimizohen thotë dikush tjetër në replikë. Ato nuk pranojnë ta denoncojnë dhunën që kryhet ndaj tyre”*.

“Shoqëria jonë është një shoqëri maskiliste”, thotë Ela nga komuniteti LGBT, *“dhe duhen shumë breza që të arrijmë të krijojmë një barazi mes meshkujve dhe femrave, duke qënë shoqëri maskiliste është shumë e vështirë që gjerat të kalojnë në respekt ndaj njëri- tjetrit, gjë që duhet shumë kohë. Gjithmonë mashkulli është i prirur nga natyra që të jetë i fuqishëm, i plotfuqishëm në*

gjithshka, ai gjykon kur ka të drejtë, ndërkohë që të tjerët duhet ta dëgjojnë atë kur duhet të veprojnë. Të tillë njerëz e kanë shumë gabim”.

Në qytet ka më tepër shanse, sepse është mbi populluar, mendje dhe karaktere të ndryshme sjellin dhunë. Në zonat ruarale ka gjithashtu gjasa për shkak të instancave që mungojnë. Dikush nga fokus grupi i grave të dhunuara shprehet: *“Aspekti i traditës është goxha i fortë dhe i prapambetur”.*

Marjana nga komuniteti LGBT shprehet: *“Ekziston dhe mentaliteti, pasi mashkulli kur vjen në shtëpi pret t’i gatuajë femra dhe pse ai vetë mund të gatuajë shumë mirë dhe kur nuk e gjen gati nis sherri midis tyre”.*

Dhuna në familje dhe ndikimi i faktorëve psiko- social.

Pjesmarrësit pohojnë se vazhdimisht ndodhen nën presionin psikologjik të prindërve, për vetë shkakun që prindërit vazhdojnë të edukojnë brezin e ri me modelet e tyre të edukimit, ndërkohë që konceptet kanë evoluar. Një pjesmarrës nga komuniteti LGBT thotë: *“Duke qënë se ne kemi qënë më të hapur ndaj botës përëndimore, ndaj informacioneve, etj. kjo na bën ne të pranojmë më tepër se ata, dhe po për këtë arsye ne vendosemi në presion psikologjik më të madh se ata”.*

Diskriminimi . Ndodh shpesh që vetë gratë mundohen të justifikojnë dhunën në familje, specifikisht bashkëshortët e tyre. Një grua nga komuniteti rom shprehet: *“Gratë e quajnë normal një fakt të tillë, madje edhe faktin që burri si pasojë e akumulimit të tepërt të tensioneve kërkon ta shfryjë diku energjinë e tij negative duke goditur gruan. “E ku tjetër mund t’i nxjerrë burri nervat e tij, përveçse tek gruaja”.*

Një nga çështjet që u diskutua gjatë ishte edhe **stigma**. Njerëzit në realitetin Shqipëtar shqetësohen për opinionin dhe jo për problemet e tyre personale. Një tjetër fakt, thotë njëra nga folëset e komunitetit LGBT është se: *”nënat janë gjithnjë më të buta në përpjekje për t’i sheshuar gjërat ndërkohë që baballarët e kanë më të vështirë t’i pranojnë gjërat sidomos kur fëmija e tyre ka prirje homoseksuale”.*

“Dhuna është një shënje dobësie: thotë një nga gratë e dhunuara , “është dobësi, kur një burrë nuk arrin të përballojë argumentin që i paraqitet, detyrohet sepse e kupton që e ka gabim dhe mënyra e vetme për të të vënë poshtë është të të dhunojë, të të mbajë të të izoluar” . Dikush tjetër nga po ky grup shprehet: “bashkëshorti mund të të abuzojë me të ardhurat financiare, mund të të bëjë një jetë të dyfishtë dhe kur përballet me argumentin nga pala tjetër nga bashkëshortja, normalisht që e vetmja rrugë është dhuna”.

Papunësia është një tjetër faktor risku për mashkullin, i cili mund të ushtrojë dhunë ndaj gruas për shkak të akumulimit të stresit, por nga ana tjetër një grua e papunë është e varur financiarisht plotësisht nga bashkëshorti i saj. Edhe pse mund të dhunohet në mënyrë frekvente ajo nguron të marrë vendimin për divorc. Një pjesmarrës nga komuniteti rom thotë: *“Kur ka varësi ekonomike në mes ekziston frika se mos ndarja do sillte rrënimin e njëres palë apo të dyjave.”*

Në fokus grupin e grave të dhunuara shumica e shohin **ndarjen** si zgjidhje, por kjo në varësi të marrdhënies për të cilën bëhet fjalë, nëqoftëse flasim për nënë-bijë apo motër-vëlla zgjidhja nuk mund të jetë ndarja. Por nganjëherë për shkak të mentalitetit në të cilin gruaja nuk mund të kërkojë divorc përpara se burri ta bëjë këtë gjë, ka ndodhur që pasi gruaja ka kërkuar ndarjen, çifti është ripajtuar dhe më pas ka qenë burri ai i cili e ka kërkuar divorcin. Njëra nga folëset u shpreh se: *“me anë të psikologut gjërat duhet të rregullohen dhe nëse kjo nuk ndodh atëherë duhet kaluar tek ndarja”.*

Në mjaft raste sic u shpreh edhe nga folësit në fokus grupe gratë ndihen të **paragjykuara** dhe shpesh herë kjo gjë është barrierë për të për të marrë vendime.

Një fenomen tjetër i cili u diskutua ishin edhe arsyet të cilat e detyrojnë femrën për të **prostituuar**. U renditën një sërë arsyesh si: arsyet ekonomike, përdorimi i forcës nga dhunuesit, frika nga dhunuesi, mungesa e sistemeve mbështetëse, veçori individuale të personalitetit etj.

Në shumë raste dhuna nuk raportohet dhe arsyet e mosraportimit të dhunës janë të ndryshme.

Sipas pjesmarrësve një nga arsyet është **frika**. Ato janë të pushtuara nga kjo ndenjë dhe shpesh nuk mund të mendojnë përtej saj. Ato kanë frikë se dhuna mund të shtohet, kanë frikë nga pasojat pas denoncimit, frikë dhe pasiguri për të ardhmen. Gratë kanë **mungesë besimi** se dikush mund t'i ndihmojë, kryesisht

ndaj strukturave përgjegjëse si gjykatat, që në mjaft raste sipas tyre janë të korruptuara. Në rastin e dhunës ekstreme thotë njëra nga bashkëfolëset, nuk mund të japë askush ndihmën përveç policisë, Duhet rritur roli i policisë. Policia, thotë ajo, po ndërgjegjësohet, por problemi qëndron tek drejtësia, pasi policia i kap dhe drejtësia i lëshon.

Ndjenja e turpit është mjaft e shprehur nga vetë ato (gratë e dhunuara). Ato kanë turp se humbin dinjitetin dhe reputacionin. Shpesh e konsiderojnë marrëdhënien e keqe si një pjesë të fatit të tyre dhe duhet të mos e denoncojnë dhunën dhe qëndrojnë në marrëdhënie të dhunshme për hir të fatit të keq, që duhet duruar si rregull i jetës. Kishte edhe një grua e cila pohoi se ka edhe raste kur gratë edhe pse bashkëshortët i dhunojnë ato përsëri kanë një ndjenjë dashurie për ta dhe nuk dëshirojnë që t’i denoncojnë, sepse janë të **trembura** se ai mund të dëmtohet fizikisht apo mund të torturohet. Gratë druhen se po të denoncojnë dhunuesin ato do të braktisen nga ata dhe nuk do të kenë mundësi ekonomike të jetojnë të pavarura nga ai. “Nuk shoh ndonjë mundësi që do ja dalë”, thotë Ela.

Një pjesë mendojnë për fëmijët dhe nëse do të denoncojnë familja do të shkojë drejt ndarjes dhe e ardhmja e fëmijëve është e pasigurt. Disa gra shprehen se: “Në përgjithësi kjo është një botë e dhunshme” duke e përgjithësuar problemin. Ka nga ato që gjykojnë që ky është një **akt kalimtar** dhe duhet të durojnë pak se më pas do të largohet. Një tjetër arsyetim nga ato ishte: Ajo duhet të zgjidhë vetë problemin e saj dhe askush tjetër.

Dikush “i shikon gjërat në kompleks, por mendon shumë për fëmijët, pavarësisht që e kupton që dhuna e vazhdueshme i dëmton shumë fëmijët”.

Dikush tjetër: “**Nuk ka besim tek vetja** se kësaj beteje mund t’ja dalë, mund t’ja arrijë deri në fund”.

Dikush mendon të mos denoncojë “**për shkak të kulturës**”, thotë një pjesëmarrës nga komuniteti LGBT.

Në rastet kur dhuna është raportuar pjesëmarrësit në fokus grupet shprehin pohime të ndryshme.

Në disa raste gratë kanë gjetur mbështetjen e institucioneve ku janë drejtuar dhe kryesisht të policisë, gjykatës dhe NGO- ve , por në raste të tjera ato nuk janë mbështetur nga këto institucione. Në disa raste edhe pse është pranuar

denoncimi, ky ka mbetur vetëm në letër, nuk është marrë asnjë masë për të mbrojtur viktimën apo për të thirrur dhunuesin. Ndërsa për komunitetin LGBT është pak e vështirë pjesa e denoncimit thotë dikush tjetër pasi ata paragjykojnë në polici. Policët në të tilla raste thonë “shumë mirë ta bëri”.

Dhuna në familje dhe karakteristikat individuale.

Dhunuesit sipas pjesmarrësve kanë disa karakteristika individuale që lidhen me personalitetin e tyre. Një nga këto karakteristika është egoizmi. Një pjesmarrëse nga fokus grupi i grave të dhunuara shprehet: “*vijnë nga trajtimi i të qenit vetes uni, e kanë unin shumë të zhvilluar, vijnë nga jeta që bëjnë jashtë në shoqëri*”, ndërkohë që ajo rendit edhe faktorë të tjerë si: “*nga modelet e jashtme, vijnë nga media, vijnë nga shumë faktorë social që nga rrethojnë*”. Folësit shprehen se në shumicën e rasteve: “*kur ndodh dhuna gjithnjë ka konfrontim verbal midis palëve*”.

Në dhunën në familje ndikojnë **si faktorët e jashtëm ashtu edhe ata të brendshëm**. “Unë mendoj”, thotë njëri nga folësit e komunitetit LGBT se: “*problemet brenda për brenda zgjidhen, por janë faktorët e jashtëm që ndikojnë së tepërmi, unë po e marr shëmbullin nga vetja ime, kur familja ime mësoi për mua ata nuk shqetësoheshin si ndjehesha unë, por vrisnin mendjen se si do reagonin të tjerët ndaj kësaj*”, vazhdon: “*ofendimet që ata mund të dëgjonin rrugës ndaj meje unë e dija që kjo do t’i lëndonte ata. Ata e kanë lëndimin të dyfishtë, sepse ofendohen kur ne na ofendojnë, por preken edhe nga vetë fakti që ne kemi këtë prirje*”.

Folësit mendojnë se dhunuesit shpesh kanë shpërthime nervore. Ata dhunojnë në momente të caktuara kur janë të mbingarkuar me stres. Shpesh kanë mungesë vetkontrolli. Nga ana tjetër edhe gratë viktimat të dhunës në familje si rezultat i dhunës frekvente për një kohë të gjatë manifestojnë herë pas here shpërthime nervore, irritabilitet, ankth dhe simptoma të depresionit. Një pjesmarrëse e komunitetit rom shprehet: “*Ka momente që nuk e kontrolloj dot veten, pasi jam shumë e stresuar nga burri, i cili më dhunon fizikisht*”

Një fenomen i cili ndodh në marrëdhënien midis çiftit është **tradhëtia bashkëshortore**. Ky është dhe një nga shkaqet e shpeshta të divorceve. Folësit referojnë se është ndjesia më negative që individi përjeton kur kupton se

bashkëshorti apo bashkëshortja tradhëton. Një nga gratë e fokus grupit të grave të dhunuara shprehet se: “*ndihet e fyer, e poshtëruar kur partneri e tradhëton*”

Njëri nga bashkëfolësit shpreh mendimin se rastet e tradhëtisë bashkëshortore mund të justifikohen nga mjedisi shoqëror nëse si ndëshkim ndaj këtij veprimi njëri nga partnerët dhunon tjetrin.

Ndjenja e xhelozisë bëhet në mjaft raste shkak për dhunë psikologjike dhe fizike. Një nga pjesëmarrësit e komunitetit LGBT shprehet: “*Të gjithë kemi prirjen të jemi paksa të dhunshëm kur bëhemi xheloz, sekreti qëndron tek vetëkontrolli thotë një tjetër bashkëfolëse*”. “*Edhe pse xhelozia duket të jetë dytësore mund të ketë familje me nivel të mirë ekonomik dhe prapë të ketë dhunë, sepse ekziston xhelozia*”.

Shkaqe te tjera të dhunës në familje të renditura nga pjesëmarrësit në fokus grupet janë: dëshira për të ruajtur kontrollin mbi fëmijët, sidomos ndaj vajzave, autoriteti i vëllezërve ndaj motrave, shfrytëzimi ekonomik i viktimave, traditat e vjetra konservatore, mentaliteti për të ndrequr sjelljet e agresorit, trashëgimia, alkoli, ndjenjat psikologjike sadiste dhe humbja e kontrollit psikologjik, humbja e ndjenjës së dashurisë, imitimi i akteve të dhunës verbale politike, mungesa e mbrojtjes nga shteti të të dhunuarve, konfliktet ekonomike brenda familjes.

“*Njeriu duhet të jetë në punë, pasi puna të eliminon tre gjëra: mërzinë, veset dhe nevojat. Ndaj është mjaft pozitive, mungesa e saj çon drejt gjerave të këqia*”, thotë Ana nga komuniteti LGBT.

Papunësia rradhisin ato, është një tjetër faktor ndikues, pasi asistenca e tyre prej 2000 lekësh të reja nuk mjafton për asgjë dhe sherri në familje fillon hera – herës. Kur asgjë nuk mjafton për jetesë, tensioni familjar rritet.

Një tjetër folëse nga komuniteti LGBT pohon se: “*Kur ekziston dhuna në familje, edhe shoqëria do të jetë më e dobët*”.

Dhunuesit shpesh kanë **vese** të tilla si përdorues të alkoolit, drogës, frekuentues të lojrave të fatit etj. Një pjesëmarrëse nga fokus grupi i grave të dhunuara thotë: “*humbja e parave në lojrat e fatit, stresi i humbjes së parave, qoftë edhe ato pak para xhepi, bën që burri ta nxjerrë zemërimin e tij tek gruaja*”.

“*Nganjëherë janë dhe vetë fëmijët shkaktarë, pasi fëmija mund të ketë një lloj vesi që njëri nga prindërit s’e pëlqen si p.sh. të jetë gay dhe nis konflikti midis*

palëve kur ata nuk bien dakort me njëri tjetrin”, thotë një pjestar i komunitetit LGBT,(homoseksualiteti)

Dhuna në familje dhe format e shprehjes së saj. Kërcënimi për t’i nxjerrë jashtë nga shtëpia (*për moshën e tretë*), kërcënimi për t’i çuar në azil, kanë filluar të jenë një problem tjetër në shoqërinë tonë. Manushaqja nga fokus grupi i grave të dhunuara thotë: *“Ne e dimë, jemi një vend ku jemi rritur me tradita, ku gjyshi, prindi respektohej dhe nuk arrijmë t’i pranojmë format e reja që kanë hyrë”*. Ana nga komuniteti LGBT thotë: *“Janë shumë, mënyra presioni: për t’i marrë pensionin, braktisja për ta lënë në mes të katër rrugëve, mungesa e ilaçeve etj”*. Një fenomen i ri për shoqërinë shqiptare është edhe emigracioni, gjë që bën që familjet të ndahen fizikisht. Harresa për t’u interesuar, dhe fuqizimi ekonomik ndikon gjithashtu. Ela nga gratë e dhunuara thotë: *“harrojnë që kanë prindër, harrojnë të merren me ta. Dihet që një njeri me biznes është goxha i zënë, por ata harrojnë fare si për familjen ashtu dhe për prindin, harrojnë fare që kanë prindër”*. Një pjesmarrës i komunitetit LGBT shprehet: *“Dhuna në moshën e tretë është kryesisht verbale, pasi e dinë që dhuna fizike mund të shkaktojë dëme serioze për moshën e tretë. Ka dhe raste ku i izolojnë dhe s’i lënë të dalin apo i bëjnë të ndjehen të tepërt edhe kjo është formë dhunë”*.

Dhuna psikologjike është ajo që ndodh rëndom në familjet shqiptare. Një grua e dhunuar thotë: *“Kur ti e dhunon fizikisht në prezencë të fëmijëve, ti e ke dhunuar edhe psikologjikisht, pa diskutuar për dhunën seksuale që është edhe më e rëndë”*.

Dhuna seksuale. Pohohet nga pjesmarrësit se është prezente në çiftet. Eliverta nga komuniteti i grave të dhunuara shprehet. Ajo gjë është vështirë, nuk mund ta krahasoj detyrimin martesor se pastaj bëhet e pavlefshme, ajo është një dëshirë dhe një mirëkuptim në çift. Në qoftë se në çift ekziston mirëkuptimi, çdo gjë bëhet”.

Dikush nga komuniteti LGBT thotë: *“Bëhet dhe e detyrueshme sipas kushteve që krijon”. Nuk mund ta krahasoj detyrim të kryej marrëdhënie seksuale. Normale nuk është. Ajo është kënaqësi individuale, ajo shpreh dashurinë e çiftit në qoftë se partnerin e ndjen”*.

Mimoza nga komuniteti rom thotë: *“Detyrim nuk është, po ai të detyron, edhe na ka ndodhur. Nuk bëhet gjë me forcë, me dëshirë”*.

Ka raste kur gruaja detyrohet nga bashkëshorti për të kryer marrëdhënie seksuale edhe kur është e sëmurë. Nadirja komuniteti i grave të dhunuara shprehet: *“Të jesh me 40 nuk është kënaqësi të kryesh marrëdhënie seksuale, këto janë gjëra të përjetuara, të jesh gjithë natën pa gjumë me fëmijët, nuk besoj se është kënaqësi ndërkohë që bashkëshorti mund të vijë nga një darkë me shokët, apo nga një drekë me shokët”. “Në shoqërinë shqiptare ndodhin, dhe i pranojnë, pavarësisht se unë jam shqiptare jam në kundërshtim me këtë”.*

“Abolutisht jo, është një marrëdhënie e lirë dhe nëqoftëse unë nuk kam dëshirë nuk duhet ta bëj! Është përdhunim në qoftëse bëhet pa dëshirën time” thotë Mirela” nga komuniteti LGBT. *“Kodi penal ka një pikë që përfshin kryerjen e marrëdhënieve seksuale me dhunë mes çiftit, ka një masë ligjore për këtë që shkon deri në 7 vjet burg, thotë njëra nga bashkëfolëset”.*

Në komunitetin rom fillimisht kjo pyetje has në hezitim për t’iu përgjigjur. Por më pas gratë thonë se jo gjithmonë gruaja duhet të jetë e gatshme, ajo mund të mos ketë dëshirë ose të jetë sëmurë.

Dhuna fizike është një nga format që ndodh rëndom në komunitetin rom siç pohohet edhe nga pjesëmarrëset. Burrat e tyre nën ndikimin e shumë faktorëve dhunojnë gratë jo vetëm fizikisht por edhe emocionalisht e seksualisht. *“Vjen i dehur dhe ç’mund të bëjë tjetër* thotë Nadire. *“Ndodh që ndonjë shpullë e konsiderojnë normale sepse ai është burrë dhe ka disa të drejta më shumë, - shprehen ato.*

Në fokus grupin e grave të dhunuara dhe atë të komunitetit rom **gjendja ekonomike e rënduar** evidentohet ndjeshëm, ku predominon papunësia dhe varësia totale ekonomike nga bashkëshortët e tyre.

Trashëgimia dhe modelet familjare të edukimit. Në katër fokus grupet u diskutua rreth modeleve familjare të edukimit si dhe rolit të trashëgimisë në manifestimin e dhunës në familje. Shumica pohuan se trashëgimia dhe sidomos modeli i edukimit janë faktorë të rëndësishëm që influencojnë në ushtrimin e dhunës. *“Nëse ke patur një baba të dhunshëm, do të bëhesh i dhunshëm edhe ti si baba”* thotë një grua e komunitetit rom. Sipas pjesmarrësve, në mjaft raste niveli i edukimit nuk luan rol në ushtrimin e dhunës pasi ajo *“sot është e pranishme në të gjitha nivelet, shkolla s’ka të bëjë fare”* thonë ato.

Kjo është shume e vërtetë, miraton Ela. *“ka edhe persona me nga dy-tre mastera dhe në familjet e tyre gjithsesi ushtrojnë dhunë. Kjo mund të ndodhë kur gruaja*

është më e arsimuar sesa burri dhe burri e shpreh inferioritetin e vet me dhunë ndaj saj”.

Eksperiencia, duhet konsideruar si një element i rëndësishëm në zbutjen e fenomenit të dhunës në familje. Ky koncept u përmend nga pjesmarrësit në shumë momente të diskutimit të tyre. Bashkëjetesa është një eksperiencë sipas tyre, madje bashkëjetesë me diferencë brezash është një tjetër eksperiencë, ku gjatë saj arrin të kuptosh e zbutësh mjaft konflikte. Kjo si çështje u diskutua më gjerësisht me pjesmarrësit e komunitetit LGBT.

Ndërgjegjësimi i shoqërisë rreth dhunës në familje është një nga elementët më të rëndësishëm, është një proces në vazhdim dhe afatgjatë që kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve të saj. U diskutua rreth mënyrave të ndërgjegjësimit ku u përmendën informimi rreth fenomenit, denoncimi dhe manaxhimi i rasteve. U diskutua edhe rreth parandalimit ku të gjithë pjesmarrësit ishin dakort me faktin që është më e lehtë të parandalosh se sa të trajtosh edhe pse është një proces që kërkon shtrirje në kohë dhe vazhdimësi. Por në momentin që dhuna është prezente një rëndësi të veçantë ka **ndërhyrja e hershme**. Sa më herët të trajtohet, aq më të vogla janë pasojat e saj.

Shërbimet për luftën kundër dhunës në familje dhe etika e profesionistëve. Në Shqipëri ka mungesë shërbimesh për luftën kundër dhunës në familje. Edhe pse në qytetet kryesore qoftë në organet e policisë qoftë në sistemin gjyqësor apo në pushtetin lokal janë hapur struktura mbështetëse, kjo nuk është e mjaftueshme. Në disa raste edhe pse ekzistojnë mungon profesionalizmi. “*Në zonat rurale dhe të thella të vendit, si fshati ku banoj unë, - thotë një nga gratë e dhunuara, “shërbimet janë tërësisht inekzistente e nuk të vjen në ndihmë as policia e as komuna, po të trajtojnë sikur ke bërë turp që do të denoncosh burrin, edhe pse e dinë që më rrihte prej shumë kohësh.”* Pjesmarrësit pohojnë rëndësinë e trajtimit nga profesionistë të rasteve të dhunës në familje. Një grua e dhunuar thotë: “*Puna është ta çosh atë person deri te psikoterapia. Nëse kjo arrihet atëherë ka shpresë për një lloj përpunimi në mënyrë që personi të arrij të kuptojë që jeta nuk është vetëm dhunë”.*

Për komunitetin rom koncepti i psikologut, nuk është ende i perceptueshëm në formën e duhur. Por ato pohojnë se e ndjejnë nevojën për dikë, me të cilin të bisedojnë për problemet e tyre.

Perveç pjesës së nevojës për shërbime dhe profesionistë pjesmarrësit u shprehën edhe për **etikën** e tyre, si një element i rëndësishëm në trajtimin e rasteve të

dhunës në familje. Për mendimin tim thotë njëra nga pjesëmarrëset e grupit të grave të dhunuara: “*çdo profesion ka etikën e vet dhe nëse shohim gjininë në të, që aty fillon problemi. Megjithatë ka femra të cilat problemet që kanë nuk dëshirojnë t’ia thonë një mashkulli dhe mund të ndjehen më të lirshme tek një femër*”. Nëse një djalë i komunitetit LGBT është dhunuar ai mund ta ketë më të lehtë të flasë me një police femër sesa me një mashkull ose e kundërta, por kjo varet”.

Përveç shërbimeve për dhunën në familje që mbulohen nga shteti në Shqipëri **Shoqatat jo qeveritare (OJF)** kanë një rol të rëndësishëm si në parandalimin e dhunës, ndërgjegjësimin, ashtu edhe në trajtimin e rasteve dhe referimeve të tyre. Për këtë çështje pjesëmarrësit shprehën opinione të ndryshme. Disa nga bashkëfolësit mendojnë se kjo varet nga organizatat, disa organizata punojnë me seriozitet e përkushtim ndërsa disa të tjera jo. Teorikisht mendoj që luajnë rol pozitiv OJF-të thotë një grua e keqtrajtuar, por praktikisht varet nga kredibiliteti i shoqatës”.

Shumica e tyre përgjigjet pozitivisht. Disa prej tyre thonë se ekzistojnë shoqata nga të cilat kemi marrë ndihmë, ashtu sikurse ekzistojnë të tjera nga të cilat nuk kemi përfituar asgjë, (komuniteti rom).

Ndikimi i mediave dhe modeli i politikës. Roli i mediave është një rol mjaft i rëndësishëm në ndërgjegjësimin e opinionit publik si dhe identifikimin e problematikave, por “në disa raste ato kanë ndikuar negativisht pasi duke bërë gjithmonë prezente e kthejnë atë në një model për brezin e ri”, thotë Ervini nga komuniteti LGBT. Më shumë ka deklarime sesa ndëshkime dhe dënime për fajtorët. Kjo gjë nuk e parandalon dhunën.

Edhe **politika** në shoqërinë shqiptare prezanton një model. Një pjesëmarrëse shprehet: “*Normale janë modele. Kur përdoret gjuhë vulgare qoftë nga meshkujt, qoftë nga femrat në parlament, dhe në rrethe shoqërore që janë në nivele të larta edukative, çfarë mund të presësh pastaj nga nivelet e ultra*”?

L.T nga komuniteti LGBT pohon se: “*kur një figurë e lartë e shtetit shfaq dhunë si model për popullin, është më se normale që edhe populli do të përftojë të njëjtat mënyra komunikimi*”.

Ligji kundër dhunës në familje është një armë e rëndësishme në luftën ndaj saj. Gruaja tashmë është më e mbrojtur dhe dhunuesi ndëshkohet. Por jo gjithmonë ligji zbatohet me rigorozitet. Një pjesmarrëse nga grupi i grave të dhunuara shprehet se: *“Ligji nuk ka funksionuar siç duhet. Me këtë sistem drejtësie që është, nga përvoja ime personale, gjërat gjithmonë kanë gjeneruar, ndërhyrje, korrupsion, të të gjitha formave”*, vazhdon ajo.

Roli i policisë është mjaft i rëndësishëm në procesin e identifikimit, denoncimit dhe referimit të dhunës. Ka një angazhim shtetëror për këtë problem duke ngritur strukturat përkatëse. *“Kohën e fundit ka filluar dhe një ndërgjegjësime, ndoshta dhe me hyrjen e këtyre të rinjve në policinë e shtetit, krijimi i strukturave të veçanta për dhunën në familje, futja e brezit të ri ka anë shumë pozitive. Është ajo e para që përballlet me dhunën”* shprehet një grua e keqtrajtuar.

Në rastin e dhunës ekstreme thotë njëra nga bashkëfolëset, *“nuk mund të japë askush ndihmën përveç policisë, Duhet rritur roli i policisë”*. *“Policia, thotë ajo, po ndërgjegjësohet, por problemi qëndron tek drejtësia, pasi policia i kap dhe drejtësia i lëshon”*. *“Ka raste edhe kur deklarimet e policisë dalin në media, pra rrjedh informacioni nga policia, dhe këtë e kam të provuar vetë, sepse gjithmonë numrat e telefonit jam detyruar t'i ndërroj shumë shpesh për shkak të deklarimeve që bëja gjatë kallzimeve në polici”* shprehet një grua e dhunuar.

Njëra nga gratë e komunitetit rom, tregon se pasi ka dëshmuar në polici se dhunohej sistematikisht nga i shoqi, dhe ka patur ballafaqim të drejtpërdrejtë edhe me bashkëshortin e saj, ka zgjidhur problemin e saj, pasi sjellja e dhunshme e të shoqit ka ndryshuar radikalisht.

Edhe në rastin e dhunës seksuale, gratë sërish pohojnë se policia mund t'i ndihmojë dhe shpëtojë gratë, por ato kanë frikë se mund të bëhen objekt talljeje nga policia nëse pohojnë se janë dhunuar seksualisht nga burri i tyre.

Por edhe një herë shfaqet mosbesimi që këto gra kanë ndaj shtetit. Njëra prej tyre u shpreh se policia në disa raste nuk e ka kryer detyrën e vet. Ato dëshmojnë se disa herë kanë thirrur në ndihmë policinë, ajo nuk ka qenë e gatshme t'i ndihmojë, e siç thonë ato: *“të përzihet me punët e tyre”*.

KAPITULLI IV

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Përfundime

Ky studim hulumton një dizajn kërkimi të metodave të përziera të ofruar dhe skelat filozofike dhe metodologjike për të hartuar, grumbulluar dhe analizuar të dhënat, si cilësore ashtu edhe sasiore, që mund t’i përgjigjeshin pyetjeve të kërkimit. Pjesa sasiore ishte pjesa kryesore dhe pjesa cilësore ishte plotësuese për pjesën kryesore. Këto të dhëna sasiore u gjeneruan nga një pyetësor dhe të dhënat sasiore u plotësuan nga diskutimet në fokus grupe. Të dyja teknikat u nënshtruan trekëndëzimit. Qëndrimet metodologjike udhëhoqën procesin e analizës së të dhënave. Statistika përshkruese u përdorën dhe analiza e teorisë së bazuar ofroi mjetet për të analizuar të dhënat cilësore të grumbulluara nga fokus grupet. Të dy grupet e të dhënave, sasiore dhe cilësore, u eksploruan, analizuan dhe u krahasuan.

Konkluzione të Pjesës sasiore

Ky është një studim cilësor i hartuar për të shqyrtuar perceptimet, besimet dhe sjelljet e qytetarëve shqiptarë dhe grave të dhunuara, pasojat dhe mënyrat si duhet të menaxhohet dhuna në familje. “T’i japim zë” grave të abuzuara për të shprehur problemet e tyre me fjalët e tyre ka qënë fokusi kryesor i kësaj iniciative. Të dhënat cilësore hedhin dritë mbi kuptimin e dhunës nga këndvështrimi i grave të abuzuara që u intervistuan. Intervista të detajuara dhe të thella u kryen në dymbëdhjetë qarqe të ndryshme të Shqipërisë me 155 viktime të dhunës në familje si dhe me 405 qytetarë të moshave të ndryshme, rrethanave të ndryshme social ekonomike dhe historiku kulturor. Një nga pikat e forta të kësaj analize narrative/përshkruese është aksesimi që i jep ajo kontekstit kulturor në të cilin kryhet abuzimi. Kërkimi sugjeron se ka një ndërthurje shumë të komplikuar të faktorëve kulturorë, shoqërorë, ekonomikë dhe ndërpersonalë, të cilat mund t’i ekspozojnë gratë shqiptare ndaj një rreziku të lartë për t’u bërë subjekt i dhunës. Gjetjet e rrëzojnë mitin se dhuna në familje është në përgjithësi një problem i të varfërve dhe njerëzve të paarsimuar, si dhe tregon se abuzimi i kryqëzon kufijtë social-ekonomikë. Evidencat në këtë raport sugjerojnë se

marrëdhëniet tradicionale gjinore kanë imponuar një kosto të madhe mbi gratë. Megjithëse ndryshime të mëdha kanë ndodhur në Shqipëri në vitet e fundit, vendi nuk ka arritur akoma të çrrënjosë sjelljet e ngulitura fort në lidhje me statusin e varësisë së grave. Intervistat identifikuan tragjedinë afat gjatë që ka mbushur jetët e grave, disa prej të cilave kanë lënë shenja të thella nga dhimbja e fshehur, por gjithashtu kanë shfaqur edhe rezistencën e shumë grave. Vlerat tradicionale kanë induktuar në shumë nga gratë perceptimin e martesës si një nga qëllimet më të rëndësishme në jetët e tyre. Nëpërmjet martesës, gratë presin të arrijnë kushte sociale të dëshirueshme dhe një jetë që ja vlen ta jetosh. Gratë e shohin të qënurit e martuar si një element të rëndësishëm të identitetit të një gruaje. Traditat patriarkale të martesave me shkuesi nga autoriteti mashkullor përmenden akoma nga gratë. Martesa gjithashtu perceptohet si një mënyrë për t'i shpëtuar një mjedisi familjar të varfër dhe/ose abuziv. Ëndrrat e grave në lidhje me martesën vazhdimisht përplasen në mënyrë kontradiktore me realitetin e çdo dite dhe nga statusi i tyre i vartësisë në martesë. Kërkimi tregon se abuzimi në tipet e marrëdhënieve midis partnereve ka më shumë mundësi të ndodhë dhe vazhdojë aty ku çifti, veçanërisht burri, mban sjellje tradicionale përkundrejt roleve në familje. Gjetjet kanë vërtetuar se bashkëshortët abuzivë duket se dominojnë proceset e vendim-marrjes në familje, ndërsa nga gratë pritet të marrin përgjegjësi për punët e shtëpisë dhe kujdesin e fëmijëve.

Megjithëse gruaja mund të jetë në një nivel të lartë shoqëror dhe profesional, ajo nuk përjashtohet nga përballimi i gjithë ngarkesës së kryerjes së punëve të shtëpisë. Gratë supozohet të gjejnë plotësim në rolin e tyre si bashkëshorte e nëna dhe të përgatiten për të sakrifikuar jetën e tyre për hir të martesës. Partneriteti ndërmjet burrave dhe grave në përballimin e problemeve të jetës familjare është jo shumë i njohur për shumë çifte shqiptare. Gratë akoma duhet të veprojnë sipas rregullave të vendosura nga meshkujt. Shkeljet në rolet dhe pritshmëritë tradicionale të gjinive çojnë në abuzim fizik dhe psikologjik. Abuzimi i partnerit intim zakonisht është shfaqur të jetë një model i sjelljes dhe kontrollit abuziv, më shumë se një akt i izoluar i agresionit fizik. Përlllogaritjet e grave kanë provuar se abuzimi në familje është një fenomen kompleks sepse përfshin forma të ndryshme si ai verbal, emocional, fizik, seksual ose ekonomik. Dhuna fizike që pësojnë gratë varion nga një shpullë, deri tek një sulm me armë vdekjeprurëse. Ky studim ka treguar se mundësia për dhunë vdekjeprurëse kundrejt grave shqiptare mund të ndodhë përgjatë gjithë jetës së tyre. Gratë kanë treguar për krahun e tyre të thyer, trupat e tyre të djegur me cigare, armë të drejtura në kokë dhe kërcënimet me thika e granata. Shumë gra jetojnë me frikë

jo vetëm për jetët e tyre, por edhe për jetët e fëmijëve të tyre, familjes dhe miqve.

Eksperiencat e grave me dhunën seksuale variojnë në një gamë të gjerë, nga përdhunimi me forcë dhe sulmi tek kërcënimet, dhunimi verbal dhe forma të ndryshme jofizike të presionit për t'u përfshirë në marrëdhënie seksuale kundër dëshirës së tyre. Pranimi për të kryer marrëdhënie seksuale kundër dëshirës perceptohet nga disa gra si një mënyrë për të kundërvepruar ndaj inatit/zemërimit të bashkëshortit dhe si mënyrë për të shmangur dhunimin e mëtejshëm. Gra të tjera ndjehen të detyruara për të qënë në krye të detyrës dhe për t'i shërbyer nevojave të bashkëshortit të tyre, pavarësisht dëshirave të tyre personale. Akti seksual me forcë është provuar të jetë një mënyrë në të cilën gruas i hiqet 'zëri' dhe e mbulon heshtja, ajo kontrollohet dhe vihet në marrëdhënie vartësie. Në mënyrë frekvente gratë raportojnë poshtërim dhe manipulim emocional. Izolimi social ka qënë gjithashtu edhe një si strategji e përdorur nga partneret abuzivë për të rritur kontrollin e tyre dhe për të ulur aftësinë e grave për t'u larguar nga marrëdhëniet abuzive. Disa nga burrat abuzive i kanë ndaluar gratë të marrin pjesë në vendim-marrjen mbi shpenzimin e parave për nevoja bazë të familjes dhe shtëpisë.

Kontributet ekonomike të grave në familje nuk reduktojnë apo influencojnë pozicionin dominant të bashkëshortëve të tyre brenda familjes. Eksperienca e abuzimit në familje i ekspozon gratë ndaj një rreziku më të madh e ndaj një game të gjerë të problemeve fizike dhe të shëndetit mendor përfshi këtu plagosjet, depresionin, ankthin, stresin post-traumatik, çrregullimet mendore, çrregullimet e gjumit, vetëvlerësim i ulët dhe mendimet për të kryer vetëvrasje. Plagët nuk janë e vetmja pasojë fizike: çrregullimet fizike, abortet, lindjet e parakohshme dhe shtatzënitë e padëshirueshme janë midis të tjerash pasoja të tjera fizike të rënda, të cilat gratë duhet t'i përballojnë. Efektet e përjetimit të dhunës gjithashtu përfshijnë pamundësinë për t'u marrë me punët e përditshme apo aktivitete sociale. Gratë i perceptojnë pasojat psikologjike të abuzimit të jenë edhe më serioze se efektet fizike. Kur burimet që furnizojnë aftësitë personale për të përballuar situatat shterojnë, shumë gra i kthehen mjekimit me medikamente, shpeshherë e perceptuar si një filtër mbrojtës ndaj ngjarjeve traumatike. Gjetjet ilustronë procesin nëpërmjet të cilit gratë demoralizohen dhe përdhunohen në marrëdhëniet abuzive. Procesi i abuzimit varion nga mënyra se si gratë e shohin veten e tyre, marrëdhëniet e tyre dhe vendin që ato zënë në botë. Dhuna në familje ka ndikim shumë të madh mbi fëmijët, edhe nëse ata

aktualisht përjetojnë apo jo abuzim fizik. Fëmijët e grave në këtë studim kanë zhvilluar shumë probleme konjitive, emocionale, somatike dhe të sjelljes. Midis këtyre, gratë kanë përmendur nivele të ulëta të kompetencës sociale ose në shkollë, ankthin, irritimin dhe sjelljet agresive, dhimbjet e kokës, urinimit në shtrat dhe çrregullimet e gjumit. Gratë gjithashtu shprehën shqetësimin e tyre në lidhje me ndikimet e modelit të babait në zhvillimin e fëmijëve të tyre.

Një hap i rëndësishëm në menaxhimin e dhunës është të kuptuarit e shkaqeve të abuzimit. Pavarësisht së të gjithë të intervistuarit identifikojnë shkaqe të ndryshme për dhunën në familje, ai më dominant i përshkruan si një problem social që buron nga një shoqëri, që nuk ka ekuilibra dhe që ka ngecur midis traditacionales dhe modernes. Shkaku kryesor i abuzimit në familje perceptohet të jetë varfëria, e cila gjeneron stres dhe një ndjenjë dështimi tek burrat që kanë dështuar në rolin e tyre tradicional të atij që fiton bukën e përditshme/siguron financat. Shkaqe të tjera të cituara shpesh për dhunën në familje janë abuzimi i dhunuesit me alkoolin dhe xhelozia e tij. Dhuna në familje gjithashtu ndërtohet edhe si produkt i mosfunksionimit emocional të burrave, si depresioni apo një vlerësim i ulët ndaj vetes. Ky fokus mbi shkaqet emocionale të dhunës në nivelin individual krijon një justifikim për aktet e dhunshme që janë perceptuar të shkojnë përtej kontrollit të dhunuesit. Gra të tjera i perceptojnë burrat si qenie njerëzore agresive nga natyra. Disa gra fajësojnë veten për abuzimin dhe ato besojnë se kanë dështuar në rolet e tyre si gra dhe si nëna. Rrëfimet e pjesëmarrëseve reflektojnë se gratë janë socializuar për të pranuar përgjegjësinë kryesore për suksesin e martesës së tyre dhe për kujdesin e mirëritjen e fëmijëve të tyre. Ato besojnë në sakrificimin e të drejtave të tyre individuale për hatër të fëmijëve. Kjo sjellje ka futur në kurth shumë gra në marrëdhënien abuzive për shkak të qëllimit të tyre në mbajtjen e familjes së pacënuar me çdo kusht. Gratë përmendën shpresën, shmangien, riformimin dhe kompromisin si strategji që i ndihmojnë ato të durojnë dhunën.

Një strategji e rëndësishme për të eliminuar dhunën është ndërgjegjësimi se situata, që ato përjetojnë është e gabuar dhe se ka hapa që ato mund t'i hedhin për të përmirësuar jetët e tyre. Divorci është një nga strategjitë aktive të përmendura nga gratë. Pavarësisht pas shumë pengesash, gratë të cilat divorcohen kanë refuzuar të jenë viktimat pasive të dhunës në familje. Ndikimi i influencës së divorcit nga një partner i dhunshëm është përmendur shpesh nga gratë. Pjesëmarrëset ndjejnë se ato rifitojnë dinjitetin e tyre, ndjesinë e vetëvlerësimit dhe kontrollin personal mbi jetët e tyre. Gratë luftojnë fort për të fuqizuar veten e tyre në mënyre që të gjejnë mënyra të reja për të jetuar dhe rimenduar vendin e tyre në botë. Rrëfimet e grave kanë bërë të dukshme

tolerancë kulturore dhe sociale ndaj dhunës në familje. Thyerja e heshtjes që rrethon këtë çështje të ndjeshme konfirmon praninë e gjerë të dhunës në familje dhe thellësinë e pasojave të saj. Dëshira për të fuqizuar viktimat të tjera të dhunës nëpërmjet rrefimit, u tregua gjithashtu nga gjetjet e kërkimit. Gratë shprehën shpresën që dhënia zë e protestës së tyre ndaj dhunës në familje do të çonte në ndryshime të normave kulturore, ligjeve dhe politikave sociale në mbrojtje të drejtave të grave. Gjithsesi, gratë në Shqipëri nuk duhet të presin që shteti të marrë iniciativën për adresimin e këtyre çështjeve kritike - janë vetë gratë, që në nivelin e shoqërisë civile duhet të marrin në dorë fatin dhe të luftojnë vetë. Përgjigjet e grave në këtë studim qartësojnë mënyrën se si dhuna iu ka hequr atyre kapacitetet emocionale dhe fizike sepse ato vazhdimisht provojnë të mbrojnë identitetin e tyre thelbësor si gra. Gratë e abuzuara kanë nevojë për këshillim profesional për të kapërcyer këto ndjenja negative dhe të rimendojnë mënyrën e tyre të jetuarit. Gjetjet e këtij studimi gjithashtu kërkojnë për ndryshime në politikat që mbajnë fuqinë gjinore të pabarabartë, si në sferat e jetës publike ashtu dhe asaj private. Në respekt të dhënies zë për gratë shqiptare dhe për të inkurajuar fuqizimin e tyre, ky raport përfaqëson një hap përpara. Ne kemi pritshmërinë se ky proces i të kuptuarit të domethënies kulturore lokal të dhunës në familje dhe perceptimeve individuale, sjelljeve dhe përgjigje ndaj saj, mund të përdoret si një bazë domethënëse për zhvillimin e ndërhyrjeve të përshtatshme për uljen e rasteve të dhunës dhe parandalimin e saj në Shqipëri.

a. Shfaqjet e dhunës ushqehen së tepërmi nga një mentalitet kolektiv ende i pranishëm sipas të cilit dhuna është fatale në shoqëri dhe se shpesh në familje ajo është strukturuese e disa raporteve sociale të caktuar.

b. Në fazën e tranzicionit lindin edhe një sërë dukurish të tjera që e nxisin dhunën në familje, sikurse është një ftohje e marrëdhënies shoqërore brenda saj, konfliktet ekonomike dhe pronësore si edhe në lloj humbje e respektit dhe e ndjenjës së detyrës në raport me më të moshuarit.

c. Fushatat e sensibilizimit dhe ato të informimit janë ende të dobëta dhe nuk kanë efektivitetin e duhur. Forcimi i punës sociale dhe i solidaritetit shoqëror, forcimi i qendrave kundër dhunës, i organizmave pritës ndaj viktimave të dhunës, është një tjetër masë efikase.

d. Izolimi i familjes aktuale në vetvete e shton mundësinë e dhunës dhe potencialet e agresivitetit sidomos të burrit ndaj gruas prandaj socializimi nëpërmjet punës i tyre do ta hapte familjen drejt shoqërisë së madhe dhe opinionit të gjerë të shoqërisë.

e. Krahas policisë që ndërhyjnë në rastet e dhunës flagrante, del nevoja e përpunimit të një sërë agjencish që kanë në fokus luftën kundër dhunës në familje. Shumë më tepër mund të bëjë pushteti lokal, shkolla, sikundër kabinetet psikologjike, si edhe gjykatat.

Konkluzione të Pjesës Cilësore

Konkluzione të përgjithshme nga 4 fokus grupet

1. Është mjaft i rëndësishëm ndërgjegjësimi i metejshëm i shoqërisë dhe veçanërisht i gruas shqiptare rreth dhunës në familje dhe pasojave të saj.
2. Vazhdon të ndikojë tradita dhe mentaliteti në mënyrën e perceptimit të dhunës.
3. Dhuna në familje ndodh si për shkak të faktorëve të jashtëm ashtu edhe për shkak të faktorëve të brendshëm.
 - a- Ndër faktorët e jashtëm renditen: shoqëria, papunësia, gjendja ekonomike,
 - b- Ndër faktorët e brendshëm përmenden familja dhe modelet familjare, marrëdhëniet brenda saj, eksperiencat në bashkejetesë, karakteristikat individuale të personalitetit të individit.
4. Përveç ndikimit pozitiv të mediave në identifikimin dhe denoncimin e dhunës, ato ndikojnë edhe negativisht duke prezantuar modele dhune.
5. Dhuna seksuale është prezente edhe pse ajo nuk deklarohet me lehtësi.
6. Roli i OJF-ve në fushën e dhunës në familje është një rol shumë pozitiv dhe shteti duhet t'i shohë si partnerë në rrugën e luftës kundër dhunës në familje.

Konkluzione specifike

Fokus Grupi i Komunitetit Rom

1. Gruaja vazhdon të jetë e diskriminuar në familjen shqiptare.
2. Gruaja në mjaft raste konsiderohet si pronë e bashkëshortit mbi të cilën ai ka të drejta të plotë të bëjë çfarë të dojë.
3. Në zonat malore dhe ato rurale dhe brenda komunitetit rom denoncimi i dhunës vazhdon të jetë tabu.
4. Ligji duhet të zbatohet nga intancat perkatëse, pasi në mjaft raste nuk zbatohet. Mungon shpresa se ligji do të zgjidhë problemin e dhunës në familje.
5. Koncepti i psikologut nuk është i qartë, por ndiejnë nevojën për të ndarë me dikë problemin e dhunës.
6. Për këtë komunitet arsyet pse gruaja dhunohet në familjen shqiptare janë: papunësia, veset e bashkëshortit, marrëdhëniet jashtëmartesore.
7. Gratë shpesh ngurojnë të denoncojnë dhunën pasi janë të detyruara të qëndrojnë në këtë marrëdhënie për shkak të pamundësisë ekonomike.
8. Personi më i afërt për to për të denoncuar dhunën është prindi (nëna) e më pas policia.
9. Martesat me shkesi bëhen më tepër objekt i dhunës për to.
10. Nuk kanë besim tek policia se mund t’i ndihmojë në rastin e dhunës seksuale në familje, por mendojnë se policia mund t’i ndihmojë dhe shpëtojë keto gra nga dhuna, vecanërisht nga përdhunimi.
11. Dhuna seksuale konsiderohet një akt i turpshëm dhe si e tillë më mirë do ishte të mbetej brenda familjes.
12. Për gratë e këtij komuniteti është më e lehtë t’i drejtohen një personi femër në polici, sesa mashkull.

13. Dhuna fizike dhe emocionale në disa raste është prezente në këtë komunitet edhe ndërmjet çifteve të moshuara.
14. Disa nga shkaqet për ushtrimin e dhunës në çiftet e moshuara janë: përdorimi i alkoolit, problemet e komunikimit, gjendja e keqe ekonomike.
15. Fëmijët e vegjël dhunohen fizikisht nga prindërit e tyre, kryesisht nga baballarët por edhe nga nënat.

Fokus grupi i Komunitetit LGBT

1. Është më lehtë të parandalosh se sa të trajtosh.
2. Modelet familjare të edukimit duhen të konsiderohen si një element i rëndësishëm në procesin e parandalimit të dhunës në familje.
3. Të rinjtë shqiptarë të komunitetit LGBT ndihen në një presion psikologjik nga familja dhe shoqëria për shkak të orientimit që kanë.
4. Divorcet të cilat janë finalizimi i një marrëdhënie të dështuar janë shtuar.
5. Eshtë rritur aksesimi ndaj shërbimeve të ofruara nga shteti dhe cilësia e tyre përsa i përket dhunës në familje.
6. Politika Shqiptare gjithashtu prezanton modele dhune në disa raste.
7. Në disa raste strukturat shtetërore janë të korruptuara dhe/ose me mungesë profesionalizmi dhe kjo bën që të mos zbatohet si duhet ligji kundër dhunës në familje.
8. Për komunitetin LGBT dhuna seksuale konsiderohet si një problem shumë intim dhe duhet të zgjidhet brenda partnerëve.
9. Prindërit shpesh ushtrojnë dhunë psikologjike tek fëmijët e tyre kur mësojnë orientimin seksual të fëmijës së tyre.
10. Ndihen konfuzë, pasi orientimi i tyre, i cili nuk pranohet nga prindërit konfrontohet me dëshirën për të mos i braktisur ata.

11. Prindërit fajësojnë veten kur mësojnë për orientimin e fëmijës së tyre.
12. Për komunitetin LGBT personi më i përshtatshëm për t’u referuar në rast dhune janë në fillim punonjësi social dhe pastaj policia.
13. Nëse mardhënia seksuale kryhet jashtë dëshirës së njërit nga partnerëve, kjo duhet konsideruar si përdhunim.
14. Prindërit e fëmijëve të komunitetit LGBT ndihen të dhunuar nga opinioni që është mjaft gjykues për këtë kategori.

Komuniteti i grave të dhunuara

1. Stigma është prezente dhe ka ndikim negativ në marrjen e iniciativave për të luftuar dhunën.
2. Si rezultat i ndërgjegjësimit më të madh është rritur numri i denoncimeve të rasteve të dhunës në polici.
3. Në zonat malore dhe ato rurale denoncimi i dhunës vazhdon të jetë tabu.
4. Ligji duhet të zbatohet nga instancat përkatëse, pasi në mjaft raste nuk zbatohet. Përgjegjësia kryesore sipas ligjit i takon njësisve të qeverisjes vendore ku në shumicën e tyre nuk zbatohet mekanizmi i referimit të viktimave dhe koordinimi i aktorëve lokalë.
5. Nuk ka asnjë denoncim sipas ligjit nga mjekët e familjes në të gjithë vendin dhe shihen probleme të mëdha të zbatimit të ligjit nga punonjësit e përmbarimit, veçanërisht pas privatizimit të tij.
6. Gruaja në mjaft raste konsiderohet si pronë e bashkëshortit mbi të cilën ai ka të drejta të plotë të bëjë çfarë të dojë.
7. Në disa raste strukturat shtetërore janë me mungesë profesionalizmi dhe kjo bën që të mos zbatohet si duhet ligji kundër dhunës në familje.
8. Është e domosdoshme ngritja e shërbimeve psikologjike për viktimat e dhunës në familje.

9. Dhuna nuk njeh kufij. Ajo mund të ushtrohet nga intelektualli dhe jo intelektualli.
10. Në raste të dhunës fizike dhe seksuale gratë e dhunuara janë të mendimit se mund të shprehen tek motra, prifti, qendrat e këshillimit të grave.
11. Denoncimi në polici i një dhune të vazhdueshme jo gjithmonë e ruan konfidencialitetin e denoncimit.
12. Denoncime anonime të aktesh dhune në familje prej organeve të rendit nga komshinj, miq të panjohur që ndodhen të pranishëm janë një mënyrë civilizimi e shoqërisë.
13. Një bashkëshorte në respekt të detyrimeve të veta martesore nuk mund të jetë kurdoherë e gatshme për të plotësuar kënaqësite seksuale të partnerit të vet kur ai kërkon, por në shoqërinë shqiptare ndodhin, dhe i pranojnë.
14. Dhuna fizike dhe emocionale është prezente edhe në moshën e tretë dhe në pak raste denoncohet nga ata.
15. Në shumë raste shërbimet e ofruara nga shteti për fëmijët dhe të moshuarit në lidhje me dhunën në familje nuk janë të arritshme për këtë moshë.
16. Punonjës të zyrave të dhunës pranë policisë transferohen shpesh dhe nuk krijohet lidhja dhe besimi i nevojshëm me strukturat

Rekomandime

Për popullsinë Rome

- 1- Hartimi i programeve sensibilizuese mbi dhunën në familje sidomos për dhunën fizike dhe seksuale për zonat rurale dhe komunitete vulnerable si ai rom, zona të komuniteteve të migruara .
- 2- Zbatimi i Ligjit kundër dhunës në familje nga të gjithë aktorët.
- 3- Ngritja e shërbimeve psikologjike sa më afër komunitetit, për këshillimin e grave të komunitetit rom.
- 4- Krijimi i hallkave lehtësuese për denoncimin e rasteve në polici.
- 5- Krijimi i mundësive për punësim të grave rome me qëllim që të ndihen të pavarura ekonomikisht nga bashkëshortët e tyre.
- 6- Rritja e numrit të grave police të angazhuara në sektorin e dhunës pranë rajoneve të policisë më qëllim lehtësimin e komunikimit të grave të komunitetit rom.

Për komunitetin LGBT

- 1- Ngritja e shërbimeve psikologjike për këshillimin e këtyre personave të cilët ndihen mjaft të frustruar.
- 2- Përfshirja në strategjitë e luftës kundër dhunës në familje edhe të programeve për komunitetet të veçanta si ai LGBT.
- 3- Ndërgjegjësimi i profesionistëve dhe policisë për të ofruar ndihmë në këtë komunitet.
- 4- Ndërgjegjësimi i këtij komuniteti për problemet e dhunës në familje.

Për Gratë e dhunuara

- 1- Programe për parandalimin dhe ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave
- 2- Programe të ndërhyrjes së hershme
- 3- Ngritja e shërbimeve psikologjike për këshillimin e tyre.
- 4- Fuqizimi i sistemit të referimit të rasteve me një plan të detajuar se ku shkon viktimja nga një shërbim në tjetrin.
- 5- Trainimi i strukturave të policisë me njohuri të avancuara dhe bashkëkohore rreth dhunës në familje dhe mos transferimi i shpeshtë i punonjësve të njësive kundër dhunës në familje.
- 6- Trainimi i gjykatësve me njohuri rreth dhunës në familje.
- 7- Koordinimi më i mirë i strukturave përgjegjëse shtetërore, lokale me ato të shoqërisë civile për luftën kundër dhunës në familje.
- 8- Përsa i përket marrëdhënies seksuale me dhunë kërkohet një edukatë seksuale shumë e gjatë dhe marrje informacioni nga forma dhe nga burime të ndryshme. Edukata në shkolla në planin seksual duhet riparë, sepse shpesh ajo ndalet thjesht në aspekte fiziologjike dhe jo më tepër. E mbi të gjitha praktikatat këshillimore si për gratë dhe për burrat që mund të kryhen në grup, ose edhe në komunikime të personalizuarra telefonike, etj.
- 9- Dhuna në familje ndodh si në hapësira private, ashtu edhe në ato publike. Ajo merr forma mjaft të ndryshme që nga dhunimi në familje deri tek përdhunimi, tortura psikologjike, trafikimi, shfrytëzimi seksual dhe praktikatat e dëmshme, ndër të tjera. Aktet e dhunës ndodhin në mjedise të ndryshme (në shtëpi, rrugë, shkollë, punë, situata konflikti) dhe prekin grupe nga më të ndryshmet (ku përfshihen ato rurale/urbane, të pasurit/të varfërit, të rinjtë/të rriturit, emigrantët, të shpërngulurit, indigjenët, me aftësi të kufizuara dhe gra me HIV). Një reagim efikas kërkon që ligjet, rregullat, shërbimet dhe veçanërisht mbledhja e të dhënave të dallojnë dhe të prekin shfaqjet e ndryshme të dhunës dhe të hartojnë strategjitë e duhura në bazë të konteksteve specifike në të cilat ato ndodhin.

- 10- Hartimi i politikave, programeve dhe reagimeve praktike varet nga të dhënat e besueshme. Kjo përfshin informacion për përhapjen, shkaqet, të mbijetuarit dhe personat që ushtrojnë dhunë në familje; ndikimin e ndërhyrjeve dhe rezultatet e sektorit publik në termat e mundësive për t’iu drejtuar shërbimit shëndetësor dhe reagimeve të policisë dhe gjyqësorit; qëndrimet, sjelljet dhe përvojat e burrave, grave dhe të rinjve nga grupe të ndryshme të popullsisë dhe si e perceptojnë ata këtë çështje në shoqërinë e tyre; si dhe kostot sociale dhe ekonomike të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Këto të dhëna janë thelbësore për të matur progresin e nismave kundër dhunës në familje, për të hartuar strategji efikase dhe për të caktuar buxhete.
- 11- Trajtimi i dhunës në familje kërkon një reagim shumë-dimensional ku përfshihen organizmat qeveritare, organizatat jo fitimprurëse dhe subjekte të tjera nga sektorë dhe disiplina të ndryshme. Përveç institucioneve që janë përfshirë që në fillim në këto përpjekje (si psh. shëndetësia, siguria publike, organizmat ligjore, ministritë që trajtojnë çështjet e grave), duhet të përfshihen edhe faktorë të tjerë kyç - si psh. institucionet arsimore, punëdhënësit, sindikatat, media, ministria e financave dhe sektori privat në kuadër të përgjegjësisë sociale. Ndërhyrjet duhet të përbëhen si nga sistemet e shërbimit dhe të referimit për të mbijetuarit/viktimat e dhunës, ashtu edhe nga përpjekjet më të gjera të parandalimit që përqendrohen në mobilizimin e shoqërisë dhe komunitetit për “tolerancën zero” dhe barazinë gjinore. Mbështetje e gjithanshme do të thotë të trajtosh shumëllojshmërinë e nevojave dhe të drejtave të grave dhe vajzave, që përfshin sigurinë, shërbimet shëndetësore, ligjore dhe gjyqësore dhe sigurinë ekonomike për veten, fëmijët apo personat e tjerë në varësi.
- 12- Të mbijetuarit e dhunës në familje kanë nevojë për mbështetje të “vijës së parë” nga policia por edhe nga organizmat e tjerë që përcakton ligji si qeveria vendore, shëndetsia dhe zbatimi rigoroz i ligjit. Ndërkohë që krijohen mundësitë e ndihmës në shkallë më të gjerë dhe më afatgjatë, të gjitha institucionet duhet të sigurojnë standardet për të përmbushur nevojat urgjente. Në varësi nga konteksti kombëtar, ato duhet të përfshijnë: ofrimin e sigurisë dhe mbrojtjes së duhur për të mbijetuarit/viktimat; mundësinë universale për të përdorur të paktën një linjë telefonike 24 orëshe pa pagesë për të raportuar abuzimin dhe situata të tjera me rrezik për jetën ku gjenden edhe këshillues profesionistë e me eksperiencë që mund t’i referojnë telefonuesit tek shërbimet përkatëse;

një strehëz për çdo 10 mijë banorë që ofron strehim të sigurt në rast urgjence si për rastet e marrjes së një UMM apo edhe për afate kohore më të gjata, këshillim të kualifikuar dhe ndihmë tjetër të nevojshme; një qendër avokatie dhe këshillimi për çdo 50 mijë gra që t’u ofrojë ndihmë të mbijetuarve/viktimave; një qendër për rastet e përdhunimeve për çdo 200 mijë gra; dhe mundësi për të marrë trajtim shëndetësor cilësor pas përdhunimit (që përfshin testin e shtatëzanisë, kontraceptivët e urgjencës, profilaksinë pas-faktit për të parandaluar HIV-in dhe trajtim për infeksionet që transmetohen seksualisht, trajtim për lëndimet dhe këshillim psiko-social). Këto shërbime nuk duhet të kushtëzohen nga dhuna që i mbijetuari/viktima raporton në polici dhe duhet të ndiqen nga një mbështetje afatgjatë shëndetësore, ligjore, psiko-sociale, arsimore dhe ekonomike.

- 13- Ligjet dhe zbatimi i tyre janë thelbësore për t’i dhënë fund mungesës së ndëshkimit. Ato përcaktojnë kufijtë për normat dhe sjelljet publike. Ato garantojnë të drejtat që duhet të gëzojnë të gjithë njerëzit dhe përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrimet e personave të caktuar për mbrojtjen e tyre. Ligjet për të ndalur dhunën duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të ndihmojnë për të parandaluar, reaguuar dhe ndëshkuar të gjitha format e dhunës kundër grave dhe vajzave. Dhuna në familje dhe të drejtat e grave dhe vajzave duhet të konsiderohen si shqetësimi madhor i të gjitha ligjeve, politikave dhe programeve - duke përfshirë të drejtat e tyre për siguri personale, intimitet dhe fshehtësi, vendimmarrje të informuar dhe autonome, shërbime shëndetësore dhe sociale dhe për drejtësi. Kjo nënkupton gjithashtu dispozita ligjore që parashikojnë të drejta që mund të përcaktojnë nëse një grua ka mundësinë për t’u larguar nga një situatë abuzive, më konkretisht, të drejtat e gruas për ndihmë dhe kujdestarinë e fëmijës; të drejtat ekonomike, të pronës, të tokës dhe trashëgimisë; si dhe shtetësi dhe status emigranti. Pavarësisht nëse mbizotërojnë sistemet formale apo zakonore të drejtësisë, ato duhet të mbështesin të drejtat e grave dhe vajzave. Ligjet dhe zbatimi i tyre duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut, siç parashikohet në konventa, marrëveshje apo mekanizma të ndryshëm.
- 14- Një pjesë e grave nuk fillojnë dot procedurat e divorcit apo të ndarjes së pasurisë, pasi ligji nuk parashikon asnjë lehtësim financiar edhe në rastin kur gjykata ka provuar se gruaja është viktimë e dhunës në familje e do të rekomandohej me forcë reduktimi ose heqja e këtyre tarifave në të tilla situata.

- 15- Duhet të përcaktohen standarde të qarta për zbatimin dhe monitorimin e ligjeve, politikave dhe programeve nëpërmjet instrumentave dhe procedurave të ndryshme që i përforcojnë dhe i institucionalizojnë ato. Protokollat, si brenda sektorit ashtu edhe ato ndërsektoriale, mund të ofrojnë udhëzime të rëndësishme për punonjësit dhe të caktojnë standarde pune e funksionimi. Këto standarde gjithashtu mund të shërbejnë si tregues për të matur progresin apo përgjegjësitë, si dhe për të përfshirë përmirësimet. Protokollat dhe procedurat duhet të jenë në përputhje me të drejtat e rekomanduara dhe të miratuara në arenën ndërkombëtare si dhe me standardet e ofrimit të shërbimeve.
- 16- Planet Kombëtare të Veprimit që i kushtohen trajtimit të dhunës në familje mund të jenë instrumente të vlefshme për të përcaktuar burimet institucionale, teknike dhe financiare të nevojshme për reagimet e bashkërenduara e ndërsektoriale. Ato mund të parashtrajnë mekanizmat e llogaridhënies dhe mund të qartësojnë përgjegjësitë institucionale. Ato mund të shërbejnë gjithashtu për të monitoruar progresin drejt objektivave specifike. Ministrinë të cilave u është ngarkuar bashkërendimi (Ministria e Punës) ka nevojë për mbështetje politike në nivelet më të larta të qeverisë, si dhe për mbështetjen e nevojshme institucionale dhe financiare për të përmbushur këtë detyrë komplekse. Garantimi që veprimet për të trajtuar dhunën ndaj grave dhe vajzave të integrohen në politika të tjera kryesore dhe kuadre financimi mund të ofrojë gjithashtu rrugët strategjike për forcimin e përpjekjeve dhe sigurimin e buxheteve. Shembuj të tyre përfshijnë strategjitë dhe planet kombëtare për reduktimin e varfërisë dhe zhvillimin, si dhe reforma sektoriale në lidhje me arsimin, shëndetësinë, drejtësinë, HIV/SIDA-n, etj.
- 17- Shumë shpesh politikat dhe ligjet miratohen pa pasur fonde për zbatimin e tyre. Duhet bërë një vlerësim i buxhetit për t'u siguruar se ato plotësojnë nevojat e popullsisë, i shërbejnë si duhet zonave gjeografike të varfra dhe garantojnë barazi, si dhe sjellin përfitime për gratë dhe vajzat për të cilat hartohen. Konsideratat financiare duhet të bazohen tek kostot dhe duhet të përfshijnë aspekte në dukje periferike, por që në të vërtetë janë thelbësore si psh. ndihmë mjekësore dhe ligjore falas apo transport në mënyrë që gratë dhe vajzat të mund të përdorin shërbime të tjera ligjore, si dhe ndihmë për ri-integrimin e tyre social-ekonomik. Ndihma financiare për të mbijetuarit/viktimat mund të sigurohet nëpërmjet skemave novatore, si psh. fonde të administruara në mirëbesim në të cilat

mund të derdhin kontributet si shteti ashtu edhe aktorë të tjerë (individë, organizata apo donatorë privatë). Burimet janë të nevojshme për të garantuar zhvillimin e aftësive të sektorëve dhe profesionistëve të ndryshëm që kanë përgjegjësi për të zbatuar ligjet dhe programet. Duhet caktuar fonde publike të mjaftueshme për organizatat jo-fitimprurëse dhe grupet e grave, si dhe shërbimeve për të mbijetuarit/viktimat për punën dhe kontributet e tyre.

- 18- Shumë shpesh ka një tendencë për të “ofruar” politika dhe shërbime pa e përfshirë publikun nëpërmjet qasjeve fuqizuese që i mundësojnë njerëzit të “kërkojnë” dhe t’i përdorin këto shërbime si dhe të kërkojnë llogari. Ndryshimet e vërteta dhe që zgjasin për t’i dhënë fund dhunës në familje duhet të përqendrohen në nivelin lokal dhe të komunitetit, ku ndodhin aktet e abuzimit dhe ku, shumë shpesh, ato tolerohen. Strategjitë duhet të fuqizojnë gratë dhe vajzat për të kërkuar të drejtat e tyre për drejtësi, mbrojtje dhe ndihmë; duhet t’u japin njohuri për të drejtat e tyre dhe detyrimet e qeverisë; si dhe duhet të sigurojnë bashkëpunimin me qendrat e grave dhe grupet avokatore, si dhe organizatat e të rinjve, burrave apo të tjera që i kushtohen barazisë gjinore. Arsimi publik në masë dhe fushatat e ndërgjegjësimit për këto çështje, edhe nëpërmjet mediave lokale dhe kombëtare, janë elementë të rëndësishëm. Mobilizimi i komunitetit për barazinë gjinore dhe jo dhunën është thelbësor për të ndërprerë dhunën në familje, veçanërisht ndërmjet burrave, të rinjve dhe grupeve të tjera strategjike.

Për fëmijët

- 1- Ngritja e shërbimeve identifikuese të rasteve të fëmijëve të keqtrajtuar.
- 2- Hartimi i programeve sensibilizuese me qëllim denoncimin e dhunës që ushtrohet karshi tyre
- 3- Hartimi i programeve për ndërhyrjen e hershme.
- 4- Hartimi i programeve ndërhyrëse në procesin e edukimit me qëllim parandalimin, dhe minimizimin e pasojave të dhunës në familje.

- 5- Trainimi i personelit mjekësor për identifikimin dhe trajtimin e rasteve urgjente të fëmijëve viktimë të dhunës në familje.
- 6- Trainimi i personelit edukues (mësues, edukatorë të kopshteve dhe çerdheve) me njohuri bashkëkohore rreth dhunës në familje.
- 7- Hartimi i programeve trainuese për gjykatësit dhe psikologët pranë gjykatave për çështjet civile e familjare, të rasteve kur fëmijët janë gjithashtu pjesë e keqtrajtimit.
- 8- Koordinim efektiv të njësive për mbrojtjen e fëmijëve me qëllim jo vetëm referimin e rasteve, por edhe trajtimin e tyre sa më të sukseshëm.

Për të moshuarit

1. Përshirja në strategjitë e ndërgjegjësimit të publikut për dhunën në familje edhe programe për moshën e tretë me qëllim denoncimin e dhunës të ushtruar mbi ta.
2. Nxitjen dhe mbështetjen lobiste të përmirësimit të legjislacionit që ka të bëjë me një akses të lehtë të personave të moshuar dhe të sëmurë në hapësirat urbane, rurale, institucione, etj.

Për një strategji më të mirë ndërgjegjësimi e komunikimi me viktimat dhe publikun e gjerë

1. Është me vend të nxitet dalja e spoteve publicitare në mediat audiovizive kundër dhunës në familje dhe formave të mbrojtjes së viktimës.
2. Konkurse dhe çmime për botimet më të mira që i kushtohen familjes shqiptare, pozitës së gruas në shoqëri, edukimit të rinjve e veçanërisht djemve për të drejtat e grave në shoqëri.
3. Nxitje me informacion dhe subvencione të ndryshme të shfaqjes të filmave të huaj në kinematë dhe ekranet televizive shqiptare që trajtojnë probleme të dhunës në familje, trajtimit human të të moshuarve, të sëmurëve, etj.

4. Nxitje e bisedave në studio televizive e radiofonike me temë nga problematika e marrëdhënieve humane në familjen bashkëkohore dhe solidaritetit familjar.
5. Bashkëpunimi me komunitetet fetare për të propaganduar dhe kuptuar më mirë vlerat e paqes dhe kundërshtimit e refuzimit të dhunës në shoqëri dhe në familje, brenda kontekstit të pluralizmit fetar shqiptar.
6. Rishikimi nga grupe individësh dhe qytetarësh aktivë, specialistë, prindër, mësues, etj., lidhur me cilësinë dhe përmbajtjen e teksteve të edukimit qytetar e seksual në shkolla, në të gjitha nivelet e arsimimit, që lidhen me familjen dhe kundërshtimin e dhunës familjare.
7. Analiza statistikore e të dhënave marrë nga organet gjyqësore dhe ato të rendit publik lidhur me krimin dhe dhunën në familje dhe botimi i tyre periodik në statistikat zyrtare.

Grupi i Punës që realizoi Studimin

Udhëheqëse e grupit të punës studimore: Doc. Iris LUARASI

Drejtues i grupit studimor: Akademik Prof. Dr. Artan FUGA

Kërkuese e grupit sasior: MA. Elvana Gadeshi

Kërkuese e grupit cilësor: Dr. Anita Pilika

Menaxher për mbledhjen e të dhënave

në terren: MA. Thanas Goga

Asistente e projektit studimor: MA. Elona Ocka

Konsulentë të studimit: Znj. Alma Gjurgji

Z. Ilir Zhurka

Drejtues i Programit SACP: Z. Robert Korkuti

Ekspert Ndërkombëtar: Z. Timothy Del Vecchio

Mbledhësit e të dhënave dhe stafi:

Lejla Shehu, Arjana Haxhiu Maci, Anila Dedei, Nazire Bidollari, Dafina Zhgjuni, Lida Leskaj, MA. Ela Tollkuci, dhe Jona Rrapti.

Bibliografia

1. Barnes, D. M. (1996). An analysis of the grounded theory method and the concept of culture. *Qualitative Health Research*, 6(3), 429-441.
2. Bachman, R., *Violence Against Women: A National Crime Victimization Survey Report*, Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Bureau of Justice Statistics, 1994
3. Creswell, J. W. (2009). *Research design: Qualitative, quantitative, and mixed methods approaches* (3rd Edition ed.). Thousand Oaks, CA: Sage
4. Glaser, B. G. (1978). *Theoretical sensitivity: Advances in the methodology of grounded theory*. Mill Valley, CA: Sociology press.
5. Glaser, B. G. (1992). *Basics of grounded theory analysis*. Mill Valley, CA: Sociology Press.
6. Glaser, B. G. (1999). The future of grounded theory. *Qualitative health research*, 9(6), 836-845.
7. Glaser, B. G. & Strauss, A. L. (1967). *The discovery of grounded theory: Strategies for qualitative research*. New York: Aldine de Gruyter.
8. Johnson, R. B. & Onwuegbuzie, A. J. (2004). Mixed methods research: A research paradigm whose time has come. *Educational Researcher*, 33(7), 14–26.
9. Johnson, B. R., Onwuegbuzie, A. J., & Turner, L. A. (2007). Toward a definition of mixed methods research. *Journal of Mixed Methods Research*, 1(2), 112-133.
10. Kendall, J. (1999). Axial coding and the grounded theory controversy. *Western Journal of Nursing Research*, 21(6), 743–757.
11. Kitzinger, J. (1994). The methodology of focus groups: the importance of interaction between research participants. *Sociology of Health and Illness*. Vol 16, Issue 1.
12. Miles, M. B. & Huberman, A. M. (1994). *An expanded source book. Qualitative data analysis* (2nd ed.). Thousand Oaks, London, New Delhi: Sage Publications.
13. Montes, G., & Halterman, J. (2006).

14. Newman, W. L. (2006). *Social research methods: Qualitative and quantitative approaches* (6th ed.). Boston: Pearson
15. Patton, M. Q. (2002). *Qualitative research & evaluation methods* (3rd ed.). Thousand Oaks, London, New Delhi: Sage Publications
16. Rauscher, L., & Greenfield, B. H. (2009). Advancements in contemporary physical therapy research: Use of mixed methods designs. *Physical Therapy*, 89(1), 91-100.
17. Schafer, J., R. Caetano, C.L. Clark, “Rates of Intimate Partner Violence in the United States,” *American Journal of Public Health* 88 (11) (1998)
18. Strauss, A. & Corbin, J. (1998). *Basics of qualitative research: Techniques and procedures for developing grounded theory* (2nd ed.). Thousand Oaks, London, New Delhi: Sage Publications.
19. Stephenson, A., Henry, C., & Robinson, L. (1996). Family characteristics and adolescent substance use. *Adolescence*, 31, 59–77.
20. Walker, D. & Myrick, F. (2006). Grounded theory: An exploration of process and procedure. *Qualitative Health Research*, 16(4), 547–559.
21. World Health Organization. (1993). *ICD-10 1986 draft of chapter 5 categories F00-F99*.
22. Yin, R. (1989). *Mental, behavioral and developmental disorders* Geneva: Case study research: Design and methods. Newbury Park: Sage Publications. References 295
23. INSTAT. *Dhuna në familje në Shqipëri: vrojtim kombëtar me bazë popullatën*. Mars 2009
24. UNICEF. *Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri*. Tiranë, 2006
25. USAID. *Udhëzimet për Urdhrat e Mbrojtjes në Shqipëri*. 2006
26. USAID. *Protokolli shëndetësor në Shqipëri për dhunën në familje*. 2006
27. Amnesty International. *Raport 2011: Situata e drejtave të njeriut në botë (Shqipëria)*
28. QAGJZH & MPÇSSH. *Dhuna në familje: Paraqitje e situatës aktuale*. Prill 2006

29. Rrjeti kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Trafikimit. Raporti “Ngritja e mekanizmit të referimit ndërsektorial për rastet e dhunës në familje, në nivel lokal dhe efektivitetit i funksionimit të tij”. Mars 2010
30. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. “Raport: Zbatimi i ligjit për masat e dhunës në marrëdhëniet familjare”. Shkurt 2010
31. Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”
32. Ligji nr.9914, datë 12.5.2008 “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006, Për masat ndaj dhunës në Marrëdhëniet familjare”
33. Ligji Nr. 10 329, datë 30.09.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 Për masat ndaj Dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar
34. VKM Nr.334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”
35. Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”
36. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë Ligji nr. 23/2012 datë 1.3.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895 datë 27.01.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar
37. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje 2011-2015
38. Vendimi nr.573, datë 16.6.2011 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin me bazë Gjinore e Dhunës në Familje 2011-2015, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj”
39. Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013. Tiranë, 2007
40. Plan Veprimi i PSH-së (shtator’11 –dhjetor’12) për zbatimin e planit të veprimit të SKBGJ-DHGDHF 2011-2015
41. Urdhër nr. 379 datë 03.03.2008 i ministrit të Brendshëm: “Për masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje”
42. Urdhër nr. 344, datë 05.10.2010 i ministrit të Brendshëm “Për disa shtesa dhe

ndryshime në Urdhrin e ministrit të Brendshëm Nr.251, datë 15.02.2008, Për hartimin e statistikave të kriminalitetit”, i ndryshuar

43. Urdhër nr.981 datë 31.10.2008 i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë “Për masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, trajtimin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare”
44. Manual “Mbi procedurat standarde që duhet të zbatojë punonjësi i Policisë së Shtetit në marrjen e masave për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e kujdesin për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare”. PSH-it, 2008
45. Strategjia për Trajnimin dhe Arsimin në Policinë e Shtetit Shqiptar, 2011-2016. MB / PSH
46. <http://www.ovw.usdoj.gov/domviolence.htm>